



# GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

**PRISHTINË**  
.....  
**VITI III / NR. 25 / 1 QERSHOR 2008**

## GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Editon: Zyra për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës botohet në mbështetje të *Ligjit për Gazetën Zyrtare nr. 2004/47; si dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/25 për shpalljen e Ligjit për Gazetën Zyrtare.*

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës boton tekstet zyrtare dhe përfundimtare të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe të shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm; rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, rregullativat dhe aktet e tjera normative të Qeverisë dhe ministrive; marrëveshjet e karakterit ndërkombëtar etj.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, botohet në pesë gjuhë: në gjuhën shqipe, angleze, serbe, turke dhe atë boshnjake.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës administrohet nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës.

Mbikëqyrja editoriale:

Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit, **FITIM KRASNIQI**

Drejtor i Zyrës për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës:  
**Naser Canolli**

Redaktor përgjegjës:

**Mentor Hoxha**

Redaksia

**Shqipe Fazliu - Gashi**

Adresa dhe korrespondencat:

Ndërtesa e re e Qeverisë,

Prishtinë

gazetazyrtare@ks-gov.net

038-201 14039

www.ks-gov.net/gazetazyrtare

NË RAST MOSMARRËVESHJEJE NDËRMJET VERSIONEVE TË DOKUMENTEVE TË  
NDRYSHME TË SHPALLURA NË GAZETËN ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
VERSIONET NË GJUHËT ZYRTARE TË QEVERISË, NË PËRPUTHJE  
ME PARAGRAFIN 9.3.19 TË KORNIZËS KUSHTETUESE, JANË NJËSOJ AUTENTIKE



## PËRMBAJTJA

<i>LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17.....</i>	<i>1</i>
<i>LIGJI PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E TË USHQYERIT ME QUMËSHT GJIRI.....</i>	<i>59</i>
<i>LIGJI PËR AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS.....</i>	<i>64</i>
<i>LIGJI PËR VEPRIMTARITË HIDROMETEOROLOGJIKE.....</i>	<i>68</i>
<i>LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/49 PËR PATENTIM.....</i>	<i>71</i>
<i>LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/5 PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË.....</i>	<i>72</i>



## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

## LIGJI NR. 02/L-99

LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK  
NË KOSOVË, NR. 2003/17

Me ndryshimet dhe plotësimet e datës 08.02.2007

Kuvendi i Kosovës,

Duke marrë parasysh Rregulloren e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 të datës 12 dhjetorit 1999, të ndryshuar, mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë, Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/9 të 15 Majit 2001, "mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë," veçanërisht nenet 5.1 (b), 5.7, 9.1.1, 9.1.26, (a), 9.3.3 dhe 11.2 e tutje; dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 të 13 Shtatorit 2001, mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, veçanërisht nenet 1.6 dhe 1.7 e tutje, dhe pikën (ix) të Shtojcës II të kësaj Rregulloreje si dhe pikën (vi) të Shtojcës IX; dhe duke njohur nevojën për renditjen dhe përputhjen e aktiviteteve të prokurimit në Kosovë me kërkesat dhe standardet e Unioni Evropian dhe praktikat e standardeve më të mira ndërkombëtare;

Miraton,

LIGJIN PËR PROKURIMIN PUBLIK NË  
KOSOVË

## PËRMBAJTJA;

PJESA I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

## Kreu 1

## Qëllimi, fushëveprimi, përjashtimet, përkufizimet

Neni 1.	Qëllimi,
Neni 2.	Fushëveprimi,
Neni 3.	Përjashtimet,
Neni 4.	Përkufizimet,

## Kreu 2

## Parimet e përgjithshme

Neni 5.	Ekonomiciteti dhe efikasiteti
Neni 6.	Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi

## Kreu 3

## Kërkesat e përgjithshme

Neni 7.	Planifikimi i prokurimit,
Neni 8.	Përcaktimi i nevojave që duhet përm bushur,
Neni 9.	Transparenca,
Neni 10.	Informatat sekrete afariste,
Neni 11.	Valutat dhe pagesat,
Neni 12.	Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik,
Neni 13.	Pranuesit e të drejtave të veçanta ose ekskluzive,

## Kreu 4

Rregullat për vlerësimin dhe klasifikimin e  
Kontratave Publike dhe Konkurseve të Projektimit

Neni 14.	Klasifikimi i kontratave të përziera,
Neni 15.	Llogaritja e vlerës së parashikuar të kontratës për furnizim,
Neni 16.	Llogaritja e vlerës së parashikuar të kontratës për shërbime, Klasifikimi i kontratës publike sipas vlerës së parashikuar,
Neni 19.	Klasifikimi i konkursit të projektimit sipas vlerës,
Neni 19.	Kufizimet për zbatimin e neneve 15-19,

## Kreu 5

Autorizimi për iniciimin e një aktiviteti të prokurimit  
dhe nënshkrimin e kontratës publike

Neni 20.	Inicimi i aktiviteteve të prokurimit,
Neni 21.	Themelimi i departamenteve të prokurimit nga autoritetet kontraktuese,
Neni 22.	Zyrtarët e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit ,
Neni 23.	Trajnimi i Zyrtarëve të Prokurimit,
Neni 24.	Nënshkrimi i kontratave publike,
Neni 25.	[Shfuqizohet],
Neni 26.	[Shfuqizohet],

## PJESA II

## RREGULLAT PËR KONTRATAT PUBLIKE

## Kreu 1

## Rregullat për specifikimet teknike dhe dosjen e tenderit

Neni 27.	Dispozitat e përgjithshme
----------	---------------------------

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

- Neni 28. Specifikimet teknike  
Neni 29. Llojet e specifikimeve teknike

**Kreu 2****Llojet dhe zbatueshmëria e procedurave të prokurimit**

- Neni 30A. Dispozitat e përgjithshme,  
Neni 30. Procedurat e hapura,  
Neni 31. Procedurat e kufizuara,  
Neni 32. [Shfuqizohet],  
Neni 33. Procedurat e negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës,  
Neni 34. Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës,  
Neni 35. Procedurat për kuotimin e çmimeve,  
Neni 36. Procedurat për kontratat me vlerë minimale dhe kontratat e pronës së paluajtshme,  
Neni 36A. Kontratat Publike Kornizë

**Kreu 3****Rregullat mbi reklamimin dhe transparencën**

- Neni 37. Njoftimi paraprak,  
Neni 38. Njoftimi i kontratës,  
Neni 39. Njoftimi mbi dhënien e kontratës,  
Neni 40. Publikimi i njoftimeve,  
Neni 41. Forma dhe përmbajtja e njoftimeve,  
Neni 42. Rregullat e përgjithshme mbi caktimin e afateve kohore për pranimin tenderëve ose kërkesave për pjesëmarrje,  
Neni 43. Rregullat e posaçme për përcaktimin e afatit kohor për pranimin e tenderëve, të një kontrate publike të përfshira nga një njoftim paraprak  
Neni 44. Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore,  
Neni 45. Fillimi i afatit kohor për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve,  
Neni 46. Dorëzimi i dosjes së tenderit,  
Neni 47. Mënyra e dërgimit të kërkesave për pjesëmarrje,  
Neni 48. Dërgimi dhe përmbajtja e ftesave dhe kërkesave për kuotimin e çmimeve,  
Neni 49. Njoftimi mbi kushtet e kualifikimit dhe kriteret e selektimit,  
Neni 50. Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës,  
Neni 51. Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit,  
Neni 52. Njoftimi i kandidatëve dhe tenderuesve të eliminuar,  
Neni 53. Mënyrat e komunikimit,

**Kreu 4****Udhëheqja e procedurave të prokurimit**

- Neni 54. Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave,  
Neni 55. Sigurimi i tenderit,  
Neni 56. Hapja e tenderëve,  
Neni 57. Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve,  
Neni 58. Kriteret për dhënien e kontratës,  
Neni 59. Tenderët jo-normalisht të ulët,  
Neni 59A. Përfundimi i pktivitetit të prokurimit,  
Neni 6. Siguria e ekzekutimit.

**Kreu 5****Kërkesat e përshtatshmërisë**

- Neni 61. Pranueshmëria e kandidatëve ose tenderuesve,  
Neni 62. Përshtatshmëria profesionale,  
Neni 62. Provat shkresore,  
Neni 63. Gjendja ekonomike dhe financiare,  
Neni 64. Aftësia teknike dhe/ose profesionale,  
Neni 65. Standardet për sigurimin e cilësisë,  
Neni 66. Grupet e operatorëve ekonomik dhe grupet e operatorëve të huaj.

**PJESA III****RREGULLAT PËR KONKURSET E PROJEKTIMIT**

- Neni 67. Dispozitat e përgjithshme,  
Neni 68. Fushëveprimi,  
Neni 69. Njoftimet për konkursin e projektimit,  
Neni 70. Njoftimi mbi rezultatet e konkursit të projektimit,  
Neni 71. Publikimi i njoftimeve për konkursin e projektimit,  
Neni 72. Formulari dhe përmbajtja e njoftimeve për konkursin e projektimit  
Neni 73. Mjetet e njoftimit,  
Neni 74. Përbërja dhe vendimet e jurisë.

**PJESA IV****[Shfuqizohet]**

- Nenet 75-80  
[Shfuqizohet]

**PJESA V****KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK**

- Neni 81. Krijimi i komisionit rregullativ të

- Neni 82. prokurimit publik,  
 Neni 83. Funkcionet themelore të KRPP-së,  
 Vëzhgimi dhe funksionet mbikëqyrëse të KRPP
- Neni 84. [Shfuqizohet,  
 Neni 85. [Shfuqizohet],  
 Neni 86. Emërimi i anëtarëve,  
 Neni 87. Organizimi dhe votimi në KRPP  
 Neni 87A. Masat zbatuese.  
 Neni 88. Fshtësia.  
 Neni 89. Largimi dhe suspendimi i anëtarëve,  
 Neni 89A. Dispozitat Kalimtare.

## PJESA VI

### AGJENSIA E PROKURIMIT PUBLIK

- Neni 90. Krijimi i agjencisë së prokurimit Ppublik,  
 Neni 91. Aktivitetet e prokurimit të APP-së  
 Neni 92. Emërimi, largimi dhe pezullimi i drejtorit dhe bordit ekzekutiv të APP-së  
 Neni 93. Fshtësia,

## PJESA VII

### ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

- Neni 94. Themelimi i OSHP-ës,  
 Neni 95. Funksionet dhe kompetencat e OSHP-ës  
 Neni 96. Emërimi i anëtarëve të OSHP-së  
 Neni 97. Suspendimi dhe Largimi i një Anëtarit të OSHP-së  
 Neni 98. Organizimi dhe puna e OSHP-së

## PJESA VIII

### PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË PROKURIMIT

#### Kreu 1

##### Dispozitat e përgjithshme

- Neni 99. Fushëveprimi,  
 Neni 100. Parimet themelore,

#### Kreu 2

##### Panelet shqyrtuese

- Neni 101. Autoriteti i paneleve shqyrtuese ,  
 Neni 102. Themelimi dhe Përbërja e paneleve shqyrtuese,  
 Neni 103. Rregullorja e punës së paneleve shqyrtuese,  
 Neni 104. Sekreti

#### Kreu 3

##### Fitimi dhe zbatimi fillestar i procedurave të shqyrtimit

- Neni 105. Afatet për dorëzimin e ankesës,  
 Neni 106. Arkivimi dhe përmbajtja thelbësore e ankesës,  
 Neni 107. Pezullimi automatik i aktivitetit të prokurimit,  
 Neni 108. Angazhimi i ekspertit shqyrtues,  
 Neni 109. Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues,  
 Neni 110. Vendimi i autoritetit kontraktues.

#### Kreu 4

##### Procedurat para një paneli shqyrtues

- Neni 111. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Panelit Shqyrtues,  
 Neni 112. Afati i fundit për marrjen e vendimeve,  
 Neni 113. Siguria, gjobat dhe dëmet,  
 Neni 114. Veprimet pranë gjykatave,

#### Kreu 5

##### Raportimi

- Neni 115. Raportimi para Kuvendit,  
 Neni 116. Dërgimi i informacioneve,

## PJESA IX

### MJETET JURIDIKE, DISPOZITAT NDËSHKIMORE DHE ÇËSHTJET PËRFUNDIMTARE

#### Kreu 1

##### Shkeljet e ligjit dhe ndëshkimet

- Neni 117. Ndikimi i paligjshëm dhe shpagimi,  
 Neni 118. Shkeljet e ligjit nga autoriteti kontraktues,  
 Neni 119. Kontratat që lidhen në kundërshtim me këtë ligj.

#### Kreu 2

##### Dispozitat përfundimtare

- Neni 120. Shfuqizimi i legjisllacionit të mëparshëm,  
 Neni 121. Hyrja në fuqi.

## PJESA I

### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17****Kreu 1****Qëllimi, fushëveprimi, përjashtimet,  
përkufizimet****Neni 1****Qëllimi**

1.1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

1.2. Ky ligj po ashtu, ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nën punësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

1.3. Ky ligj, ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellën duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke ju përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

**Neni 2****Fushëveprimi**

2.1. Ky ligj, vlen për të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoriteteve kontraktuese dhe koncesionerëve të punëve, ashtu siç përcaktohen këto terme në këtë ligj. Autoritet kontraktues dhe koncesionerët kërkohet që të veprojnë në përputhje dhe kërkesat e zbatueshme procedurale dhe materiale të këtij ligji gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre të prokurimit.

2.2. Ky ligj, vlen për të gjithë personat, operatorët ekonomik, dhe ndërmarrjet, ashtu si përcaktohen këto terme në këtë ligj, që janë të përfshirë, marrin pjesë

ose interesohen, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në aktivitete prokurimi të rregulluara me këtë ligj; nga personat e tillë, operatorët, dhe ndërmarrjet po ashtu kërkohet që t'i respektojnë dhe të veprojnë në përputhje me kërkesat procedurale dhe materiale të këtij ligji.

**Neni 3****Përjashtimet**

3.1. Pa cenuar asnjë dispozitë të këtij ligji, nga autoriteti kontraktues nuk do të kërkohet që të veprojnë në përputhje me secilën procedurë të veçantë të prokurimit dhe as të respektoj dispozitat e këtij ligji mbi transparencën gjer në shkallën kur, përputhshmëria dhe respektimi do të komprometonin sekretin e ligjshëm ose interesat e sigurisë gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit të rëndësishme për dhënjen e një kontrate publike për të cilën PSSP-ja dhe kryeministri janë pajtuar që ta përjashtojnë nga fushëveprimi i këtij ligji sepse, (i) ekzekutimi i kontratës në fjalë, sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë, kërkon përdorimin e masave të veçanta të sigurisë, ose (ii) PSSP-ja dhe kryeministri janë pajtuar që ta klasifikojnë lëndën e kontratës në fjalë si sekret. Pa paragjykim për kompetencat e PSSP-së lidhur me përgjegjësitë e rezervuara, përjashtimet sipas këtij neni lidhur me çështjet e rezervuara do të lejohen në pajtim me parimin e dhënë në nenin 4.2 të Ligjit mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/32.

3.2. Ky ligj nuk zbatohet për aktivitetet e prokurimit që qojnë në dhënien e një kontrate publike që bie në fushën e veprimit të një marrëveshje që parashikon zbatimin e rregullave dhe/ose procedurave të tjera të prokurimit ku; (i) kjo marrëveshje e kushtëzon disponueshmërinë e financimit të kontratës në fjalë me zbatimin e rregullave dhe/ose procedurave të tjera, dhe (ii) marrëveshja është lidhur ndërmjet UNMIK-ut ose Qeverisë dhe një institucioni financiar ndërqeveritar, dypalësh, shumëpalësh e ndërkombëtar.

3.3. Ky ligj nuk do të zbatohet për një aktivitet të prokurimit që shpie drejt punësimit ose një kontrate të punësimit nëse aktiviteti i tillë i prokurimit është lëndë e rregullave të tjera që vendosen me një ligj ose rregullore tjetër të UNMIK-ut.

3.4. Ky ligj nuk aplikohet për Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore që administrohen nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, nëse ndërmarrja e tillë nuk pranon para publike dhe nuk është e angazhuar, në bazë të drejtave të veçanta ose ekskluzive që i janë dhënë nga një autoritet kompetent publik, në një aktivitet të shërbimeve publike.

#### Neni 4 Përkufizimet

4.1. Kurdo që përdoren në këtë ligj, secili nga termet vijuese, do të ketë kuptimin e cekur më poshtë përveç, nëse konteksti në të cilin këto terme shfaqen, qartësisht kanë kuptim tjetër.

**“Zyrtar Autorizues”**, është personi i autorizuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ i autoritetit kontraktues sipas nenit 20.1 të këtij ligji, si përgjegjës për inicimin e një aktiviteti të prokurimit.

**“Agjenci Autonome Ekzekutive”**, do të thotë një autoritet publik që; (i) nuk është vetë organizatë buxhetore por është pjesë e një organizate buxhetore, dhe (ii) shprehimisht këkohet nga një akt primar normativ që të veprojë në mënyrë autonome ose me autonomi substanciale nga organizata buxhetore pjesë e së cilës është.

**“Organ i themeluar në bazë të së drejtës publike”**, nënkupton personin, ndërmarrjen ose organin që; (i) është themeluar me qëllim të veçantë për plotësimin e nevojave të përgjithshme që nuk kanë karakter prodhues ose komercial, dhe (ii) i plotëson këto kritere: (a) merr 50% ose më shumë nga financimi i tij prej fondeve publike dhe/ose një ose më shumë autoriteteve publike dhe/ose organeve të themeluara në bazë të drejtës publike, (b) i nënshtrohet mbikëqyrës menaxhues nga një ose më shumë autoritete publike dhe/ose organe të themeluara në bazë të së drejtës publike, ose (c) ka një bord administrativ, mbikëqyrës ose menxhus, 50% ose më shumë e votave të të cilit mund të ushtrohen nga anëtarët e emëruar nga një ose më shumë autoritete publike dhe/ose organeve të themeluara në bazë të së drejtës publike.

**“Kandidat”**, nënkupton një operator ekonomik që ka kërkuar të ftohet ose është ftuar të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit që është duke u ushtruar me procedurë të kufizuar ose të negociuar ose procedurë të kuotimit të çmimeve.

**“Zyrtari Kryesor Administrativ” ose “ZKA”**, në rastin e organizatave buxhetore, do të thotë; (i) Sekretarin Permanent, (ii) nëse organizata nuk ka sekretar permanent, atëherë Kryeshefin Ekzekutiv, ose (iii) nëse organizata nuk ka as Sekretar Permanent dhe as Kryeshef Ekzekutiv, atëherë personin e autorizuar për administrimin e përditshëm të organizatës dhe personelit. Në rastin e agjencive autonome ekzekutive, ZKA është drejtori ose udhëheqësi i asaj agjencie dhe jo ZKA i organizatës buxhetore pjesë e së cilës është agjencia. Në rastin e ndërmarrjeve publike, ky term nënkupton Kryeshefin Ekzekutiv, drejtorin menaxhues ose personin e autorizuar për administrimin e përditshëm të veprimtarisë dhe personelit.

**“ZKF” ose “Zyrtari Kryesor Financiar”**, ka kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

**“Mallra”** do të thotë të gjitha produktet, përfshirë energjinë elektrike, të cilat janë të zëvendësueshme dhe çmimet e të cilave janë të kuotuar në një treg ekzistues të mallrave ose në një platformë ose sistem të ngjashëm tregtar.

**“Specifikim i përbashkët teknik”**, nënkupton specifikimin teknik të përpiluar në përputhje me procedurën e pranuar nga shtetet anëtare të UE-së, me qëllim të zbatimit e njëjtë të saj nga të gjitha shtetet anëtare dhe të publikuar në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Evropian.

**“Artikuj të përdorimit të përbashkët”**, nënkupton prodhimet ose shërbimet e kërkuara nga një ose më shumë autoritete kontraktuese, për të cilat mund të arrihet përdorimi më efikas dhe me kosto ekonomike i fondeve publike me anë të zhvillimit të prokurimit qendror, të përbashkët ose të konsoliduar.

**“Parashtrues i ankesës”**, nënkupton palën e interesuar që parashtron ankesë në pajtim me dispozitat e nenit 106 të këtij ligji.

**“Informacionet sekrete afariste”**, nënkupton informacionet e përcaktuara si të tilla në nenin 10.2 të këtij ligji.

**“Autoriteti kontraktues”**, nënkupton autoritetin publik, operatorin e shërbimeve publike, ndërmarrjen publike dhe/ose personin, komisionin ose ndërmarrjen që ushtron aktivitete të prokurimit në emër të ose për llogari të autoritetit publik, ose operatorit të shërbimeve publike, ose një ndërmarrje publike.

**“Data e publikimit”**, do të thotë; (i) në lidhje me njoftimet paraprake ose njoftimet e kontratës, datën në të cilën njoftimi i tillë për herë të parë publikohet sipas nenit 40.3, dhe (ii) në lidhje me njoftimet për dhënie të kontratës, datën në të cilën ky i fudnit u është dërguar operatorëve ekonomik sipas nenit 40.4.

**“Konkurs projektimi”**, nënkupton një procedurë prokurimi që ka për qëllim t'i mundësoj autoritetit kontraktues të fitoj një plan ose një projekt të zgjedhur nga një juri, pasi që është vënë në konkurrim me ose pa shpërbllim, veçanërisht në sferat e planifikimit hapësinor, planifikimit urbanistik, arkitekturës, ingjinerjeringut, përpunimit të të dhënave, dhe projektet e veprave të artit.

**“Ndikimi mbizotërues”**, nënkupton (por nuk është i kufizuar), një situatë kur autoriteti kontraktues ose një ndërmarrje, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mban shumicën e kapitalit të një ndërmarrje, kontrollon shumicën e votave nga aksionet e emetuara të ndërmarrjes, ose mund

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

të emëroj më shumë se gjysmën e anëtarëve të organit administrativ, menaxhus ose mbikëqyrës të ndërmarrjes së tillë.

**“Operator ekonomik”**, është term i përgjithshëm që përfshinë furnizuesin, ofruesin e shërbimeve dhe/ose kontraktuesin e punëve.

**“Mjetet elektronike”**, nënkupton përdorimin e paisjeve elektronike për përpunimin (duke përfshirë kompensimin shifror), dhe ruajtjen e të dhënave të transmetuara, të bartura ose të pranuar me telegraf, me radio, me mjete pamore, ose me mjete tjera elektromagnetike.

**“Specifikim evropian”**, nënkupton specifikacionin e përbashkët teknik, miratimin teknik evropian ose standardin kombëtar-vendor që zbaton një standard evropian.

**“Standard evropian”**, nënkupton standardin e miratuar nga; (i) Komiteti Evropian për Standardizime (European Committee for Standardization, CEN), ose nga Komiteti Evropian për Standardizimin Elektroteknik (European Committee for Electrotechnical Standardization CENEL-EC) si “Standard Evropian”-( European Standard, EN), ose “Dokumenti Harmonizimi” ( Harmonization Document, HD), në përputhje me rregullat e përbashkëta të këtyre organizatave, ose (ii) nga Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit (European Telecommunication Standards Institute, ETSI), në pajtim me rregullat e tyre si Standarde Evropiane të Telekomunikacionit (European Telecommunications Standard, ETS).

**“Miratimi Teknik Evropian”**, nënkupton vlerësimin e favorshëm teknik të dhënë nga organi miratues i një shteti anëtar i UE-së mbi përshtatshmërinë e përdorimit të prodhimit për qëllime të veçanta, mbështetur në përmbushjen e kërkesave themelore për punët ndërtimore, me anë të karakteristikave qenësore të prodhimit dhe kushtet e përcaktuara të kërkesës dhe përdorimit, siç parashihet në Direktivën e Këshillit 89/106/BEE të 21 dhjetorit 1988 mbi harmonizimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare lidhur me prodhimet ndërtimore.

**“Rregullat Financiare”** do të thotë Rregullat Financiare të nxjerra nga Thesari.

**“Qeveria”**, nënkupton qeverinë e themeluar sipas nenit 1.5 (c) dhe 9.3 dhe më tutje të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/9 “Mbi Kornizën Kushtetuese të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë” dhe çdo Qeveri të ligjshme pasardhëse ose autoritet qendror ekzekutiv.

**“Kontratë e pronës së paluajtshme”**, është një kontratë me shpërbllim në të holla e lidhur ndërmjet një autoriteti kontraktues dhe një personi, ndërmarrje, ose autoriteti

kontraktues që lidhet kryesisht ose ekskluzivisht me fitimin e pronës së paluajtshme, një interesi ose të drejtë mbi ose në pronën e paluajtshme nga autoriteti kontraktues.

**“Palë e interesuar”**, nënkupton personin ose ndërmarrjen që ka ose kishte interes material nga aktivitetet ose procedurat e prokurimit të zbatuara nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi.

**“IKAP”**, është Instituti i Kosovës për Administratë Publike.

**“Kontratë me vlerë të madhe”**, nënkupton kontratën publike që trajtohet në nenin 18.1 të këtij ligji.

**“Konkurs projektimi me vlerë të madhe”**, nënkupton konkursin për projektim që trajtohet në nenin 19.1 të këtij ligji.

**“Kontratë me vlerë të vogël”**, nënkupton kontratën publike që trajtohet në nenin 18.3 të këtij ligji.

**“Konkurs projektimi me vlerë të vogël”**, nënkupton konkursin e projektimit që trajtohet në nenin 19.3 të këtij ligji.

**“Kontratë me vlerë mesatare”**, nënkupton kontratën publike që trajtohet në nenin 18.2 të këtij ligji.

**“Konkurs projektimi me vlerë mesatare”**, nënkupton konkursin e projektimit që trajtohet në nenin 19.2 të këtij ligji.

**“Kontratë me vlerë minimale”**, do të thotë një kontratë publike që trajtohet në nenin 18.4.

**“Procedurat e negociuara”**, nënkupton procedurat e prokurimit që i lejojnë autoritetit kontraktues të ftojë dhe të këshillohet me operatorët ekonomik të zgjedhur nga ai për t’i negociuar kushtet e kontratës me njërin ose më shumë prej tyre.

**“Procedurë e hapur”**, nënkupton procedurat e prokurimit që i lejojnë çdo operatori të interesuar ekonomik të paraqet tender.

**“Person”** do të thotë person fizik.

**“Rregullat e KBFP”**, do të thotë Rregullat e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike që nxirren nga thesari.

**“APP”**, do të thotë Agjencioni i Prokurimit Publik i themeluar sipas pjesës VI të këtij ligji.

**“KRPP”**, nënkupton Komisionin Rregullativ të Prokurimit

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

Publik të themeluar sipas Pjesës V të këtij ligji.

**“OSHP”**, nënkupton Organin Shqyrtues të Prokurimit të themeluar sipas Pjesës VII të këtij ligji.

**“Ky ligj”**, nënkupton këtë ligj dhe aktet normative nënligjore dhe instrumentet e nxjerra në bazë të autorizimit të këtij ligji, duke përfshirë edhe rregullat e prokurimit publik dhe kodin etik që janë lëshuar sipas autorizimit të këtij ligji.

**“Aktivitet i prokurimit,”** do të thotë çdo aktivitet që ndërlihet me fillimin ose ekzekutimin e një procedure ose një aktiviteti tjetër që shpie ose që ka për qëllim të shpie drejt dhënies së një kontrate publike.

**“Autoritet publik”**, ka secilin nga kuptimet vijuese: (i) autoritetin ekzekutiv qendror, rajonal, komunal ose lokal, organin publik, ministrinë, departamentin, agjencinë, ose autoritetin tjetër që ekzekuton, konfor me çdo akt normativ ose nën-normativ, pushtetin ekzekutiv, legjislativ, rregullativ, administrativ-publik ose gjyqësor; (ii) organin e themeluar në bazë të së drejtës publike; dhe (iii) një asociim të një ose më shumë autoriteteve dhe/ose organeve të tilla.

**“Kontratë publike”**, është term i përgjithshëm që përfshin ndonjërin dhe të gjitha llojet e veçanta të kontratave vijuese të lidhura nga një autoritet kontraktues: (i) një kontratë shërbimi, (ii) një kontratë e furnizimi, (iii) një kontratë pune, duke përfshirë kontratën e koncesioneve të punës, (iv) kontratën publike kornizë, dhe/ose (v) kontratën e pronës së paluajtshme.

**“Kontratë publike kornizë”**, do të thotë një marrëveshje për një periudhë të kufizuar kohore ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një operatori ekonomik, qëllimi i të cilës është të themelojë kornizën për kontratat që duhet të jepen gjatë kësaj periudhe, sidomos në lidhje me objektin e kontratave dhe, ku kjo është e përshtatshme, me shumat, me gjerësinë dhe sasinë e paraparë, si dhe me çmimin.

**“Fond publik”**, nënkupton; (i) para ose mjete financiare që administrohen ose kontrollohen nga autoriteti publik, në dobi të një personi, organit, organizate ose ndërmarrje përveç autoritetit publik; (ii) para ose mjete financiare që administrohen ose kontrollohen nga ndonjë person, organ, organizatë ose ndërmarrje që kryen këtë administrim ose që ekzekuton këtë kontroll për ose në emër të autoritetit publik dhe (iii) të gjitha paratë ose mjetet financiare të dhëna ose të përvetësuara, drejtpërdrejt ose tërthorazi autoritetit kontraktues ose ndërmarrjes nën Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës ose nën Fondin e Konsoliduar të Kosovës.

**“Regjistri i Prokurimit Publik”**, nënkupton regjistrin e themeluar nga KRPP-ja sipas nenit 82 të këtij ligji.

**“Rregullat e prokurimit publik”**, do të thotë udhëzimet, rregullat, dokumentet, kodi etik dhe formularët standard që nxirren dhe shpallen nga KRPP sipas këtij ligji.

**“Aktivitet i shërbimeve publike”**, do të thotë një aktivitet që përfshin; (i) ofrimin ose mbajtjen e rrjetit fiks fizik me qëllim të ofrimit të shërbimeve për publikun në lidhje me, mes tjerash., prodhimin, transportin, ose përpunimin ose shpërndarjen e ujit, rrymës, gazit ose ngrohjes, (ii) furnizimin me ujë, rrymë, gaz ose ngrohje për rrjetin e tillë, (iii) shfrytëzimin e zonave gjeografike me qëllim të hulumtimit ose nxjerrjes së naftës, gazit, thëngjillit ose karburanteve tjera të ngurta, (v) ofrimin e aeroportit ose pajisjeve të tjera terminale, (iv) ofrimin ose mbajtjen e një rrjete publike të telekomunikacionit ose ofrimin e një ose më shumë shërbimeve të telekomunikacionit ose postare, (vi) mbledhjen dhe menaxhimin e mbeturinave, ose (vii) mbajtjen e një rrjete që i ofron publikut shërbime të transportimit duke përfshirë përdorimin e hekurudhës, autobusëve, tramvajeve, trolejbusëve, sistemeve kabllorike ose automatike; një rrjetë e tillë ekziston kur shërbimet e tilla transportuese ofrohen në përputhje me kushtet operative të përcaktuara nga një autoritet kompetent publik, siç janë kushtet mbi territorin i cili do mbulohet nga shërbimi, kapaciteti i cili do të vihet në dispozicion ose frekuentimi i shërbimit.

**“Operator i shërbimeve publike”**, nënkupton: (i) autoritetin publik ose ndërmarrjen publike të angazhuar në një aktivitet të shërbimeve publike, dhe (ii) një person, ndërmarrje, organ ose organizatë që nuk është as autoritet publik e as ndërmarrje publike dhe që është e angazhuar, në bazë të te drejtave të veçanta ose ekskluzive që i janë dhënë nga një autoritet kompetent publik, në një aktivitet të shërbimeve publike.

**“Ndërmarrje publike”**, do të thotë çdo ndërmarrje mbi të cilën një ose më shumë autoritete publike mund të ekzekutojnë drejtpërdrejtë ose tërthorazi, ndikim mbizotërues në bazë të pronësisë në ndërmarrjen e tillë, pjesëmarrjes financiare në ndërmarrjen e tillë dhe/ose dispozitave që rregullojnë ndërmarrjen e tillë.

**“Ndërmarrje e ndërlidhur”**, nënkupton çdo ndërmarrje; (i) mbi të cilën koncesioneri i punëve mund të ushtrojë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, ndikim mbizotërues, (ii) që mund të ekzekutojë ndikim mbizotërues mbi koncesionerin përkatës të punës, ose (iii) që, bashkë me koncesionerët përkatës të punës, i nënshtrohet ndikimit mbizotërues të ndërmarrjes tjetër në bazë të pronësisë, pjesëmarrjes financiare, ose dispozitave që e rregullojnë atë.

**“Procedurat e kufizuara,”** janë procedurat e prokurimit të përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji.

**“Paneli shqyrtues”** do të thotë panelin e shqyrtimit që themelohet nga Kryetari i OSHP në pajtim me pjesën VIII të këtij ligji.

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

**“Kontratë për koncesion shërbimi”**, nënkupton kontratën e llojit të njëjtë sikur që është kontrata e shërbimit përveç se kompensimi për shërbimet e ofruara realizohet nga e drejta për të shfrytëzuar shërbimet, ose në këtë të drejtë bashkë me pagesën.

**“Kontratë shërbimi”**, nënkupton kontratën me shpërblim me para, të lidhur ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë ofruesve të shërbimeve që ka të bëjë vetëm ose kryesisht me ofrimin e shërbimeve.

**“Ofrues i shërbimeve”**, nënkupton çdo person, ndërmarrje ose organ publik, ose grup i personave, ndërmarrjeve dhe/ose organeve të tilla që kryejnë dhe/ose ofrojnë të kryejnë shërbime.

**“Të drejta të veçanta ose ekskluzive,”** nënkupton të drejtat që dalin prej lejes ose autorizimit të dhënë nga organi kompetent publik sipas dispozitave ligjore, rregullave ose administrative që; (i) ka efekt kufizues ndaj një ose më shumë entiteteve në të drejtën ose ftësinë për t'u angazhuar në aktivitete të caktuara, dhe (ii) qenësisht ndikon në të drejtën ose aftësinë e personave të tjerë, ndërmarrjeve, organeve ose organizatave për të kryer një aktivitet të tillë në të njëjtin territor dhe nën kushte esencialishtë të njëjta.

**“Furnizues”**, do të thotë çdo person, ndërmarrje ose organ publik, ose grup i personave të tillë, ndërmarrjeve, dhe/ose organeve që furnizojnë ose ofrojnë të furnizojnë produkte.

**“Kontratë furnizimi”**, nënkupton kontratën me shpërblim në para të lidhur ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë furnizuesve që ka të bëjë vetëm ose kryesisht me blerjen, qiradhënien ose blerjen me këste, me ose pa mundësi blerje, të një ose më shumë produkteve; “produktet” interpretohen gjerësisht si një ose më shumë sende të prekshme të lëvizshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, mallrat, artikujt, prodhimet e përpunuara, lëndët e para, dhe pajisjet.

**“Standard”**, do të thotë specifikacion teknik i miratuar nga një organ i pranuar i standardizimit, për përdorim të përsëritur ose të vazhdueshëm, përputhja me të cilin përgjithësisht nuk është i detyrueshëm.

**“Specifikim teknik”**, do të thotë kushtet teknike që përcaktojnë karakteristikat e grupit të punëve, materialit, produktit, furnizimit ose shërbimit, dhe që i mundëson llojit të punës, materialit, produktit, furnizimit ose shërbimit që të përshkruhet objektivisht në mënyrë që të plotësojë nevojat e paracaktuara nga autoriteti kontraktues. Specifikim teknik mund të përfshijë kualitetin, treguesin e zbatueshmërisë, aspektin e sigurisë, si dhe kërkesat e zbatueshme të materialit, produktit, furnizimit ose shërbimit sa i përket sigurisë së kualitetit, terminologjisë,

simboleve, metodave të testit dhe testimit, ambalazhimit, shënimit dhe etiketimit. Në rastin e kontratave të punës, ato po ashtu mund të përfshijnë rregullat për dizajnim dhe shpenzime, testin, inspektimin dhe kushtet e pranimit për punët ose teknikat ose metodat e ndërtimit dhe të gjitha kushtet tjera teknike të cilat autoriteti kontraktues është në gjendje t'i përshkruaj sipas rregulloreve të veçanta ose të përgjithshme, lidhur me punët e kryera dhe materialet ose pjesët që ato i përfshijnë.

**“Tender”**, do të thotë një dokument që i dorëzohet autoritetit kontraktues nga një operator ekonomik, duke parashtruar kushtet e ofertës së operatorit ekonomik si përgjegje ndaj një njoftimi specifik të kontratës, njoftimit për tenderim ose ndonjë kërkesë tjetër që është nxjerrë ose përgatitur nga autoriteti kontraktues në fjalë. Termi “tender” përfshin, por nuk kufizohet vetëm në një propozim ose kuotim të çmimeve.

**“Tenderues”**, nënkupton operatorin ekonomik që ka dorëzuar tenderin.

**“Dosje tenderi”**, ka kuptimin e përcaktuar në nenin 27

**“Ndërmarrje”**, nënkupton secilin subjekt afarist (duke përfshirë edhe subjektet personale afariste), ortakëri, ndërmarrje të përbashkët, person juridik, shoqatë, projekt, filialë, zyrë, ose organizatë ose themelitet tjetër.

**“Shkelje”**, do të thotë dështimin për tu pajtuar me një ose më shumë dispozita të këtij ligji.

**“Punë”**, nënkupton rezultatin e ndërtimit ose punët ndërtimore ose aktivitetet që, marrë në tërësi, janë të mjaftueshme të plotësojnë një funksion ekonomik ose teknik.

**“Koncesioner i punëve”**, nënkupton; (i) personin, ndërmarrjen ose autoritetin kontraktues që ka marrë kontratë pune koncesioni nga autoriteti kontraktues, dhe/ose (ii) secili person, ndërmarrje ose autoritet kontraktues që kryen aktivitete prokurimi në emër të ose për llogari të personit të tillë, - ndërmarrjes ose autoritetit kontraktues.

**“Kontratë pune me konsension”**, nënkupton kontratën e punës, përmbushja e së cilës kompensohet tërësisht ose pjesërisht, me dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të objektit të kësaj kontrate

**“Kontratë pune”**, nënkupton kontratën me shpërblim në para, të lidhur ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë kontraktuesve të punëve i cili ka detyrë kryesore zbatimin, projektimin dhe përmbushjen, ose realizimin, me çfarëdo mënyre, të punës ose ndërtimit ose aktiviteteve ndërtimore komunale, që do të thotë aktiviteteve që janë drejtpërdrejt të përfshira në ndërtimin, restaurimin, riparimin ose shkatërrimin e godinave, pajisjeve, strukturave ndërtimore, strukturave tjera, ose të një

pjesë të tyre.

**“Kontraktues pune”**, nënkupton secilin person, ndërmarrje ose autoritet kontraktues, ose grup të personave të këtyllë, ndërmarrjeve, që ofrojnë të ekzekutojnë, projektajnë ose përmbrojnë, ose realizojnë, me çfarëdo mjeti, punën ose ndërtimin ose aktivitetet ndërtimore, do të thotë aktivitetet që janë drejtpërdrejt të përfshira në ndërtimin, restaurimin, riparimin ose shkatërrimin e godinave, pajisjeve, strukturave ndërtimore, strukturave tjera, ose secilës pjesë të tyre.

**“Me shkrim”**, do të thotë çdo shprehje që përbëhet nga fjalët dhe/ose shifrat që mund të lexohen, riprodhohen dhe më pastaj të komunikohen. Kjo mund të përfshijë informacionin e transmetuar dhe të ruajtur me mjete elektronike.

4.2. Personi ose ndërmarrja që ka për qëllim t'i caktoj ose jap kontratë personit tjetër ose ndërmarrjes, nëse 50% ose më shumë e vlerës së çmuar të kontratës së tillë është qoftë drejtpërdrejt e subvencionuar nga autoriteti kontraktues ose përndryshe e financuar me fonde publike, do të konsiderohet se është “autoritet kontraktues” në kuptim të këtij ligji lidhur me çdo aktivitet prokurimi me lejin apo dhënien e kontratës së tillë. Personi ose ndërmarrja e tillë me këtë rast, do të zhvilloj aktivitetet e prokurimit rreptësisht në përputhje me kërkesat a zbatueshme procedurale dhe thelbësore të këtij ligji.

4.3. Më shumë përkufizime të termave të përdorura në këtë ligj, si dhe definimet e termave të tjerë, mund të përcaktohen ose të rregullohen me rregullat e prokurimit publik; me kusht që, sidoqoftë, këto definime më të detajuara dhe definimet e termave tjerë nuk do të pengojnë zbatimin e asnjë dispozite të këtij ligji.

## Kreu 2 Parimet e përgjithshme

### Neni 5 Ekonomiciteti dhe efikasiteti

5.1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, operatorët ekonomik, personat, ndërmarrjet dhe koncesionerët e punëve që ekzekutojnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

5.2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

### Neni 6

#### Barazia në trajtim- jo-diskriminimi

6.1. Autoriteti kontraktues nuk do të ndërmerr asnjë aktivitet ose procedurë të prokurimit në ndonjë mënyrë që redukton ose eliminon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik.

6.2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë fazë ose element të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që diskriminon në favor ose kundër një ose shumë operatorëve ekonomik.

6.3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi të artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

6.4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

6.5. Përveç nëse, një imponim i tillë i ndonjë kërkesë në mënyrë specifike lejohet nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose ndonjë marrëveshje ndërkombëtare, autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

6.6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të marrin masa të arsyeshme dhe të nevojshme për të garantuar; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënje, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftësën për tender ose pjesëmarrje dhe ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

### **Kreu 3**

## **Kërkesat e përgjithshme**

#### **Neni 7**

#### **Planifikimi i prokurimit**

7.1. Jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë dhe të pajis APP-në me planifikimet paraprake të prokurimit, me shkrim, në të cilat identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë. Planifikimi i tillë paraprak i prokurimit saktëson:

- a. Në rastin e kontratave të ardhshme për furnizim, vlerën e përgjithshme të llogaritur të prokurimit sipas lëmesë së secilit produkt, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal;
- b. Në rastin e kontratave të ardhshme për shërbime, vlerën e përgjithshme të parashikuar sipas kategorisë të secilit shërbim, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal; dhe
- c. Në rastin e kontratave për punë, karakteristikat thelbësore të çdo kontrate të punës, që autoriteti kontraktues planifikon ta japë gjatë vitit fiskal.

7.2. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike pas shpalljes së legjislationit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë APP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit të tillë fiskal. Planifikimi i tillë përfundimtar duhet të përmbajë të dhënat që kërkohen nga pikat a-c të nenit 7.1.

7.3. APP-ja, menjëherë shqyrton dhe mbledhë informacionet e dhëna në planifikimet e tilla. APP-ja identifikon produktet e përdorimit të përbashkët dhe të gjitha artikujt dhe produktet e tjera që mund të sigurohen në mënyrë më efektive përmes zbatimit të një procedure të konsoliduar ose të përbashkët të prokurimit. APP-ja ia dorëzon këtë listë Qeverisë.

7.4. Në pajtim me nenin 91.1 të këtij ligji, Qeveria është e autorizuar, që të përcaktojë APP-në si organin përgjegjës për kryerjen e një aktiviteti të caktuar prokurimi, duke përfshirë aktivitetet e konsoliduara (përbashkëta), të prokurimit, në emër të një ose më shumë autoriteteve publike.

#### **Neni 8**

#### **Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur**

8.1. Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti ose procedure të veçantë të prokurimit që ka për qëllim blerjen e çfarëdo produkti, shërbimi ose pune, autoriteti kontraktues duhet të bëjë një vlerësim formal të nevojave lidhur me këto. Me këtë vlerësim përcaktohen; (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtësore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë; (iv) përfitimet e pritura nga secili objekt i tillë; (v) në rastin e pajisjeve, mallrave të qëndrueshme dhe punëve, përlllogaritja e shpenzimeve të disponimit gjatë tërë afatit të përdorimit të objektit, duke përfshirë shpenzimet e blerjes, operative, mirëmbajtjes si dhe vlerës së mbetur; (vi) një njoftim, mbi atë se nëse aktiviteti i tillë i prokurimit ishte përfshirë në planifikimin e prokurimit, në përputhje me nenin 7 dhe nëse nuk ishte përfshirë, atëherë një deklaratë mbi arsyet e mospërfshirjes së tillë; dhe (vii) konstatimin e saktë mbi atë se në çfarë mënyre do të avancojë prokurimi përkatës synimet institucionale të autoritetit kontraktues.

8.2. Pas vlerësimit të nevojave, autoriteti kontraktues do të garantojë formalisht se fondet për prokurimin përkatës janë akorduar në shumën që është e mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të lindin gjatë vitit përkatës fiskal (vitit kur ushtrohet aktiviteti i prokurimit në fjalë), si pasojë e prokurimit të tillë.

8.3. Nëse prokurimi përkatës nxit ngritjen e obligimeve financiare që duhet të përmbushen nga përvetësimet e viteve të ardhshme fiskale, autoriteti kontraktues do të (i) sigurojë se Korniza ekzistuese Afatmesme e Shpenzimeve, e përgatitur sipas Ligjit për Menax-

himin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ofron bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do të ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla dhe, (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.

8.4. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik.

8.5. Si dëshmi se autoriteti kontraktues është pajtuar me nenet 8.1-8.4, autoriteti kontraktues do të përgatisë dhe mbajë një "Deklaratë të Nevojave dhe Vendosshmerisë për Disponueshmërinë e Fondeve". Deklarata e tillë e Nevojave dhe Vendosshmerisë për Disponueshmërinë e Fondeve do të përmbajë informatat në vijim: (i) një deklaratë të nevojave me shkrim, e cila i përmbledh rezultatet e vlerësimit të nevojave që është bërë nga autoriteti kontraktues sipas nenit 8.1, (ii) një deklaratë me shkrim që konfirmon disponueshmërinë e fondeve, që demonstroi se autoriteti kontraktues i ka përmbushur obligimet e tij sipas nenit 8.2, (iii) nëse është e aplikueshme, atëherë duhet që gjithashtu të dorëzohet një deklaratë me shkrim që i parashtron bazat, që kërkohen nga neni 8.3, për pritjet e autoritetit kontraktues në lidhje me përvetësimet e ardhshme: dhe (iv) nëse është e aplikueshme, një deklaratë me shkrim që përshkruan masat që autoriteti kontraktues i ka marrë për t'u përputhur me nenin 8.4. KRPP do të hartojë një formular standard për "Deklaratën e Nevojave dhe të Vendosshmerisë për Disponueshmërinë e Fondeve" që autoritetet kontraktuese do ta përdorin për t'i përmbushur kushtet e parashtruara nga ky nen 8.5.

8.6. Nëse objektet e aktivitetit të prokurimit nuk janë përfshirë në planifikimin përfundimtar të prokurimit, që është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe i është dorëzuar APP-së sipas nenit 7.2, autoriteti kontraktues do t'i dorëzojë APP-së një kopje të "Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmerisë për Disponueshmërinë e Fondeve" për prokurimin përkatës së paku pesë (5) ditë pune para fillimit të aktivitetit përkatës të prokurimit. APP-ja do të shqyrtojë çdo deklaratë të nevojave për të përcaktuar se nëse ka ndonjë metodë tjetër më efikase dhe më ekonomike për blerjen e mallrave të tilla ose produkteve të tjera, që i plotësojnë nevojat e autoritetit kontraktues. Në veçanti, nëse mallrat ose produktet përkatëse nuk janë përfshirë në planifikimin përfundimtar të prokurimit që i

është dorëzuar APP-së sipas nenit 7.2, APP-ja do të shqyrtojë objektet e tilla për të identifikuar artikujt e përbashkët të prokurimit si dhe mallrat e tjera dhe artikujt që mund të sigurohen në mënyrë më efikase, përmes procedurës së përbashkët ose procedurës së zakonshme të prokurimit. APP e dorëzon një listë të mallrave (artikujve) në Qeveri. Qeveria është e autorizuar sipas nenit 91.1 të këtij ligji, që të përcaktojë APP-ën si organin ekskluzivisht përgjegjës për kryerjen e aktivitetit të prokurimit për ato mallra (artikuj).

## **Neni 9 Transparenca**

9.1. Autoriteti kontraktues mban një përmbledhje të rregulluar dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave për secilin aktivitet të prokurimit që e kryen, pa marrë parasysh nëse aktiviteti i tillë rezultoi në dhënjën e kontratës ose konkursit të projektimit.

9.2. Shënimet për secilin aktivitet të prokurimit duhet të përmbajnë se paku: (i) të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me një aktivitet të prokurimit ose që janë zhvilluar apo pranuar gjatë, ose që janë mbledhur ose shfrytëzuar për të filluar ose përmblyllur një aktivitet të prokurimit, pa marrë parasysh nëse aktiviteti i tillë rezultoi në një kontratë ose në dhënjën e konkursit të projektimit, dhe (ii) nëse aktiviteti i prokurimit ka rezultuar në dhënjën e një kontrate ose konkursi të projektimit, atëherë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me dhënjën e tillë, dhe (iii) nëse aktiviteti i prokurimit ka rezultuar në ekzekutimin e një kontrate publike, atëherë një kopje të kontratës publike dhe të të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me kontratën dhe/ose ekzekutimin e saj.

9.3. Me kërkesën e cilitdo person, autoriteti kontraktues i siguron qasje të menjëhershme dhe të arsyeshme personit të tillë, i cili kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në nenin 9.1 dhe 9.2 përveç informatave sekrete afariste, që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur për më shumë se dhjetë (10) ditë; Për qëllime të këtij neni 9.3, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur; (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënjën e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) nëse sipas këtij ligji nuk është e nevojshme publikimi i një njoftimi të tillë për aktivitetin përkatës të prokurimit, në datën e dhënies së kontratës, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën kur aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar.

9.4. Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

nga neni 9.3 në mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave.

9.5. Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një personi ose pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë personit ose palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin personi ose pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas nenit 9.3.

9.6. KRPP-ja do t'i sigurojë çdo personi që kërkon, një kopje të këtij ligji dhe/ose rregullave të prokurimit.

9.7. KRPP-ja do të publikojë në mënyrë elektronike, këtë ligj dhe rregullat e prokurimit publik në faqen e saj zyrtare në internet.

9.8. KRPP-ja do të vendosë në rregullat e prokurimit publik, një tarifë të arsyeshme që autoriteti kontraktues dhe KRPP-ja mund ta vendosin për të mbuluar shpenzimet e fotokopjimit që kërkohen nga neni 9.5 dhe 9.6; sidoqoftë, me kusht që, tarifa e tillë të mos jetë më e madhe se sa konsiderohet e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që ndërliken më prodhimin e atyre kopjeve.

9.9. Autoriteti kontraktues do t'i sigurojë një ekspert shqyrtues, APP-së, KRPP-së, OSHP-së dhe/ose një paneli shqyrtues, qasje në kopjet e cilitdo aktivitet të prokurimit, duke përfshirë edhe informatat sekrete afariste dhe çfarëdo informata të tjera që kanë të bëjnë me prokurimin, menjëherë pas kërkesës së të mësipërmeve. Autoriteti kontraktues gjithashtu do t'i sigurojë qasje dhe kopje të shënimeve dhe informatave një gjykatë kompetente, nëse qasja ose kopjet e tilla kërkohen nga një urdhër i nxjerrë nga gjykata e tillë. Autoriteti kontraktues menjëherë do të sigurojë qasjen dhe kopjet e kërkuara nga ky nen 9.9, në mënyrë të rregullt, të qetë dhe pa pengesa.

**Neni 10**  
**Informatat sekrete afariste**

10.1. Pa perjudikuar detyrimin për t'u siguruar palëve të interesuara dhe publikut qasje në shënimet e aktiviteteve të tij të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të respektojë dhe të mbajë si sekret informatat e klasifikuara si "informata sekrete afariste" në përputhshmëri me nenin 10

10.2. Informatat që sipas nenit 56.3 duhet të shpallen dhe regjistrohet gjatë hapjes publike të tenderëve nuk mund të klasifikohen si informata sekrete afariste.

10.3. Autoriteti kontraktues mund t'i klasifikojë informatat

e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere:

- a. Që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 63 ose 64 të këtij ligji;
- b. Që operatori përkatës ekonomik t'i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t'i mbajë artikujt e tillë si sekret; dhe
- c. Kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstronjë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik.

10.4. Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas nenit 10.3, do të përgatit versionin e "pastruar" të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit 9.3. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste.

10.5. Nëse dokumenti përmban vetëm informacione që autoriteti kontraktues i ka klasifikuar si informacione sekrete afariste sipas nenit 10.3, dhe prandaj ky autoritet kontraktues vendos që këtë dokument ta largoj nga materiali në të cilin palët e interesuara dhe anëtarët e publikut kanë të drejtë qasjeje sipas nenit 9.3, autoriteti kontraktues duhet të përgatis dhe përfshijë në dokumentacionin në të cilin publiku ka qasje, një përmbledhje të përmbajtjes së përgjithshme të dokumentit sekret. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të përmbledhjes së tillë një njoftim që thotë se; (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar të gjitha informacionet që gjendeshin në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesë të operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) se dokumenti i bashkangjitur

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe se është një përmbledhje e përgjithshme jo sekrete e origjinalit.

- 10.6. Nëse, në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të prokurimit, autoriteti kontraktues kërkon nga një operator ekonomik që të dorëzojë informatat që mbulohen nga neni 63 dhe/ose 64 të këtij ligji, autoriteti i tillë kontraktues në dosjen e tenderit duhet të përfshijë një deklaratë duke i njoftuar operatorët ekonomik se, nëse ata dëshirojnë që informatat në fjalë të trajtohen si informata sekrete afariste, ata duhet të dorëzojnë një kërkesë me shkrim në përputhshmëri me nenin 10.3 të këtij ligji.

#### **Neni 11 Valutat dhe pagesat**

- 11.1. Të gjitha çmimet dhe vlerat e specifikuar në çfarëdo kontrate publike, dosje të tenderit, njoftim, ftesë për tender ose pjesëmarrje, duhet të deklarohen dhe të gjitha pagesat e tyre duhet të bëhen në euro.
- 11.2. Kushtet dhe termet e kontratave publike duhet të jenë në përputhje me praktikën e zakonshme publike dhe afariste për llojin dhe lëndën e veçantë të kontratës përkatëse.

#### **Neni 12 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik**

- 12.1. Autoriteti kontraktues do të përgatisë të gjitha dosjet e tenderëve, njoftimet, ftesat dhe dokumentet e tjera që janë publikuar ose u janë dhënë operatorëve ekonomik gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit që shpjen drejt dhënies së një kontrate ose konkursi të projektimit me vlerë minimale, të vogël ose të mesme, në gjuhën shqipe dhe serbe i cili do të jetë njëlloj identik. Autoriteti kontraktues mundet që gjithashtu t'i përgatisë dokumentet në fjalë edhe në gjuhën angleze.
- 12.2. Autoriteti kontraktues do t'i përgatisë të gjitha dosjet e tenderëve, njoftimet, ftesat dhe dokumentet e tjera që janë publikuar ose u janë dhënë operatorëve ekonomik gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit që shpjen drejt dhënies së një kontrate ose konkursi të projektimit me vlerë të madhe, në gjuhën shqipe, serbe dhe në gjuhën angleze.
- 12.3. Në rast se ka ndryshime (pa përputhshmëri), ndërmjet versioneve në gjuhët e ndryshme të dokumentit të njëjtë, versioni në gjuhën angleze, nëse një i tillë është përgatitur, do të mbizotërojë. Nëse

versioni në gjuhën angleze është përgatitur, fakti se ky version mbizotëron, duhet të deklarohet dhe të shkruhet qartësisht në faqen e parë të të gjitha dokumenteve përkatëse.

- 12.4. Nëse nuk është përgatitur asnjë version në gjuhën angleze, dhe ekziston një pa përputhshmëri (mospajtim), ndërmjet versioneve në gjuhën shqipe dhe serbe që me arsye pritet se do të shkaktojnë paragjyqime materiale rreth aftësisë së një operatori ekonomik që me kohë të dorëzojë një tender të përgjegjshëm ose kërkesë për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues, menjëherë pasi që të zbulojë pa përputhshmërinë e tillë duhet që të përmbushë kërkesat e nenit 51.9 të këtij ligji, dhe t'u ofrojë të gjithë operatorëve ekonomik shpjegimet e nevojshme, si dhe duhet të zgjasë afatet e aplikueshme kohore. Nëse masat e tilla nuk janë të mjaftueshme për të eliminuar paragjykimin e tillë potencial, ose nëse koha e cila është caktuar nga neni 51.9 për përdorimin e masave të tilla ka kaluar, autoriteti kontraktues duhet të anulojë aktivitetin përkatës të prokurimit.

- 12.5. Operatori ekonomik mund të dërgojë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje ose një dokument tjetër që duhet ose lejohet që të arkivohet gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit, në gjuhën shqipe, serbe ose në gjuhën angleze.

- 12.6. Të gjitha dosjet e tenderit, njoftimet, dhe ftesat duhet që hollësisht të theksojnë se operatori ekonomik mundet, siç thuhet në nenin 12.5, të dorëzojë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera që kërkohen ose lejohen për arkivim gjatë ushtrimit të procedurës së prokurimit në gjuhën shqipe, serbe ose në gjuhën angleze.

#### **Neni 13**

##### **Pranuesit e të drejtave të veçanta ose ekskluzive që angazhohen në aktivitete të shërbimeve publike**

Nëse një person ose ndërmarrje, përveç një autoriteti kontraktues – pavarësisht nga statusi i tij ligjor – pranon ose ka pranuar (merë), të drejta të veçanta ose ekskluzive për t'u angazhuar në çfarëdo aktiviteti të shërbimeve publike, personi, ose ndërmarrja e tillë duhet t'i respektojë rregullat dhe procedurat e këtij ligji gjatë dhënies së kontratave me vlerë të mesme ose të madhe, palëve të treta.

#### **Kreu 4**

##### **Rregullat për vlerësimin dhe klasifikimin e Kontratave Publike dhe Konkurseve të Projektimit**

#### **Neni 14**

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17****Klasifikimi i kontratave të përziera**

- 14.1. Nëse një kontratë për furnizim përmban dispozita që kërkojnë nga furnizuesi (t), që të dërgojnë, vendosin edhe/ose instalojnë artikullin/artikujt përkatës, ekzistenca e këtyre dispozitave, nuk do të ndikojë në klasifikimin e kontratës në fjalë si kontratë për furnizim.
- 14.2. Kontrata që përfshin njëkohësisht produktet dhe shërbimet, konsiderohet si kontratë e shërbimeve nëse vlera e parashikuar e shërbimeve e kalon vlerën e parashikuar të produkteve. Nëse në kontratë përfshihen dispozitat mbi dërgimin, vendosjen dhe/ose instalimin e produkteve përkatëse, vlera e parashikuar e aktiviteve të tilla përfshihet në vlerësimin e elementit të produktit të kontratës së tillë.
- 14.3. Kontrata që për lëndë kryesore ka sigurimin e shërbimeve profesionale të ndërtimtarisë (d.m.th, shërbimet arkitektonike dhe/ose të ingjinerit, të lokacionit gjeotek/nik ose gjeodezik, shërbimet hulumtuese, shërbimet për vlerësimin e strukturës ose projektimin e strukturës, mbikëqyrjen e ndërtimtarisë ose shërbimet për menaxhimin e ndërtimit), konsiderohet si kontratë e shërbimeve edhe nëse kontrata e tillë po ashtu mbulon, përveç lëndës së tillë kryesore edhe ushtrimin e një ose më shumë aktiviteve që përcaktohen në përkufizimin e “kontratës së punëve”.
- 14.4. Kontrata që për lëndë kryesore ka ushtrimin e aktiviteve të përmendura në përkufizimin e “kontratës së punëve”, por që po ashtu përfshin sigurimin e shërbimeve të ndërtimtarisë, konsiderohet “kontratë e punëve” nëse shërbimet e tilla janë të nevojshme për përmbushjen e kësaj kontrate.
- 14.5. Kontrata që për lëndë ka njëkohësisht edhe furnizimin e produkteve edhe ushtrimin e aktiviteve të përcaktuara në përkufizimin e “kontratës së punëve” klasifikohet si “kontratë e punëve”, përveç kur aktivitetet e tilla përfshijnë vetëm aktivitetet e vendosjes dhe/ose të instalimit.
- 14.6. Të gjitha kontratat, pavarësisht nga struktura, që i mundësojnë operatorit ekonomik marrjen ose mbajtjen e një përqindje ose lloj tjetër kompensimi, për kryerjen e shërbimeve të shitjes ose mbledhjes në emër të autoritetit kontraktues, duhet të trajtohet si “kontratë për shërbime” që rregullohet nga ky ligj, me kusht që kontratat e tilla për shërbime nuk udhëhiqen nga legjislacioni tjetër i miratuar në mënyrë specifike për kontratat e tilla.

**Neni 15****Llogaritja e vlerës së parashikuar të kontratës për furnizim**

- 15.1. Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për furnizim duhet të jetë e barabartë me çmimin përfundimtar që duhet të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha produktet, shërbimet dhe objektet e tjera që përfshihen në një kontratë të tillë. Çmimi i parashikuar i produkteve, shërbimeve dhe objekteve është çmimi i parashikuar i tyre në ditën e dërgimit të njoftimit të kontratës lidhur me to. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për furnizim, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për produktet, shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, doganat dhe tarifat e tjera.
- 15.2. Në rastin e kontratave për qiradhënie, qiramarrje ose blerje me këste të produkteve, vlera që do të merret si bazë për përcaktimin e vlerës së parashikuar të kontratës është;
- Në rastin e kontratës me afat të caktuar, vlera e gjithëmbarshme e kontratës duke përfshirë mbetjen e vlerës së parashikuar.
  - Në rastin e kontratës me afat të pacaktuar ose kur ekziston dyshimi për kohëzgjatjen e kontratës, vlera mujore e shumëzuar me 48.
- 15.3. Kur kontrata e propozuar përmban një opsion tjetër, baza për llogaritjen e vlerës së parashikuar të kontratës është shuma e gjithëmbarshme e lejuar maksimale e blerjeve, qiramarrjes, qiradhënies ose blerjes me këste, duke përfshirë çfarëdo shumash që tani duhet të paguhet si pasojë e ekzekutimit të klauzolës së opsioneve.
- 15.4. Autoriteti kontraktues nuk do të zgjedh ose përdor metodën e vlerësimit me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 18; dhe asnjë autoritet kontraktues, nuk do të ndajë kërkesën për prokurimi për një sasinë të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 18.

**Neni 16****Llogaritja e vlerës së parashikuar të kontratës për shërbime**

- 16.1. Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për shërbime është e barabartë me pagesën e përgjithshme dhe shumat e kompenzueshme që do të paguhet nga autoriteti kontraktues sipas

kontratës, përgjatë gjithë kohë së zgjatjes së kontratës, duke pasur parasysh dispozitat e këtij neni 16. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për shërbime, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, detyrimet dhe tarifatat e tjera.

16.2. Kur kontrata e propozuar për shërbime përmban një opsion, baza për llogaritjen e vlerës së kontratës merret shuma e gjithëmbarshme e lejuar maksimale që duhet të paguhet sipas kontratës së propozuar për shërbime, duke përfshirë çfarëdo shumash që tani duhet të paguhet si pasojë e ekzekutimit të klauzolës së opsioneve.

16.3. Me qëllim të llogaritjes së vlerës mesatare të kontratës, në të cilën përfshihen shërbimet e sigurimit, shërbimet bankare dhe llojet tjera të shërbimeve financiare, ose shërbimet e projektimit, duhet marrë në konsideratë, kur është e mundshme:

- a. Në rastin e shërbimeve të sigurimit, primi (preminë) e paguar;
- b. Në rastin e shërbimeve bankare dhe shërbimeve të tjera financiare, tarifatat, provizionet, kamatat si dhe llojet e tjera të kompensimit; ose
- c. Në rastin e shërbimeve të projektimit, tarifatat dhe provizionet.

16.4. Kur shërbimet ndahen në disa pjesë më të vogla, dhe secila është lëndë (subjekt), i një kontrate të veçantë, vlera e gjithëmbarshme e parashikuar e të gjitha sasive të tilla duhet të shfrytëzohet për klasifikimin e secilës kontratë sipas nenit 18.

16.5. Në rastin e një kontrate të propozuar të shërbimeve që nuk e cek çmimin e përgjithshëm, vlera që duhet marrë si bazë për llogaritjen e vlerës së parashikuar të kontratës së tillë është si vijon:

- a. Në rastin kontratës me afat të caktuar deri në 48 muaj ose më pak, vlera e përgjithshme e parashikuar e kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj;
- b. Në rastin e kontratës me afat të pacaktuar ose me afat më të gjatë se 48 muaj, vlera e parashikuar mujore e shumëzuar me 48.

16.6. Në raste kur parashikohet në mënyrë të arsyeshme se kontrata e propozuar për shërbime mund të zgjatet, rifillohet ose të pasohet nga një kontratë pasardhëse për shërbime të reja brenda kuptimit të nenit 34.2.c.(iii) baza për llogaritjen e vlerës mesatare të kontratës së tillë të propozuar për

shërbime, është vlera maksimale e mundshme e përgjithshme e cila duhet të paguhet për kontratën e propozuar të shërbimeve, duke përfshirë edhe shumën maksimale të mundshme të përgjithshme që duhet të paguhet për çdo kohëzgjatje, rifillim ose kontratë pasardhëse të tillë të parashikuar në mënyrë të arsyeshme.

16.7. Autoriteti kontraktues nuk do të zgjedhë ose përdorë metoda të vlerësimit, që kanë për qëllim zvogëlimin e vlerës së kontratës për shërbime nën kufirin e përcaktuar në nenin 18; as pala kontraktuese nuk do të bëjë ndarjen e kërkesave të prokurimit për shumën e shërbimeve të ofruara me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për shërbime nën kufirin e përcaktuar në nenin 18.

### Neni 17

#### Llogaritja e vlerës së parashikuar të kontratës së punëve dhe kontratës së pronësisë së paluajtshme

17.1. Vlera e parashikuar e një kontrate të propozuar të punëve ose të pronësisë së paluajtshme është e barabartë me çmimin e parashikuar që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha punët, shërbimet, produktet, pronat e paluajtshme, si dhe lëndët e tjera që mbulohen nga ajo duke përfshirë në rast të një kontrate të punëve, lëndët e nevojshme për ekzekutimin e kontratës në fjalë që duhet ti vihen në dispozicion kontraktuesit të punëve nga autoriteti kontraktues. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar të punëve ose pronësisë së paluajtshme autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për punët, shërbimet, produktet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, doganat dhe tarifatat e tjera.

17.2. Kur një punë nëndahet në disa pjesë, dhe secila prej tyre është lëndë i kontratës së veçantë, vlera e përgjithshme e parashikuar e të gjitha sasive të tilla, duhet të shfrytëzohet për klasifikimin e secilës kontratë, në kuadër të nenit 18.

17.3. Kur kontrata e propozuar e punëve përmban një klauzolë të mundësisë, baza për përcaktimin e vlerës së parashikuar të kontratës merret shuma maksimale e mundshme e përgjithshme që duhet të paguhet në bazë të kontratës së propozuar të punëve, përfshirë çdo shumë që do të duhej të paguhej si rezultat i ushtrimit të klauzolës së mundësisë.

17.4. Kur parashikohet që një kontratë e punëve mund të zgjatet ose rifillohet ose të pasohet nga një

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

kontratë pasardhëse për punë të reja në kuadër të nenit 34.2.d. si bazë për përcaktimin e vlerës së parashikuar të kontratës do të merret shuma maksimale e mundshme e përgjithshme e punëve të mbuluara me kontratë si dhe vlera maksimale e të gjitha punëve të tilla të parashikuara shtesë.

- 17.5. Autoriteti kontraktues nuk do të bëjë ndarjen e punëve ose kontratës së punëve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së punëve ose të kontratës së punëve nën kufirin e caktuar në nenin 18.

**Neni 18****Klasifikimi i kontratës publike sipas vlerës së parashikuar**

- 18.1. "Kontratë me vlerë të madhe" konsiderohet:

- Kontrata e furnizimit ose kontrata e shërbimeve, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe ose mund të pritët që të jetë e barabartë ose më e madhe se 100.000 euro; ose
- Kontrata për punë ose pronë të paluajtshme, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose që me arsye mund të pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se 350.000 euro.

- 18.2. "Kontratë me vlerë mesatare" konsiderohet:

- Kontrata e furnizimit ose kontrata e shërbimeve vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose që me arsye mund të pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se 10.000 euro, por më e vogël se 100.000 euro; ose
- Kontrata për punë ose pronë të paluajtshme, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe se, ose që me arsye mund të pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se 10.000 euro, por më e vogël se 350.000 euro.

- 18.3. Kontratat në vijim konsiderohen "kontrata me vlerë të vogël": Çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose më arsye pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se 1.000 euro, por më e vogël se 10.000 euro.

- 18.4. Kontratat në vijim konsiderohen "kontrata me vlerë minimale": Çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është më e vogël se, ose me arsye pritët që të jetë më e vogël se 1.000 euro.

**Neni 19****Klasifikimi i konkursit të projektimit sipas vlerës**

- 19.1. "Konkurs i projektimit me vlerë të madhe" konsiderohet:

- Konkursi i projektimit që organizohet si pjesë e procedurës që shpjen drejt ose që përfshinë shpalljen e kontratës fituese për shërbime, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose që me arsye pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se 100.000 euro; ose
- Konkursi i projektimit në të cilin shuma e përgjithshme e çmimeve të konkursit dhe e pagesave për pjesëmarrësit është e barabartë me ose më e madhe se, ose me arsye pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se 100.000 euro.

- 19.2. "Konkurs i projektimit me vlerë mesatare" konsiderohet:

- Konkursi i projektimit që organizohet si pjesë e procedurës që shpjen drejt ose përfshinë dhënien e kontratës së shërbimeve vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose me arsye pritët të jetë e barabartë ose më e madhe se 10.000 euro, por më e vogël se 100.000 euro; ose
- Konkursi i projektimit në kuadër të së cilit shuma e përgjithshme e çmimeve dhe pagesave për pjesëmarrësit është e barabartë ose më e madhe se, ose me arsye pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se 10.000 euro por më pak se 100.000 euro.

- 19.3. Konkursi i projektimit që nuk përfshihet në nenin 19.1 ose 19.2 konsiderohet "konkursi i projektimit me vlerë të vogël".

**Neni 19A****Kufizimet për zbatimin e neneve 15-19**

- 19A. 1. Autoriteti kontraktues mund t'i zbatojë nenet 15-19 vetëm për qëllim të klasifikimit të një kontrate publike ose një konkursi projektimi si kontratë me vlerë të madhe, të mesme, të ulët ose minimale. Dispozitat e neneve 15-19 nuk mund të zbatohen për qëllime të tjera.

- 19A. 2. Gjithashtu, të gjitha informatat në lidhje me përllogaritjen specifike ose të përgjithshme të vlerës së një kontrate publike ose një konkursi të projektimit, si dhe të gjitha informatat mbi fondet në dispozicion për financimin e kontratës ose konkursit të projektimit, nuk duhet të zbulohen para asnjë personi deri në përmbylljen e aktiv-

itetit të prokurimit. Mirëpo, autoriteti kontraktues duhet të sigurojë këto të dhëna për APP-në, ekspertin shqyrtues, OSHP-në ose një gjykatë, menjëherë pas kërkesës së këtyre të fundit.

## **Kreu 5**

### **Autorizimi për inicimin e një aktiviteti të prokurimit dhe nënshkrimin e kontratës publike**

#### **Neni 20**

##### **Inicimi i aktivitetit të prokurimit**

- 20.1. Për çdo aktivitet të prokurimit të autoritetit kontraktues, ZKA duhet të caktojë një person që të shërbejë si Zyrtar Autorizues për atë aktivitet të prokurimit. Gjatë caktimit të Zyrtarit Autorizues, ZKA duhet të përmbushë të gjitha kushtet e parapara në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe në Rregullat Financiare të shpallura nga Thesari. Zyrtari Autorizues nuk e inicon aktivitetin e prokurimit përderisa ZKF i autoritetit kontraktues të vërtetojë me shkrim se kushtet e nenit 8 të këtij ligji dhe dispozitat e tjera të zbatueshme të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe Rregullave Financiare, janë përmbushë.
- 20.2. Pas nxjerrjes së vërtetimit me shkrim nga ZKF sipas nenit 20.1, atëherë Zyrtari Autorizues është i autorizuar që të iniciojë aktivitetin e prokurimit. Zyrtari Autorizues e inicon aktivitetin e prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të "Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve" sipas nenit 8 të këtij ligji. Pas dorëzimit të deklaratës së sipër cekur, Zyrtari i Prokurimit e ka autorizimin ekskluziv për kryerjen e aktivitetit të prokurimit.

#### **Neni 21**

##### **Themelimi i departamenteve të prokurimit nga autoritetet kontraktuese**

- 21.1. Çdo autoritet kontraktues duhet të caktojë një person që të shërbejë si zyrtar i prokurimit. Nëse punonjësit e tjerë të autoritetit kontraktues janë shërbyes civil, Zyrtari i Prokurimit po ashtu duhet të jetë shërbyes civil. Dy ose më shumë autoritete kontraktuese që kryejnë numër të kufizuar të prokurimeve mund të caktojnë një person të vetëm si Zyrtar të Prokurimit. Aq sa është e nevojshme, autoriteti kontraktues duhet të sigurojë që Zyrtari i Prokurimit të mbështetet nga një numër i mjaftueshëm i personelit të trajtuar, për ti mundësuar atij kryerjen efikase dhe profesionale të aktivitetit të prokurimit të autoritetit kontraktues në pajtim të plotë me këtë ligj.

- 21.2. Një person mund të shërbejë si Zyrtar i Prokurimit vetëm nëse posedon diplomën universitare dhe "certifikatën profesionale të prokurimit" aktuale dhe të vlefshme. Një diplomë e universitetit mund të zëvendësohet më së paku tre vjet përvojë të konsiderueshme në fushën e prokurimit. Sidoqoftë, kjo kërkesë nuk është e detyrueshme për Zyrtarët e Prokurimit deri me 1 Janar 2008; deri në atë datë, një person mund të angazhohet si Zyrtar i Prokurimit nëse ai/ajo posedon "certifikatën profesionale të prokurimit" aktuale dhe të vlefshme të dhënë nga IKAP ose KRPP.

- 21.3. Asnjë person nuk mund të shërbejë si zyrtar i prokurimit ose si punonjës në Departamentin e Prokurimit nëse ai/ajo konsiderohet si i/e papërshtatshëm për pjesëmarrje në aktivitetet e prokurimit, për shkak të ndonjëres nga dispozitat e nenit 61.2 të këtij ligji

- 21.4. Asnjë person nuk mund të shërbejë si zyrtar i prokurimit ose si punonjës në Departamentin e Prokurimit, përveç dhe përderisa ai/ajo të ketë nënshkruar një deklaratë nën betim se ai/ajo do të ushtrojë detyrat e tij/saj në mënyrë të ndërgjegjshme dhe në përputhshmëri të plotë me këtë ligj.

- 21.5. Çdo autoritet kontraktues do të sigurojë që personi i caktuar si Zyrtar i Prokurimit e përmbushë kërkesën e parashtruar në nenin 21.2, nuk konsiderohet i papërshtatshëm sipas nenit 21.3 dhe e ekzekuton deklaratën e kërkuar nga neni 21.4. Çdo autoritet kontraktues do të sigurojë se të gjithë anëtarët e tjerë të personelit të Departamentit të tij, të Prokurimit nuk konsiderohen të papërshtatshëm sipas nenit 21.3 dhe se ata e ekzekutojnë deklaratën e kërkuar nga neni 21.4.

#### **Neni 22**

##### **Zyrtarët e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit**

- 22.1. Të gjitha aktivitetet e prokurimit të një autoriteti kontraktues duhet të kryhen nga Zyrtari përkatës i Prokurimit, përveç në ato raste kur Qeveria e ka caktuar APP-në për kryerjen e një aktiviteti të caktuar të prokurimit sipas këtij ligji.
- 22.2. Zyrtari i Prokurimit i një autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen nga Departamenti i Prokurimit dhe në përputhshmëri të plotë me këtë ligj dhe me rregullat e prokurimit publik.
- 22.3. Zyrtari i Prokurimit i një autoriteti kontraktues është

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

përgjegjës që menjëherë t'i raportojë KRPP-së mbi aktivitetet e prokurimit të autoritetit përkatës kontraktues që ekzekutohen në një mënyrë që nuk është në pajtim me këtë ligj.

- 22.4. Nëse një Zyrtar i Prokurimit nuk mund të mbajë më atë post për shkaqet e parapara në nenin 21.3, autoriteti kontraktues menjëherë e largon personin e përmendur nga ai post dhe e njofton IKAP-ën dhe KRPP-ën për largimin. Nëse Zyrtari i Prokurimit është shërbyes civil dhe ky person nuk mund të mbajë më postin e tij/saj në shërbimin civil në bazë të ligjit ose rregullave për shërbimin civil, autoriteti kontraktues duhet të njoftojë IKAP dhe KRPP për këtë gjendje. Në të dyja rastet, organi që ka lëshuar "certifikatën profesionale të prokurimit" për këtë person, qoftë ai IKAP-ës ose KRPP-ës duhet që menjëherë të shfuqizojë dhe ta anulojë atë certifikatë.

**Neni 23****Trajnimi i Zyrtarëve të Prokurimit**

- 23.1. Së paku dy herë në vit, IKAP-ja duhet të aranzhojë zhvillimin dhe mbajtjen e një kursi profesional të prokurimit me kohëzgjatje të paktën dhjetë (10) ditë pune. IKAP duhet të sigurojë që kursi të përgatitet dhe mbahet nga një person ose organizatë që ka përvojë substanciale në praktikën e mira ndërkombëtare të prokurimit dhe në sistemin e prokurimit të BE-së. Në bazë të këtij ligji, IKAP është përgjegjëse për angazhimin e personit ose organizatës adekuate për përgatitjen dhe ofrimin e kurseve të tilla. IKAP duhet të kërkojë prej personit ose organizatës në fjalë që të familjarizohet profesionalisht dhe të mbulojë të gjitha aspektet e rëndësishme të këtij ligji.
- 23.2. IKAP-i lëshon "certifikatë profesionale të prokurimit" vetëm për persona të cilët në bazë të testimit objektiv (dhe anonim, aty ku është e mundur), kanë treguar në mënyrë të kënaqshme njohuri të mjaftueshme për ligjin dhe praktikën e prokurimit.
- 23.3. Çdo person i interesuar mund të marrë pjesë në trajnimin profesional të prokurimit. Zyrtari i Prokurimit duhet të ndjekë këtë trajnim së paku një herë në vit dhe autoriteti kontraktues do të sigurojë që zyrtari i prokurimit të jetë në dispozicion gjatë të gjitha ditëve të trajnimit. Autoriteti kontraktues duhet të trajtojë kohën e shpenzuar nga zyrtari i prokurimit në trajnim si orar të zakonshëm pune dhe ta kompozojë atë në lloj sikurse të kishte shpenzuar atë kohë në punë. Autoriteti kontraktues po ashtu mund t'i ofrojë personit në fjalë, në pajtim me aktet e zbatueshme ligjore dhe nënligjore edhe kompensim për shpenzimet që domosdoshmërisht janë

bërë nga personi për pjesëmarrjen në trajnim.

- 23.4. IKAP-i menjëherë ia merr "certifikatën profesionale të prokurimit" cilitdo zyrtari të prokurimit i cili nuk e kalon testimin objektiv. IKAP-i menjëherë e njofton autoritetin kontraktues për këtë zhvillim dhe autoriteti kontraktues menjëherë e largon personin në fjalë nga posti i Zyrtarit të Prokurimit.
- 23.5. Testimi dhe rekomandimi për dhënien ose marrjen e "certifikatës profesionale të prokurimit" i përket organit të pavarur për shqyrtim dhe miratim, i themeluar nga IKAP-i, anëtarët e të cilit janë profesionalisht të kualifikuar për fushën e prokurimit ose fusha të ngjashme.
- 23.6. Kryesuesi i organit vlerësues është përgjegjës për udhëheqjen dhe monitorimin e të gjitha vlerësimeve dhe për sigurimin e transparencës gjatë zbatimit të vlerësimit të drejtë të provimeve sipas standardeve më të mira ndërkombëtare. Kryesuesi siguron që të gjitha shqyrtimet e organit vlerësues të jenë të regjistruara, dhe është përgjegjës për përgatitjen e raportit të provimit dhe listës së rezultateve të atyre që kanë kaluar IKAP-i siguron që raportet dhe listat e tilla të publikohen në faqen e internetit të KRPP-së.

**Neni 24****Nënshkrimi i kontratave publike**

- 24.1. Përveç, siç thuhet në nenin 24.2, zyrtari i prokurimit i një autoriteti kontraktues është i vetmi person i autorizuar që të lidhë ose të nënshkruajë një kontratë publike në emër të autoritetit të tillë kontraktues. Kontrata publike e nënshkruar nga kushto përveç Zyrtarit Prokurues të autoritetit kontraktues është e pavlefshme dhe e pazbatueshme. Kontrata publike e nënshkruar nga zyrtari i prokurimit në kundërshtim me nenin 24.1 ose në kundërshtim me një urdhër ose njoftim të marrë nga OSHP-ja, një panel shqyrtues ose një gjykatë kompetente, po ashtu është e pavlefshme dhe e pazbatueshme.
- 24.2. Nëse Qeveria i cakton APP-së si organ përgjegjës për kryerjen e një aktiviteti të prokurimit, personi i vetëm i autorizuar për përmbylljen ose nënshkrimin e kontratës është zyrtari i prokurimit i APP-së.
- 24.3. Personi i autorizuar që të nënshkruajë sipas nenit 24.1 ose nenit 24.2 mund të nënshkruajë kontratën e tillë vetëm nëse përmbushen kushtet vijuese;
- a. së paku tri (3) ditë pune kanë kaluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës; me kusht që, ky kusht të mos aplikohet për prokurimet urgjente që sipas nenit 34.2a (iv) ose nenit

35.2;

- b. personi në fjalë ka konfirmuar edhe një herë se informatat që gjinden në "Deklaratën e Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve" janë ende të sakta;
  - c. personi i tillë nuk ka asnjë arsye për të besuar se ankesa është dorëzuar ose do të dorëzohet brenda periudhës kohore të specifikuar në nenin 105.2; me kusht që, ky kusht të mos aplikohet nëse Kryetari i OSHP e ka nxjerrë një vendim sipas nenit 107 që thotë se dorëzimi i ankesës nuk do të pengojë ose suspendojë nënshkrimin e kontratës; dhe
  - d. personi në fjalë nuk ka marrë kurrfarë komunikate nga OSHP, një panel shqyrtues ose gjykatë kompetente në të cilën thuhet se kontrata nuk duhet nënshkruar.
- 24.4. Pavarësisht nga dispozitat e tjera të nenit 24, nëse kontrata përkatëse -publike është kontratë me vlerë të madhe, personi që është i autorizuar të nënshkruajë sipas nenit 24.1 ose 24.2 mundet, që për qëllime ceremoniale, t'i lejojë edhe një zyrtari tjetër të lartë publik që nuk është nëpunës civil që të nënshkruajë kontratën në fjalë. Në raste të tilla, personi i autorizuar që të nënshkruajë duhet të sigurojë që kontrata e tillë të përmbajë edhe një vend tjetër të zbrazët për nënshkrimin e dytë. Sidoqoftë, zyrtari i lartë publik në fjalë nuk do të nënshkruajë përderisa personi që është i autorizuar që të nënshkruajë të ketë nënshkruar.

**Neni 25  
(Shfuqizohet)**

**Neni 26  
(Shfuqizohet)**

**PJESA II  
RREGULLAT PËR KONTRATAT PUBLIKE**

**Kreu 1  
Rregullat për specifikimet teknike dhe dosjen e tenderit**

**Neni 27  
Dosja e Tenderit**

- 27.1. Përveç siç parashihet në neni 27.2, autoriteti kontraktues do të përpilojë një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kritere të përzgjedhjes, proce-

durat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, dosja e tenderit duhet të përmbajë një kopje të njoftimit të tillë dhe informatat e tjera të tilla përkatëse që mund të jenë të nevojshme për të qartësuar dhe plotësuar informatat që gjinden në njoftimin e tillë. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të zbatueshme dhe aty ku është e nevojshme, të shfaqë gatishmërinë e tij për të konsideruar variante të ndryshme, në pajtim me nenin 28 dhe 29 të këtij ligji.

- 27.2. Kushtet e dosjes së tenderit sipas nenit 27.1 nuk zbatohen për aktivitet e prokurimit për;(i) kontratat e vlerë minimale ose (ii) kontratat që jepen me procedurën e kuotimit të çmimeve.

**Neni 28  
Specifikimet teknike**

- 28.1. Autoriteti kontraktues do të parashtojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues; (i) do të parashtojë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike.
- 28.2. Autoriteti kontraktues, do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.
- 28.3. Autoriteti kontraktues do të përgatisë specifikimet teknike duke i'u referuar; (i) standardeve të Kosovës që implementojnë një standard Evropian, (ii) standardeve evropiane, (iii) miratimeve teknike evropiane, (iv) specifikimeve të përbashkëta teknike, dhe/ose (v) standardeve ndërkombëtare.
- 28.4. Nëse një standard, specifikim ose miratim i aplikueshëm që kërkohet nga nenit 24 nuk ekziston, ose nëse përdorimi i saj kërkon që autoriteti kontraktues të përdorë materiale ose produkte që nuk janë në përputhshmëri me pajisjet që tashme janë në dispozicion ose nëse përdorimi i atyre materialeve ose produkteve do të shkaktonte shpenzime të tepruara dhe të panevojshme, autoriteti i

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

tillë kontraktues mund të përgatisë specifikacionin e tillë teknik duke u referuar në; (i) standardet e Kosovës, (ii) miratimet teknike kosovare, ose (iii) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet evropiane për standardizim; sidoqoftë, me kusht që referimi i tillë të shoqërohet me fjalët ose "ekuivalent".

28.5. Nëse një standard i aplikueshëm, specifikim, miratim ose referencë teknike që kërkohet nga nenet 28.3 dhe 28.4 nuk ekziston, ose nëse përdorimi i saj kërkon që autoriteti kontraktues të përdorë materiale ose produkte që nuk janë të përshtatshme me pajisjet që tashme janë në dispozicion ose nëse përdorimi i tyre do të shkaktonte shpenzime të tepruara dhe të panevojshme, autoriteti i tillë kontraktues mund të përgatisë specifikacionin e tillë teknik në bazë të kërkesave ekzekutive ose funksionale; me kusht që specifikimi i tillë të jetë mjaft i saktë në mënyrë që të ju lejoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t'i lejoj autoritetit kontraktues ta lidhë kontratën.

28.6. Nëse për një kontratë të punëve nuk mund të zbatohet asnjëri nga standardet evropiane, miratimet teknike evropiane ose specifikimet e përbashkëta teknike, dhe është e pamundur që të përpilohet specifikimi në bazë të kërkesave ekzekutive ose funksionale, atëherë, specifikimi teknik mund të përpilohet duke u mbështetur në ndonjë specifikim teknik kosovar që ka të bëjë me projektimin, metodën e llogaritjes ose ekzekutimit të punëve ose që ka të bëjë me përdorimin e materialit; me kusht që një referim i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent".

28.7. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me nenet 28.3 – 28.6 ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët ose "ekuivalent"

28.8. Nëse tenderuesi e paraqet tenderin e tij, përmes çfarëdo masave të duhura, siç janë; (dosjet teknike ose raport testimi nga një palë e tretë e pavarur), dhe zgjedhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kon-

traktues nuk mund të mënjanojë tenderin me arsyetimin se, prodhimi ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me standardet kosovare që implementojnë standardet evropiane, miratimet teknike evropiane, përkrahjet e përbashkëta teknike, standardet ndërkombëtare, standardet e Kosovës, specifikimet teknike të Kosovës ose miratimet teknike të Kosovës.

28.9. Kur autoriteti kontraktues e ka parashtruar specifikimin teknik për kërkesat ekzekutive ose funksionale, ai nuk mund të përdorë kërkesat e tilla si arsyetim për mënjanimin e tenderit, produktit ose shërbimit që është në përputhshmëri me një standard, specifikim ose miratim teknik të përmendur në nenin 28.3 ose 28.4, nëse standardi, specifikimi ose miratimi tillë trajton kërkesat e njëjta ekzekutive ose funksionale dhe është i përshtatshëm. Tenderuesi duhet të paraqesë në tenderin e tij, në mënyrë më të përshtatshme ( siç është ajo e dosjeve teknike ose raportit të testimit nga një palë e tretë e pavarur), që produkti ose shërbimi, janë në përputhshmëri me standardin, specifikimin ose miratimin që gjithashtu i plotëson funksionet ose ekzekutimin e kërkesave të autoritetit kontraktues.

**Neni 29****Llojet e specifikimeve teknike**

29.1. Nëse kontrata i epet tenderuesit që ka paraqitur tenderin më të leverdishëm, autoriteti kontraktues mund të marrë parasysh edhe ndonjë tender që përputhet me një variant të specifikimit të veçantë dhe i përmbushë kërkesat minimale ekzekutive ose funksionale, ose kushtet minimale të autoritetit kontraktues.

29.2. Autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit do të deklarojë specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga ndonjë variant dhe çfarëdo kërkesë specifike për përdorimin e variantit të tillë.

29.3. Nëse një tenderues nuk mund të propozojë një artikull ose shërbim që përputhet me një variant të një specifikacioni të caktuar teknik, autoriteti kontraktues do të deklarojë këtë në dosjen e tenderit.

**Kreu 2****Llojet dhe zbatueshmëria e procedurave të prokurimit****Neni 30A****Rregullat e përgjithshme**

30A. 1. Gjatë ushtrimit të aktivitetit të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të shfrytëzojë procedurën e

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

hapur sipas nenit 30. Nëse një dispozitë e neneve 31-36 shprehimisht autorizon shfrytëzimin e një procedure tjetër prokurimi, autoriteti kontraktues mund të shfrytëzojë atë procedurë ose procedurën e hapur. Ushtrimi i një procedurë të prokurimit duhet të bëhen në pajtim të plotë me dispozitat e zbatueshme të këtij ligji.

30A. 2. KRPP-ja, do të vendosë rregullat dhe kushtet për zbatimin e secilës procedurë të prokurimit të përcaktuar në nenet 30-36, sipas këtij ligji dhe praktikave të mira ndërkombëtare.

30A. 3. Kurdo që autoriteti kontraktues shfrytëzon një procedurë të përshkruar në nenet 31-34 të këtij ligji, autoriteti kontraktues duhet të përfshijë në dosjen e tenderit një shpjegim të hollësishëm të arsyesimit të përdorur dhe faktorëve të marrë parasysh nga autoriteti kontraktues gjatë procesit të vendosjes se nëse shfrytëzimin i procedurës alternative është i duhur edhe i autorizuar sipas këtij ligji.

30A. 4. Nëse, gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit, pranohen më pak se tre (3) tenderë të përgjegjshëm ose, kur është e zbatueshme, kërkesa për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues duhet të anulojë aktivitetin e prokurimit. Në rastet e tilla, autoriteti kontraktues, nëse ende dëshiron të prokurorë artikujt përkatës duhet të iniciojë një aktivitet të ri prokurimi. Kushtet e këtij neni 30 A 4 nuk zbatohen për aktivitetet e prokurimit që ushtrohen sipas nenit 34.

30A. 5. Pavarësisht nga kërkesat e themeluara nga neni 30A. 4, nëse autoriteti kontraktues përcakton se arsyet e detyrueshme si mos ekzistimi ose një treg me konkurrencë të ashpër, qon deri të mendimi se anulimi i veprimit të prokurimit dhe inicimi i një veprimi të ri të prokurimit nuk do të këtë për pasojë numrin e shtuar të tenderëve ose, aty ku është e aplikueshme, kërkesat për të marrë pjesë, autoriteti kontraktues paraqet vendimin e vet së bashku me një sqarim në APP-ës, dhe APP-ja është kompetente për shqyrtim e këtij vendimi brenda afatit prej pesë(5) ditëve të punës pas pranimit. Brenda kësaj periudhe APP-ja udhëzon autoritetin kontraktues që t'i përmbahet kërkesës nga neni 30A .4 të ligjit në fuqi në rast se sqarimi nuk siguron një bazë bindëse për mosprëmbajtje ndaj kërkesës nga neni 30A. 4. Megjithatë, autoriteti kontraktues i përmbahet kërkesës nga neni 30A. 4 për prokurimet që kryhen në bazë të nenit 35.

30A. 6. Autoriteti kontraktues ka të drejtë të kërkojë nga BRP-ja shqyrtimin e vendimit të APP-së në

bazë të nenit 30A. 5 të Ligjit në fuqi. BRP-ja i jep një kërkesë të tillë prioritet të lartë dhe ka kompetenca që të kthejë vendimin e APP-së nëse konstaton se një vendim i tillë është i paarsyeshëm.

### Neni 30 Procedurat e hapura

Përveç nëse ndonjë dispozitë e neneve 31 – 36, posaçërisht e autorizon përdorimin e procedurave tjera të prokurimit, autoriteti kontraktues do të zgjedhë dhe përdorë procedurat e hapura gjatë zbatimit të aktiviteteve që kanë për qëllim dhënien e një kontrate publike.

### Neni 31 Procedurat e kufizuara

31.1. Autoriteti kontraktues mund të shfrytëzojë procedurat e kufizuara për të kryer një aktivitet prokurimi që çon te dhënia e ndonjë kontrate publike nëse zyrtari i prokurimit, në bazë të faktorëve të verifikueshëm dhe ka qëllime diskriminuese, bën konstatim formal me shkrim se;

- a. artikulli, shërbimi, ose puna përkatëse – për shkak të karakterit të tij/tyre shumë të ndërlikuar ose karakterit special – mund të furnizohen, sigurohen ose ekzekutohen nga një operator ekonomik i cili posedon kapacitetin e duhur teknik, profesional ose financiar, dhe
- b. do të ishte ekonomikisht më e efektshme për autoritetin kontraktues që së pari të shqyrtonte kapacitetin dhe kualifikimet e operatorëve të interesuar ekonomik dhe më pas të ftonte ata që posedojnë kualifikime të caktuara specifike minimale të paraqesin tenderët.

31.2. Konstatimi me shkrim i kërkuar nga neni 31.1 duhet të përfshihet në dosjen e tenderit.

31.3. Pas pranimit të kërkesës për të marrë pjesë, autoriteti kontraktues do të ftojë që të parashtrajnë tenderin ose propozimin të gjithë kandidatët të cilët përmbushin kriteret e përzgjedhjes të caktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit në përputhshmëri me nenin 49 të këtij ligji. Kandidatët që nuk përzgjidhen në këtë mënyrë eliminohen nga pjesëmarrja e mëtutjeshme.

### Neni 32 (Shfuqizohet)

### Neni 33 Procedurat e negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

33.1. Në raste të veçanta, autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pas publikimit të një njoftimi të kontratës për të kryer aktivitetin e prokurimit që shpie te dhënia e një kontrate publike për shërbime, furnizime ose punë, nëse Zyrtari i Prokurimit, në bazë të faktorëve të verifikueshëm dhe pa qëllime diskriminuese, bën konstatim formal me shkrim se natyra komplekse e teknike, financiare ose profesionale e shërbimeve që dëshira është e tillë që;

- a. është e pamundur të përgatiten specifikacionet e kontratës në mënyrë që të lejojnë dhënien e kontratës duke zgjedhur tenderin më të mirë sipas rregullave që drejtojnë procedurat e hapura ose të kufizuara ose,
- b. natyra e shërbimeve, furnizimeve ose punëve, ose rreziqet që përcjellin ato nuk lejojnë caktimin paraprak të çmimit të përgjithshëm.

33.2. Konstatimi me shkrim i kërkuar sipas nenit 33.1 duhet të përfshihet në dosjen e tenderit.

33.3. Pas pranimit të kërkesave për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues do të ftojë të gjithë kandidatët të dorëzojnë një tender/propozim që përmbush kriteret minimale të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit në përputhje me nenet 47-52 të këtij ligji. Kandidatët që nuk përzgjidhen në këtë mënyrë eliminohen nga pjesëmarrja e mëtejshme.

33.4. Autoriteti kontraktues pastaj do të negociojë me çdo tenderues në përpjekje për të përshtatur tenderin/propozimin e tij me kërkesat e caktuara nga autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Gjatë këtij procesi, autoritetit kontraktues do t'i kërkohej të identifikojë dhe t'i jap kontratën tenderuesit që dorëzon tenderin/propozimin më të mirë dhe që është ekonomikisht më i përshtatshëm.

33.5. Gjatë negociatave, autoriteti kontraktues do të sigurojë se të gjithë tenderuesit trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë dhe se të gjithë tenderuesit kanë qasje të barabartë dhe me kohë në informatat e njëjta, me përjashtim të informatave që lidhen me ose që janë pjesë e ndonjë tenderi konkurrues.

33.6. Autoriteti kontraktues mund të marrë masa që procedurat e negociuara të përdoren në faza të njëpasnjëshme me qëllim që të reduktohet me kohë numri i tenderëve të negociuar duke aplikuar kriteret e dhënies që janë specifikuar në njoftimin e kontratës ose dosjen e tenderit.

## Neni 34

## Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës

34.1. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës për të ushtruar aktivitetin e prokurimit vetëm pasi që të jetë pajtuar me nenin 34 dhe të ketë pranuar një autorizim me shkrim nga APP-ja. Nëse autoriteti përkatës kontraktues është APP-ja, atëherë këto gjithashtu do të përputhen me këtë nen 34; sidoqoftë, në raste të tilla, kërkesa për autorizim dhe deklarata që kërkohet nga ky nen 34 do t'i dorëzohet ZKA-së të APP-së dhe autorizimi me shkrim që kërkohet nga ky nen 34 mund të lëshohet vetëm nga ky zyrtar (drejtori).

34.2. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë një autorizim për përdorimin e procedurave të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e:

a. *çfarëdo kontrate publike;*

(i) nëse, për arsye objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike, kontrata duhet të epet një operatori të caktuar ekonomik;

(ii) nëse, për ndonjë arsye të vlefshme ligjore që kërkon respektimin e të drejtave ekskluzive, kontrata mund t'i epet vetëm një operatori të caktuar ekonomik;

(iii) nëse në rast të furnizimit me ujë, rrymë, gaz ose ngrohje, kushtet e kontratës për shkak të kufizimeve objektive dhe atyre të detyrueshme fizike ose teknologjike, mund të përmbushen vetëm nga një operator i ekonomik; ose

(iv) nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen (vishen), veprimeve neglizhence ose të qëllimta, ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

b. *një kontrate për furnizim;*

(ii) për dërgesa shtesë nga furnizuesit fillëstar kur dërgesat e tilla shtesë janë zëvendësime për produktet ose instalimet e dërguara ose kur përbejnë një zgjatje të dërgesave aktuale të

produkteve ose instalimeve nëse ndryshimi i furnizuesit domosdo kërkon nga autoriteti kontraktues që të pranojë produktet ose instalimet që kanë karakteristika të ndryshme teknike ose karakteristika të tjera që janë materialisht të ndryshme nga produktet ose instalimet që janë blerë më parë, dhe këto ndryshime do të rezultojnë në vështirësi domethënëse në përputhshmërinë e produkteve ose instalimeve. Më kusht që, sidoqoftë, ky nen 34. 2b; (i) të mund të përdoret vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për dërgesa shtesë që vetëm, ose së bashku, e kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë për qind (10%) e vlerës së kontratës që mbulonte dërgesat fillestare; ose

(ii) nëse autoriteti përkatës kontraktues është operator i shërbimeve publike, për blerjen e mallrave në një treg mallrash, vend-shkëmbim mallrash apo platformë ose sistem të ngjashëm tregtar.ose

(iii) nëse autoriteti kontraktues në fjalë është operator i shërbimeve publike për blerjen e rrymës elektrike me qëllim të plotësisimit të mungesës së papritur gjatë furnizimit.

c. *një kontrate të shërbimeve:*

(i) që pason nga një konkurs projektimi i ushtruar përmes procedurave të hapura ose të kufizuara, dhe që kërkohej, sipas rregullave në fuqi, t'i epet kandidatit të suksesshëm.

(ii) që do ti epet një autoriteti kontraktues që sipas një akti legjislativ ose rregullativ, normativ ose nën-normativ, e gëzon një të drejtë ekskluzive për të siguruar shërbimin e tillë; ose

(iii) për zbatimin ose ekzekutimin e shërbimeve të reja që janë shumë të ngjashme me shërbimet që mbulohen nga një kontratë e mëhershme e punëve, nëse; (a) kontrata e tillë e re do ti epet operatorit të njëjtë ekonomik të cilit i është dhënë kontrata e mëhershme e punëve, (b) shërbimet e tilla të reja janë të lidhura me projektin e njëjtë themelor për të cilin është dhënë kontrata e tillë e mëhershme e punëve dhe (c) kontrata e tillë e mëhershme e punëve është dhënë përmes procedurave të hapura ose të kufizuara. Me kusht që, sidoqoftë, ky nen 34.2 .c (iii) të mund të përdoret për të mbuluar një apo më shumë kontrata të reja për shërbime që, vetëm ose së bashku kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë për qind (10%) të vlerës së përgjithshme të kontratës së mëhershme të shërbimeve.

d. *një kontrate të shërbimeve ose punëve:*

(i) për zbatimin ose ekzekutimin e shërbimeve ose punëve shtesë që nuk ishin përfshirë

as në konceptimin fillestar të një projekti të punëve të dhënë më parë dhe as të paraqitura në kontratën përkatëse të punëve që është përmblyllur më parë, por të cilat, përmes rrethanave të paparashikuara, janë bërë të nevojshme për kryerjen e shërbimeve ose punëve të përshkruara në projektin ose kontratën e tillë. Me kusht që ky nen 34. 2d,(i) të mund të shfrytëzohet vetëm nëse; (a) kontrata që i mbulon shërbimet ose punët e tilla shtesë ti epet operatorit ekonomik që është duke i ekzekutuar shërbimet ose punët fillestare dhe (b) shërbimet ose punët e tilla shtesë, teknikisht ose ekonomikisht nuk mund të ndahen nga kontrata kryesore pa i shkaktuar dëme autoritetit kontraktues. Më tutje, me kusht që, ky nen 34.2.d (i) të mund të shfrytëzohet vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për shërbime ose punë shtesë që vetëm ose së bashku kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë për qind (10%) e vlerës së kontratës fillestare.

34.3. Autoriteti kontraktues që dëshiron të marrë autorizimin që kërkohej nga neni 34.1 së pari do të përgatisë një deklaratë me shkrim duke konfirmuar se autoriteti kontraktues, pa kurrfarë qëllimi që të diskriminojë kundër ose në favor të një operatori ekonomik, ka konstatuar se një dispozitë e nenit 34.2 e lejon përdorimin e procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktivitetit të tillë. Autoriteti kontraktues në deklaratën që kërkohej nga neni 34. 3a gjithashtu, do të parashtrojë një shpjegim detaj të arsyesimit që është përdorur dhe faktorëve që janë konsideruar nga autoriteti kontraktues gjatë marrjes së këtij vendimi.

34.4. Autoriteti kontraktues pastaj do t'i dorëzojë më shkrim APP-së një kërkesë për autorizim dhe deklaratën e specifikuar në nenin 34.3. APP-ja ose do të lëshojë autorizimin e kërkuar ose do të refuzojë kërkesën me shkrim brenda pesë (5) ditëve të punës pas pranimit të saj.

34.5. APP-ja, mund të autorizojë një autoritet kontraktues që të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës vetëm nëse; (i) APP-ja ka pranuar me shkrim nga autoriteti i tillë kontraktues kërkesën për autorizim dhe deklaratën e specifikuar më lartë, dhe (ii) APP-ja e ka shqyrtuar deklaratën e tillë dhe ka konstatuar se, deklarata e tillë tregon bindshëm se vendimi i marrë nga autoriteti kontraktues është i vlefshëm.

34.6. Kurdo që APP-ja e autorizon një autoritet kontraktues që të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, APP-ja do të

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

publikojë një kopje të autorizimit të tillë në regjistrin e prokurimit publik.

34.7. Nëse APP-ja pranon një kërkesë nga autoriteti kontraktues i cili dëshiron të mbështetet në nenin 34. 2a (iv), APP-ja menjëherë do të klasifikojë si prioritet kthimin e përgjegjës ndaj një kërkesë të tillë. APP-ja mund të autorizojë autoritetin kontraktues që të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës në bazë të paragrafit 34. 2a ,(iv) vetëm nëse APP-ja së pari verifikon me shkrim se, (i) kanë ndodhur ngjarje të cilat shfaqin nevojën për një prokurim urgjent, (ii) ngjarjet e tilla nuk kanë mundur të parashikohen në mënyrë të arsyeshme nga autoriteti kontraktues, (iii) ngjarjet e tilla e bëjnë të nevojshme ekzekutimin e prokurimit përkatës në ritme më të shpejta se sa që e lejojnë afatet kohore të përcaktuara në nenin 44, dhe (iv) ndodhja e ngjarjeve të tilla nuk mund ti atribuohet (vishet), veprimeve ose lëshimeve nga neglizhenca ose të qëllimta të autoritetit kontraktues.

34.8. Edhe nëse APP-ja konstaton se kriteret e specifikuar në nenin 34.7 janë përbushur, nëse prokurimi përkatës ka të bëjë me një kontratë me vlerë të vogël ose të madhe për mallra ose shërbime që i përbushin përshkrimet e specifikuar në nenin 35.1, APP-ja, kurdo është e mundshme, do të refuzojë kërkesën dhe në vend të kësaj do ta urdhërojë (drejtojë), autoritetin kontraktues që të përdorë procedurat e kuotimit të çmimeve, që parashtrohen në nenin 35.

34.9. Ekzekutimi i një procedure të negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës në asnjë mënyrë nuk e liron autoritetin kontraktues nga detyrimi i tij që, (i) të luajë një rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht sa ka të bëjë me çmimet, afatet e pranimit, sasi të, karakteristikat teknike dhe garancionet, (ii) të sigurojë që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi përkatës i tregut dhe (iii) të vlerësojë me kujdes kualitetin e produktit, shërbimit ose punës në fjalë.

**Neni 35****Procedurat për kuotimin e çmimeve**

35.1. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat për kuotimin e çmimeve për të ushtruar një aktivitet të prokurimit që ka për qëllim dhënjen e një kontrate të furnizimeve ose shërbimeve me vlerë minimale ose të vogël nëse; (i) mallrat ose shërbimet përkatëse aktualisht janë në dispozicion nga operatorët ekonomik, (ii) mallrat ose shërbimet përkatëse nuk ka nevojë që të prodhohen ose për-

punohen posaçërisht, në mënyrë që t'i përbushin kërkesat e autoritetit kontraktues, dhe (iii) vetëm ekziston një treg për mallrat ose shërbimet e tilla.

35.2. Autoriteti kontraktues do t'i përdorë procedurat e kuotimit të çmimeve për të ushtruar një prokurim urgjent për dhënjen e një kontratë për furnizim ose shërbime me vlerë të vogël ose të mesme, kur udhëzohet që të veprojnë kështu nga APP-ja, në përputhshmëri me nenin 34.8.

35.3. Autoriteti kontraktues do t'u dërgojë njëkohësisht, së paku tre (3) operatorëve ekonomik një, kërkesë me shkrim për kuotimin e çmimeve dhe, aq sa është e mundshme, sa më shumë operatorëve ekonomik sa është e nevojshme për të siguruar se konkurrenca efektive për kontratën përkatëse nuk dëmtohet.

35.4. Autoriteti kontraktues do t'i zgjedhë operatorët e tillë ekonomik dhe përndryshe të kryejë aktivitetin e prokurimit në një mënyrë që nuk ka për qëllim që të diskriminojë kundër një apo më shumë operatorëve ekonomik.

35.5. Operatori ekonomik që nuk e ka marrë kërkesën për kuotimin e çmimeve që u është dërguar operatorëve të tjerë ekonomik, ka të drejtë që, menjëherë pasi që ta kërkojë, të marrë kërkesën e tillë për kuotimin e çmimeve nga autoriteti përkatës kontraktues. Operatori ekonomik që nuk e ka marrë kërkesën për kuotimin e çmimeve, kërkesë kjo që u është dërguar operatorëve të tjerë ekonomik, gjithashtu ka të drejtë që të dorëzojë një kuotim të çmimeve si përgjegje ndaj kërkesës së tillë, edhe nëse operatori ekonomik e ka marrë kopjen e kërkesës ose informacionin mbi kërkesën për kuotimin e çmimeve nga dikush tjetër dhe jo nga autoriteti kontraktues.

35.6. Kërkesa me shkrim për kuotimin e çmimeve do të; (i) përshkruajë, në përputhshmëri me nenin 28, mallrat ose shërbimet, (ii) informojë të gjithë operatorët ekonomik se kuotimet e tyre duhet të përmbajnë një shumë të përgjithshme të çmimit të saktë që autoriteti kontraktues duhet ta paguajë në mënyrë që të marrë mallrat ose shërbimet përkatëse dhe se shuma e tillë e çmimit të saktë duhet të përfshijë çfarëdo dhe të gjitha tatimet dhe doganat e aplikueshme si dhe të gjitha tarifatat e tjera të transportimit, sigurimit, instalimit ose tarifatat, ngarkesat ose shpenzimet e tjera të çfarëdo lloji; dhe (iii) specifikojë datën deri në të cilën duhet të dorëzohen kuotimet e çmimeve.

35.7. Për një aktivitet të prokurimit që ushtrohet sipas nenit 35.1, data deri në të cilën duhet të pranohet

të gjitha kuotimet e çmimeve duhet që të mos jetë më pak se dhjetë (10) ditë kalendarike nga data e dërgimit të kërkesës për kuoimin e çmimeve. Për prokurimet urgjente që autorizohen sipas nenit 35.2, data në të cilën duhet të pranohen kuotimet e çmimeve duhet të jetë jo më pak se tri (3) ditë pune nga data e dërgimit të kërkesës për kuotimin e çmimeve.

35.8. Nëse, në një aktivitet të prokurimit që ushtrohet sipas nenit 35.1, më pak se tre (3) operatorë ekonomik që rregullisht i ofrojnë mallrat ose shërbimet përkatëse në treg dorëzojnë kuotime të përgjegjshme të çmimeve më shkrim në apo para afatit të fundit kohor të specifikuar në kërkesën për dorëzimin e kuotimeve të çmimit, autoriteti kontraktues do të anulojë aktivitetin e prokurimit. Në rastet e tilla, nëse autoriteti kontraktues ende dëshiron që të prokurorë mallrat ose shërbimet përkatëse, atëherë ai do të fillojë një aktivitet të ri të prokurimit për mallrat ose shërbimet e tilla.

35.9. Operatori ekonomik mund të dorëzojë vetëm një kuotim të çmimeve gjatë aktivitetit përkatës të prokurimit. Operatori ekonomik nuk mund të ndryshojë kuotimin e tij të çmimeve pas që kuotimi i tillë të jetë dorëzuar.

35.10. Për qëllime të aplikueshmërisë së dispozitave të tjera të këtij ligji, kërkesa për kuotim të çmimeve është e barabartë me "ftesën për tenderim".

### Neni 36

#### Procedurat për kontratat me vlerë minimale dhe kontratat e pronës së paluajtshme

KRPP-ja është e autorizuar që në rregullat e prokurimit publik të përcaktojë një procedurë të veçantë për të rregulluar dhënjen e kontratave me vlerë minimale. KRPP, gjithashtu është e autorizuar që të përcaktojë procedura të veçanta për dhënjen e kontratave të pronës së paluajtshme. KRPP, do të sigurojë që procedurat e tilla sigurojnë dhe mundësojnë konkurrencë adekuate, transparente si dhe shfrytëzimin ekonomik të fondeve publike. KRPP, gjithashtu do të sigurojë që procedurat e tilla t'i respektojnë parimet e mos-diskriminimit dhe të gjitha dispozitat e zbatueshme të këtij ligji.

### Neni 36A

#### Kontratat Publike Kornizë

36 A. 1. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedura të hapura apo të kufizuara për të dhënë një kontratë publike kornizë. Kontratat publike kornizë nuk do të mund të jepen duke përdorur çfarëdo procedure tjetër.

36A. 2. Asnjë kontratë publike kornizë nuk do të ketë kohëzgjatje më të madhe se 24 muaj. Kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ripërtërihet.

36A. 3. Nën kontratën publike kornizë, autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që gjatë tërë periudhës së kontratës, dhe duke qenë në përputhje të rreptë me kushtet e një kontrate të tillë, të nënshkruajë kontrata ndihmëse ose të bëjë porosi te tenderuesi i suksesshëm pa i ndjekur procedurat e këtij ligji përkitazi me secilën kontratë ndihmëse të konkluduar (apo urdhër të parashtruar), brenda kontratës publike kornizë. Me kusht që: (i) çdo kontratë ndihmëse e lidhur sipas një kontratë publike kornizë të jetë subjekt i kërkesave të nenit 39 për dhënien e njoftimit dhe kushteve për nënshkrim të përcaktuara në nenin 24, dhe (ii) dhënia e secilës kontratë ndihmëse është subjekt i rregullave të cilat rregullojnë procedurën e shqyrtimit të ankesave të përcaktuara në pjesën VIII.

36A. 4. Autoriteti kontraktues mund të marrë parasysh dhënien e kontratës publike kornizë vetëm nëse janë të pranishme një apo më shumë nga rrethanat e mëposhtme:

- objekt i kontratës janë shërbimet, punët ose mallrat, që nuk kategorizohen si pasuri afatgjate;
- objekt i kontratës janë punimet e vazhdueshme të riparimeve apo të mirëmbajtjes; ose
- Në rastin kur autoriteti kontraktues planifikon të japë disa kontrata identike përgjatë një periudhe që do të mbulohej nga një kontratë publike kornizë ndërsa konkludimi i një kontrate publike kornizë që do t'i mbulonte dy apo më shumë kontrata të tilla do të reduktohej shpenzimet e prokurimit dhe të administrimit të autoritetit kontraktues.

36A. 5. KRPP, është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që të përgatisë dhe të shpallë rregullat dhe procedurat e nevojshme për kontratat publike kornizë. Rregullat dhe procedurat në fjalë duhet: (i) të promovojnë konkurrencën gjatë dhënies së kontratave të tilla; (ii) të sigurojnë transparencën dhe përgjegjshmërinë e procesit, (iii) të respektojnë dispozitat e zbatueshme të këtij ligji mbi koston ekonomike, efikasitetin si dhe parimin e mos-diskriminimit të përcaktuar në nenin 5 dhe 6 të këtij ligji; dhe (iv) të jetë në pajtim me praktikën e mira të vendeve anëtare të UE-së

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17****Kreu 3****Rregullat mbi reklamimin dhe transparencën****Neni 37****Njoftimi paraprak**

37.1. Kur autoriteti kontraktues ka për qëllim dhënien, gjatë periudhës së ardhshme të 12 mujoreve të; (i) një ose më shumë kontratave të furnizimit, që vetëm ose bashkë kanë një vlerë të parashikuar prej 250.000 euro, (ii) një ose më shumë kontratave të shërbimeve që vetëm ose bashkë kanë një vlerë të parashikuar prej 250.000 euro, ose (iii) një ose më shumë kontrata të punëve që vetëm ose së bashku ka një vlerë të parashikuar prej 250.000 euro, autoriteti kontraktues do të përgatisë njoftimin paraprak që përcakton:

- a. Në raste të kontratave të pritura për furnizim, prokurimin e përgjithshëm sipas rajonit të prodhimit nga i cili autoriteti kontraktues synon që të prokurojë brenda periudhës 12 mujore;
- b. Në raste të kontratave të pritura të shërbimeve, vlerën e parashikuar të secilës kategori të shërbimeve të cilën autoriteti kontraktues synon që ta prokurojë brenda një periudhe të tillë 12 mujore; dhe
- c. Në raste të kontratave të pritura të punëve, karakteristikat thelbësore të kontratave të punëve të cilat autoriteti kontraktues synon që ti jep brenda një periudhe të tillë 12 muajsh.

37.2. Njoftimi paraprak do të përgatitet në gjuhën shqipe, serbe si dhe në gjuhën angleze. Autoriteti kontraktues do të sigurojë, që versionet në të gjitha gjuhët të një njoftimi paraprak, janë në përputhshmëri me këtë ligj dhe se përmbajnë informata materialisht identike.

37.3. Në rast të njoftimeve paraprake të përshkruara në nenin 37.1. a ose b, autoriteti kontraktues sa më shpejt që është e mundur dhe pas fillimit të vitit përkatës fiskal do të përgatisë dhe do t'i dërgojë APP-së njoftimin e tillë paraprak.

37.4. Në rast të njoftimeve paraprake që përshkruhen në nenin 37.1.c, autoriteti kontraktues do t'i përgatisë njoftimet e tilla paraprake menjëherë pas marrjes së vendimit që e miraton planifikimin e kontratës përkatëse të punëve.

**Neni 38****Njoftimi i kontratës**

Kur një autoritet kontraktues synon që të ndërmarrë prokurimin duke përdorur procedura të hapura, të kufizuara ose të negociuara pas publikimit të njoftimit të kon-

tratës, autoriteti kontraktues do të përgatisë një njoftim të kontratës në gjuhët e cekura nga neni 12. Autoriteti kontraktues do të sigurojë, që versionet në të gjitha gjuhët të një njoftimi të kontratës, janë në përputhshmëri me këtë ligj dhe se përmbajnë informata materialisht identike.

**Neni 39****Njoftimi mbi dhënien e kontratës**

Nëse autoriteti kontraktues ka dhënë një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura, të kufizuara ose të negociuara, ose procedurat e kuotimit të çmimeve, autoriteti i tillë kontraktues brenda dy (2) ditëve të punës pas dhënies së kontratës së tillë, do të përgatisë njoftimin mbi dhënien e kontratës në gjuhët e cekura në nenin 12. Autoriteti kontraktues do të sigurojë, që versionet në të gjitha gjuhët të një njoftimi për dhënien e kontratës, janë në përputhshmëri me këtë ligj dhe se përmbajnë informata materialisht identike.

**Neni 40****Publikimi i njoftimeve**

40.1. Çdo autoritet kontraktues menjëherë do t'i dorëzojë KRPP-së versionet në të gjitha gjuhët të një njoftimi që është përgatitur sipas nenit 37, 38 ose 39. KRPP do të vendosë rregulla që e rregullojnë dorëzimin e këtyre njoftimeve.

40.2. Brenda dy (2) ditëve të punës pasi që KRPP-ja të ketë pranuar njoftimin në fjalë nga një autoritet kontraktues sipas nenit 40.1, KRPP-ja do t'i publikojë versionet në të gjitha gjuhët e njoftimit në fjalë në faqen e KRPP-së në internet dhe në regjistrin e Prokurimit Publik.

40.3. Autoriteti kontraktues do të publikojë shpalljen e përgatitur në gjuhët e kërkuara në një publikim me tirazh të madh në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe në Kosovë; me kusht që kërkesat e këtij publikimi të mos zbatohen për dhënien e njoftimit për një vlerë të vogël apo minimale të kontratës. Autoriteti kontraktues duhet të përputhet me këtë nen 40.3 brenda tri (3) ditëve të punës pasi që të ketë dorëzuar njoftimin në fjalë në KRPP, siç kërkohet nga neni 40.1. Versionet në të gjitha gjuhët e njoftimit duhet të publikohen në të njëjtën datë, në të njëjtën mënyrë. KRPP do të vendosë rregulla që e rregullojnë publikimin e njoftimeve.

40.4. Autoriteti kontraktues do t'u dërgojë njoftimin për dhënien e kontratës, menjëherë pasi që ky të përgatitet, të gjithë operatorëve ekonomik që e kanë marrë njoftimin për tenderim ose që kanë dorëzuar një kërkesë për pjesëmarrje ose tenderim. Autoriteti kontraktues do t'u dërgojë operatorëve ekonomik njoftimin në fjalë, përmes mjeteve më të

shpejta në dispozicion.

- 40.5. Përveç siç thuhet në nenin 40.4, asnjë njoftim dhe asnjë informatë në një njoftim, nuk mund të bëhen publike ose të zbulohen një personi ose ndërmarje para se të bëhet publikimi i njoftimit në fjalë në përputhshmëri me nenin 40.2 ose 40.3.

#### Neni 41

##### Forma dhe përmbajtja e njoftimeve

Çdo njoftim do të hartohet në përputhje me formularin standard aplikativ të miratuar nga KRPP.

#### Neni 42

##### Rregullat e përgjithshme mbi caktimin e afateve kohore për pranimin e tenderëve ose kërkesave për pjesëmarrje

- 42.1. Çfarëdo afati kohor i caktuar nga autoriteti kontraktues për pranimin e tenderëve, ose kërkesave për pjesëmarrje duhet të jetë i mjaftueshëm për t'u dhënë operatorëve të interesuar ekonomik, kohë të mjaftueshme për të përgatitur dhe dorëzuar dokumentet në fjalë. Gjatë caktimit të një afati të tillë kohor, autoriteti kontraktues do të marrë parasysh qëllimin dhe kompleksitetin e prokurimit përkatës dhe kontratën që do të epet, si dhe nivelin e vështirësisë dhe/ose kompleksitetit të përgatitjes së një tenderi, të përgjegjshëm ose kërkesë për pjesëmarrje.
- 42.2. Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është:
- kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se 40 ditë kalendarike; dhe
  - kur kontrata përkatëse nuk është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se 25 ditë kalendarike.
- 42.3. Gjatë një prokurimi që zbaton procedurat e kufizuara, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve dhe kërkesave për pjesëmarrje që është:

- kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se 25 ditë kalendarike për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe jo më pak se 40 ditë kalendarike për pranimin e tenderëve; dhe
- kur kontrata përkatëse nuk është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se 15 ditë kalendarike për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje.

marrje dhe jo më pak se 20 ditë kalendarike për pranimin e tenderëve.

- 42.4. Gjatë një prokurimi që zbaton procedurat e negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve që është:

- kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se 25 ditë kalendarike për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe jo më pak se 40 ditë kalendarike për pranimin e tenderëve; dhe
- kur kontrata përkatëse nuk është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se 15 ditë kalendarike për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe jo më pak se 20 ditë kalendarike për pranimin e tenderëve.

- 42.5. Gjatë një prokurimi që zbaton procedurat e kuotimit të çmimeve, autoriteti kontraktues do të caktojë një kohë për pranimin e tenderëve siç është cekur në nenin 35.7

#### Neni 43

##### Rregullat e posaçme për përcaktimin e afatit kohor për pranimin e tenderëve të një kontrate publike të përfshira nga një njoftim paraprak

- 43.1. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 42, gjatë një aktiviteti të prokurimit që zbaton procedurat e hapura ose të kufizuara dhe që ka për qëllim një kontratë me vlerë të madhe e cila më parë ka qenë lëndë e njoftimit paraprak, autoriteti kontraktues mund të përcaktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve, që nuk është më i shkurtër se 24 ditë kalendarike nga; (i) në rast të procedurave të hapura, data e publikimit të njoftimit të kontratës përkatëse, ose (ii) në rast të procedurave të kufizuara, data në të cilën ose deri në të cilën të gjitha ftesat për tenderim janë dërguar.
- 43.2. Afatet kohore të përcaktuara në nenin 43.1 mund të përdoren vetëm nëse; (i) njoftimi paraprak në fjalë i përfshin të gjitha informacionet e përcaktuara në formularin standard të miratuar nga KRPP, dhe (ii) data e publikimit të njoftimit të tillë paraprak është jo më pak se 40 ditë kalendarike dhe jo më shumë se 12 muaj, para publikimit të njoftimit të kontratës përkatëse.

#### Neni 44

##### Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

44.1. Nëse ekzistojnë rrethanat që (i) kërkojnë zbatimin e një aktiviteti të prokurimit në raste urgjente, (ii) e bëjnë të pamundur respektimin e afateve kohore të saktësuar në nenin 42 ose nëse është e aplikueshme edhe në nenin 43, (iii) nuk shkaktojnë urgjencat e parashikuara nga neni 34.2 .a (iv), dhe (iv) nuk mund tu atribuohen (vishen), veprimeve ose mosveprimeve të autoritetit kontraktues, autoriteti kontraktues mundet të zbatojë prokurimin me përdorimin e afateve të përshpejtuara kohore që vendosen nga ky nen 44.

44.2. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që përdorë procedurat e hapura të prokurimit, autoriteti kontraktues mund të përcaktojë një afat të caktuar kohor për pranimin e tenderëve që është:

- Nëse kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se 15 ditë kalendrike; ose
- Nëse kontrata përkatëse nuk është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se 10 ditë kalendrike.

44.3. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që përdorë procedurat e kufizuara ose të negociuara, autoriteti kontraktues mund të caktojë një afat kohorë që (i) nuk është më i shkurtër se 15 ditë kalendrik, për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, dhe/ose (ii) nuk është më i shkurtër se 10 ditë kalendrik, për pranimin e tenderëve.

**Neni 45****Fillimi i afatit kohorë për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje të tenderëve**

Afatet kohore të caktuara në nenin 42 - 44, fillojnë si vijon;

- për pranimin e tenderëve në një aktivitet të prokurimit që përdorë procedurat e hapura, në datën e publikimit të njoftimit të kontratës;
- për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje në një aktivitet të prokurimit që përdorë procedurat e kufizuara ose të negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës, në datën e publikimit të njoftimit të kontratës.
- për pranimin e tenderëve në një aktivitet të prokurimit që përdorë procedurat e kufizuara ose të negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës, në datën kur të gjitha ftesat për dorëzimin e tenderit janë dërguar; dhe
- për pranimin e tenderëve në një aktivitet të prokurimit që përdorë procedurat e kuotimit të çmimeve, në datën kur të gjitha ftesat për dorëzimin e kuotimeve janë dërguar;

**Neni 46****Dorëzimi i dosjes së tenderit**

Nëse operatori ekonomik me kohë ka parashtruar një kërkesë për të marrë një dosje të tenderit që i përmbush kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës përkatëse nga autoriteti përkatës kontraktues shprehimisht kërkohet që të ia dorëzojë operatorit përkatës ekonomik dosjen e kërkuar të tenderit, siç vijon;

- nëse afati i caktuar kohorë për pranimin e tenderëve është më shumë se 30 ditë kalendrike, jo më vonë se pesë ditë kalendrike pas pranimit të kërkesës së tillë;
- nëse afati i caktuar kohorë për pranimin e tenderëve është më shumë se 20 ditë kalendrike por më pak se 30 ditë kalendrike, jo më vonë se 4 ditë kalendrike pas pranimit të kërkesës së tillë; dhe
- nëse afati kohorë për pranimin e tenderëve është më i shkurtër se 20 ditë kalendrike, jo më vonë se tri (3) ditë kalendrike pas pranimit të kërkesës së tillë.

**Neni 47****Mënyra e dërgimit të kërkesave për pjesëmarrje**

Kërkesat për pjesëmarrje në një aktivitet të prokurimit që shpjen drejt dhënies së ndonjë kontrate publike, mund të paraqiten në mënyrë elektronike, me shkrim ose telefaks.

**Neni 48****Dërgimi dhe përmbajtja e ftesave dhe kërkesave për kuotimin e çmimeve.**

- Gjatë procedurave të kufizuara, procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës dhe procedurave të kuotimit të çmimeve, autoriteti kontraktues njëkohësisht do t'ju dërgojë të gjithë kandidatëve të zgjedhur ftesën për tenderim.
- Gjatë procedurave të kufizuara dhe të negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës të gjitha ftesat për tenderim do të dërgohen së bashku me dosjen e tenderit, përveç përderisa autoriteti kontraktues ka bërë të mundshme marrjen e dosjes së tenderit në mënyrë elektronike. Nëse autoriteti kontraktues i ka vënë materialet e tilla në dispozicion në mënyrë elektronike, ftesa do të përmbajë informacione të mjaftueshme që t'i mundësojë kandidatit qasje në këtë material.
- Gjatë procedurave të kuotimit të çmimeve, ftesa për tenderim duhet të përmbajë të gjitha informacionet materiale që u nevojiten kandidatëve për të dorëzuar kuota të përgjegjshme të çmimeve.

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

48.4. Forma dhe përmbajtja e secilit tender, dokument ose informatë tjetër dorëzuar kandidatit, duhet të jetë identike me ato që i dorëzohen secilit kandidat tjetër. Asnjë kandidat nuk do të ketë më pak ose më shumë qasje në çfarëdo dokumenti ose informacioni, sesa cilido kandidat tjetër.

48.5. Nëse një aktivitet i prokurimit që përdorë procedurat e kufizuara zbatohet me afate të përshpejtuara kohore sipas nenit 44.3, autoriteti kontraktues do të dërgojë ftesat për dorëzimin e tenderëve në mënyrën më të shpejtë të komunikimit që është e mundur.

**Neni 49****Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes**

49.1. Autoriteti kontraktues duhet të theksojë në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përzgjedhjes që një operator i interesuar ekonomik duhet ti përmbushë për tu konsideruar si i kualifikuar; (i) në rast të procedurave të hapura, për dhënien e një kontrate, ose (ii) në rast të procedurave të kufizuara ose të negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës, për të pranuar një ftesë për tenderim. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për t'i përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e një ftese për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret e përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 61-65.

49.2. Autoriteti kontraktues duhet; (i) të përcaktojë në njoftimin e kontratës, aq sa është e mundur, të gjitha dokumentet dhe informatat e tjera që operatorët e interesuar ekonomik duhet të dorëzojnë së bashku me tenderin apo kërkesën për pjesëmarrje, dhe (ii) të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit, të gjitha dokumentet dhe informatat në fjalë. Të gjitha këto kërkesa për dokumente dhe informata do të kufizohen vetëm në aq dokumente dhe informata sa është e nevojshme për ti lejuar autoritetit kontraktues që të verifikojë se operatori përkatës ekonomik, (i) nuk konsiderohet i papërshtatshëm sipas nenit 61 të këtij ligji, dhe (ii) nëse aplikohet, i përmbush kriteret minimale të përzgjedhjes të saktësuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në asnjë rast njoftimi i kontratës ose dosja e tenderit nuk do të kërkojnë nga operatori i interesuar ekonomik që të dorëzojë dokumente

ose informata që nuk kërkohen ose nuk janë në përputhshmëri me nenet 61-65.

49.3. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen 49 duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

**Neni 50****Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës**

50.1. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit ose se; (i) kontrata do t'i epet operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët ose (ii) kontrata do t'i epet operatorit ekonomik që ka paraqitur tenderin më ekonomik.

50.2. Nëse autoriteti kontraktues ka specifikuar se kontrata publike do t'i epet operatorit ekonomik që ka paraqitur tenderin më ekonomik, autoriteti kontraktues në fjalë duhet të specifikojë në dosjen e tenderit kriteret që merren parasysh gjatë vendosjes së fituesit dhe peshën që i është dhënë secilit kriter. Sa më shumë që është e mundur, autoriteti kontraktues duhet të specifikojë çdo kriter në mënyrë objektive dhe kuantitative si dhe duhet të shprehë peshën që i është dhënë atyre në aspektin monetar. Gjatë specifikimit të kriterëve të tilla, autoriteti kontraktues duhet të sigurojë që kriteret e tilla të jenë të lidhura me lëndët dhe kërkesat e kontratës përkatëse publike.

50.3. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen. Autoriteti kontraktues mund të përcaktojë vetëm kriteret që kanë të bëjnë me; (i) çmimin e tenderit, (ii) kushtet e pagesës, (iii) operimin, mirëmbajtjen dhe shpenzimet e tjera të përditshme, (iv) datën e dërgesës, periudhën e dërgesës ose periudhën e përfundimit, (v) karakteristikat e matshme, të mjedisit ose karakteristika të ngjashme, (vi) dhënien dhe disponueshmërinë e shërbimeve pas shitjes si dhe asistencën teknike, (vii) kushtet e çfarëdo autorizimi, garancie dhe përjashtimi, dhe/ose (viii) kushte të tjera ligjore.

**Neni 51****Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit**

51.1. Gjatë përgatitjes së një tenderi, propozimi ose kuotimi të çmimeve, cilido operator ekonomik mund të bëjë një deklaratë me shkrim për të kërkuar nga autoriteti përkatës kontraktues informata sqaruese

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

- ose shtesë që operatori ekonomik mendon se janë të nevojshme për përgatitjen ose dorëzimin e një tenderi të përgjegjshëm; me kusht që, çfarëdo deklarate e tillë me shkrim të pranohet nga autoriteti kontraktues;
- a. jo më pak se 20 ditë kalendarike para datës së caktuar për pranimin e tenderëve, nëse afati i caktuar kohorë për pranimin e tenderëve është 40 ditë kalendarike ose më shumë;
  - b. jo më pak se 15 ditë kalendarike para datës së caktuar për pranimin e tenderëve, nëse afati i caktuar kohorë për pranimin e tenderëve është 30 ditë kalendarike ose më shumë por më pak se 40 ditë kalendarike;
  - c. jo më pak se 10 ditë kalendarike para datës së caktuar për pranimin e tenderëve, nëse afati i caktuar kohorë për pranimin e tenderëve është 20 ditë kalendarike ose më shumë por më pak se 30 ditë kalendarike; ose
  - d. jo më pak se 6 ditë kalendarike para datës së caktuar për pranimin e tenderëve, nëse afati i caktuar kohorë për pranimin e tenderëve është 10 ditë kalendarike ose më shumë por më pak se 20 ditë kalendarike.
- 51.2. Kërkesa në fjalë mund të dorëzohet në mënyrë elektronike, me shkrim ose me telefaks.
- 51.3. Autoriteti kontraktues do të specifikojë datën deri në të cilën do ti pranojë kërkesat e tilla në dosjen e tenderit, dhe nëse është e aplikueshme, edhe në ftesën për tenderim.
- 51.4. Autoriteti kontraktues menjëherë do të shqyrtojë çfarëdo kërkesë të tillë, për të përcaktuar se nëse apo jo operatorët ekonomik kanë nevojë për informatat sqaruese ose shtesë që ata i kanë kërkuar në mënyrë që të përgatisin një tender të përgjegjshëm.
- 51.5. Nëse autoriteti kontraktues konstaton se operatorët ekonomik nuk kanë nevojë për informatat e kërkuara, autoriteti kontraktues menjëherë do t'i njoftojë operatorët përkatës ekonomik më shkrim mbi refuzimin e kërkesës.
- 51.6. Nëse autoriteti kontraktues konstaton së ndonjëra nga informatat sqaruese ose shtesë të kërkuara nga operatorët ekonomik janë të nevojshme për operatorët ekonomik, autoriteti kontraktues menjëherë dhe njëkohësisht si dhe përmes mjeteve më të shpejta që ka mundësi, do t'u sigurojë informatat e tilla me shkrim të gjithë operatorëve ekonomik që kanë marrë ose kanë pranuar nga autoriteti kontraktues dosjen e tenderit përkatës ose ftesën për tenderim. Autoriteti kontraktues nuk do të zbulojë identitetin e operatorit ekonomik që i ka kërkuar informatat sqaruese.
- 51.7. Nëse, në një aktivitet të prokurimit që përfshin përdorimin e procedurave të hapura, të kufizuara ose të negociuara, autoriteti kontraktues u jep informata sqaruese ose shtesë operatorëve ekonomik, dhe data në të cilën informatat e tilla është më pak se 10 ditë kalendarike nga afati kohor i caktuar për pranimin e tenderëve, atëherë autoriteti kontraktues do të zgjasë afatin e tillë kohor për t'u dhënë operatorëve ekonomik së paku 10 ditë kalendarike, nga data në të cilën epen informatat e tilla, për t'i dorëzuar tenderët e tyre. Nëse operatori ekonomik vetëm e ka dorëzuar një tender, operatorit të tillë ekonomik do ti lejohet që të dorëzojë një amendament për tenderin në fjalë, por amendamenti i tillë kufizohet vetëm në ndryshimet që arsyeshëm janë të lidhura me informatat e tilla sqaruese ose shtesë.
- 51.8. Nëse, gjatë një aktiviteti të prokurimit që përfshin përdorimin e procedurave për kuotimin e çmimeve, autoriteti kontraktues ju ep çfarëdo informata sqaruese ose shtesë operatorëve ekonomik, dhe data në të cilën informatat e tilla epen, është më pak se 5 ditë kalendarike nga afati i caktuar për pranimin e tenderëve, autoriteti kontraktues do të zgjasë afatin në fjalë, për t'i dhënë operatorëve ekonomik së paku 5 ditë kalendarike, nga data në të cilën dorëzohen informatat e tilla, për t'i dorëzuar tenderët e tyre. Nëse një operator ekonomik vetëm e ka dorëzuar një tender, operatorit të tillë ekonomik do t'i lejohet që të dorëzojë një amendament për tenderin në fjalë, por amendamenti i tillë është i kufizuar vetëm në ndryshimet që arsyeshëm kanë të bëjnë me informatat e tilla sqaruese ose shtesë.
- 51.9. Nëse, në çdo kohë para afatit të caktuar kohorë për pranimin e tenderëve, një autoritet kontraktues vendos ose vihet në dijeni – përmes çfarëdo mjeteve – se ndonjë informatë sqaruese ose shtesë i nevojitet operatorëve ekonomik, autoriteti kontraktues do t'u dërgojë atyre informatat e tilla njëkohësisht dhe me shkrim, përmes mjeteve më të shpejta të mundshme, të gjithë operatorëve ekonomik që kanë pranuar nga autoriteti kontraktues dosjen përkatëse të tenderit ose ftesën për tenderim. Në raste të tilla, autoriteti kontraktues do të zgjasë afatin kohor për pranimin e artikujve në fjalë në përputhshmëri me nenin 51.7 ose neni 51.8.

**Neni 52****Njoftimi i kandidatëve dhe tenderuesve të eliminuar**

- 52.1. Kurdo që një autoritet kontraktues e eliminon një kandidat ose tenderues nga pjesëmarrja e më-tutjeshme në aktivitetin e prokurimit, autoriteti i tillë kontraktues duhet që menjëherë të njoftojë kandi-datin ose tenderuesin me shkrim mbi këtë fakt.
- 52.2. Nëse autoriteti kontraktues pranon një kërkesë nga një kandidat i eliminuar i cili kërkon një deklaratë mbi arsyet për të cilat ai është eliminuar, autoriteti kontraktues, brenda 15 ditëve nga data e pranimit të kërkesës në fjalë, do t'i dërgojë kandidatit ose tenderuesit të eliminuar një njoftim ku shpjegohen arsyet përkatëse në përputhshmëri me;
- në rast të eliminimit të kandidatit, njoftimi do të shpjegojë arsyet për refuzimin e kërkesës për pjesëmarrje të atij kandidati.
  - në rast të eliminimit të një tenderuesi që është eliminuar për shkak të parregullsive ose përn-dryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat në një tender të tillë.
  - në rast të një tenderuesi të pasuksesshëm, që ka paraqitur tender të përgjegjshëm, njoftimi do të saktësojë karakteristikat dhe përparësitë për-katëse të tenderit fitues si dhe emrin e tende-ruesit fitues.

#### **Neni 53 Mënyrat e komunikimit**

- 53.1. Përveç gjatë vend-shikimeve ose mbledhjeve para tenderimit, të gjitha komunikimet dhe këmbimet e informacioneve ndërmjet operatorëve ekonomik dhe një autoriteti kontraktues do të bëhen; (i) me shkrim në letër, me faks dhe/ose në mënyrë elek-tronike dhe (ii) në përputhshmëri me të gjitha dis-pozitat e tjera të aplikueshme të këtij ligji.
- 53.2. Nëse autoriteti kontraktues formalisht aranzhon një vend-shikim ose mbledhje para tenderimit për operatorët e interesuar ekonomik, autoriteti kon-traktues mund të komunikojë në mënyrë gojore me një operator të caktuar ekonomik të pranishëm në vend-shikim ose mbledhje para tenderimit, nëse, (i) të gjitha operatorëve të internuar u është dhënë njoftim i arsyeshëm dhe mundësi e arsyeshme për të marrë pjesë në vend-shikim ose në mbledhjen para-tenderimit, (ii) komunikimet gojore bëhen në publik dhe në mënyrë transparente, dhe (iii) menjëherë pas komunikimit të tillë gojor, autoriteti kon-traktues përgatit një përmbledhje të të gjitha aspe-kteve materiale të komunikimit të tillë dhe të njëjtin ja dërgon apo e vë në dispozicion për të gjithë op-eratorët e interesuar ekonomik.
- 53.3. Komunikimi dhe këmbimi i tillë i informacioneve, bëhet në mënyrën me të cilën sigurohet integriteti

i të dhënave dhe sekretit i tenderëve dhe të gjitha informacioneve të dhëna nga operatorët ekonomik dhe që autoriteti kontraktues të mund të shqyrtojë përmbajtjen e të gjitha tenderëve ose kërkesave për pjesëmarrje, vetëm pas skadimit të afateve të caktuara për pranimin e tyre.

## **Kreu 4 Udhëheqja e procedurave të prokurimit**

### **Neni 54**

#### **Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesë-marrësve dhe dhënien e kontratave**

- 54.1. Të gjitha kontratat publike do të epen në bazë të kriterëve të specifikuar në nenin 58 dhe në për-puthshmëri me procedurat e vendosura në atë nen.
- 54.2. Autoriteti kontraktues do të diskualifikojë cilindo kandidat ose tenderues që nuk i ka dorëzuar;(i) certifikatat e dhura ose dëshmitë që konfirmojnë se kandidati ose tenderuesi në fjalë, nuk është i papërshtatshëm sipas nenit 61, (ii) një certifikatë, dokument ose dëshmi të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme është kërkuar nga autoriteti kontraktues sipas nenit 62 me qëllim të verifikimit të përshtatshmërisë profesionale të kandidatit ose tenderuesit, ose (iii) dëshmi të mjaftueshme, siç përshkruhet në nenin 63 dhe 64, që në mënyrë të arsyeshme vërtetojnë se kandidati ose tenderuesi në fjalë i përmbushë kërkesat minimale lidhur me kapacitetin financiar, teknik dhe profesional, të cekura më hollësisht në njoftimin e kontratës në pajtim me nenin 49.
- 54.3. Në rastin e procedurave të kufizuara dhe proce-durave të negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues do t'i zgjedhë kandidatët që do të ftohen për të dorëzuar tender ose propozim, vetëm në bazë të (i) kriterëve të përzgjedhjes të specifikuar në njoftimin e kon-tratës dhe në dosjen e tenderit në përputhshmëri me nenin 49.2 dhe (ii) dokumenteve, informatave dhe/ose dëshmime mbi kualifikimet e dorëzuara nga kandidatët si përgjigje të drejtpërdrejt ndaj kërkesave të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Kandidatët që nuk zgjid-hen në këtë mënyrë eliminohen nga pjesëmarrja e më-tutjeshme. KRPP në rregullat e prokurimit publik do të vendosë një procedurë detale që autoritetet kontraktuese duhet ta respektojnë gjatë përzgjed-hjes në fjalë. KRPP, do të sigurojë që procedura e tillë është, (i) në përputhshmëri me praktikat më të mira ndërkombëtare, (ii) siguron konkurrencë dhe transparencë adekuate, (iii) i zbaton parimin

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

e mos-diskriminimit, (iv) dhe përndryshe është në përputhshmëri me dispozitat aplikative të këtij ligji.

54.4. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohen nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

**Neni 55**  
**Sigurimi i tenderit**

55.1. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejt dhënies së një kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit që të depozitojnë siguri (garantim) për tender. Siguria e tenderit që është depozituar nga tenderuesi do të konfiskohet, në rast se:

- (a) autoriteti kontraktues vendos, duke u bazuar në fakte të verifikuara se tenderuesi në fjalë i ka dhënë autoritetit kontraktues informacione përbajtësish të gabueshme ose mashtroese,
- (b) tenderuesi në fjalë e tërheqë tenderin pas skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të specifikuar në dosjen e tenderit.
- (c) tenderuesit në fjalë i është dhënë kontrata përkatëse në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi pastaj refuzon ose dështon, (i) që të depozitojë çfarëdo sigurie të kërkuar të ekzekutimit që ishte specifikuar në dosjen e tenderit (ii) që të përmbushë çfarëdo kushti tjetër që ishte specifikuar në dosjen e tenderit, para nënshkrimit të kontratës përkatëse, ose (iii) që të ekzekutojë një kontratë që përputhet më kushtet e specifikuar në dosjen e tenderit.

55.2. Nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë për sigurimin e tenderit, kërkesa e tillë do të aplikohet për të gjithë tenderuesit. Autoriteti kontraktues do të refuzojë dhe nuk do të vlerësojë një tender të pranuar nga një tenderues që nuk e ka përmbushur kushtin e depozitimit të sigurisë së tenderit.

55.3. Nëse autoriteti kontraktues vendos që të detyrojë depozitimin e sigurisë së tenderit, shumta e sigurisë së tillë duhet të jetë jo më pak se tri për qind se (3%) dhe jo më shumë se pesë për qind (5%) e vlerës së parashikuar të kontratës publike ose konkursit të projektimit, por sidoqoftë, në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se 1.000 Euro.

55.4. Nëse autoriteti kontraktues vendos kusht për siguri

(garanci) të tenderit, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit:

- a. të gjitha kushtet në lidhje me natyrën, formën, shumën si dhe kushtet e tjera për sigurinë e tenderit; me kusht që, të gjitha kushtet e tilla të jenë në pajtim me këtë ligj dhe rregullat e prokurimit publik;
- b. shumta e saktë e sigurimit të tenderit dhe periudha e nevojshme e vlefshmërisë për sigurimin e tenderit;
- c. afati kohorë për pranimin e sigurimit të tenderit, që është i njëjtë me atë për pranimin e tenderëve; dhe
- d. një deklaratë të rasteve, sipas nenit 55.1, në të cilat siguri i tenderit humbet.

55.5. Sigurimi i tenderit mund të bëhet në para të gatshme apo formë të ngjashme, si p.sh transfero bankar. Sigurimi i tenderit po ashtu mund të bëhet në formë të çekut të vërtetuar, letër krediti ose garancion bankar; sidoqoftë, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit të gjitha kushtet – e parapara në rregullat e prokurimit që duhet ti përmbushë lëshuesi i çekut, letrës së kreditit apo garantimit bankar.

55.6. Çdo autoritet kontraktues do të hapë, në pajtim me Rregullat Financiare, një xhirollogari të veçantë me kamatë në një bankë të licencuar në Kosovë me qëllim të pranimit dhe ruajtjes së fondeve që pranohen si siguri e tenderit ose që pranohen përmes, krediti ose garancioni bankar që është depozituar si siguri e tenderit. Autoriteti kontraktues menjëherë do t'i depozitojë dhe mbajë të gjitha fondet e tilla në xhirollogarinë në fjalë. Autoriteti kontraktues nuk do të kthejë, transferojë, përdorë ose të shfrytëzojë në çfarëdo mënyrë tjetër fondet në fjalë përveç siç autorizohet nga neni 55.7 - 55.9.

55.7. Nëse nuk ka ndodhur asnjë ngjarje që do të shkaktojë konfiskimin e sigurisë së tenderit, siç është cekur në nenin 55.1, autoriteti kontraktues do të kthejë fondet ose dokumentin që është depozituar si siguri e tenderit brenda pesë (5) ditëve pas ndodhjes së cilësdo nga këto ngjarje në vijim:

- b. skadimi i datës së vlefshmërisë së tenderit;
- c. dhënia dhe hyrja në fuqi e kontratës përkatëse publike;
- d. anulimi formal ose përfundimi i aktivitetit të prokurimit para dhënies ose hyrjes në fuqi të kontratës përkatëse publike; ose
- e. tërheqja e tenderit para afatit të fundit kohor për dorëzimin e tenderëve, përveç nëse dosja e tenderit në mënyrë eksplicite thotë se tërheqja e tenderit nuk lejohet.

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

55.8. Nëse autoriteti kontraktues vendos (zbulon), se ka ndodhur një ngjarje që kërkon konfiskimin e sigurisë së tenderit sipas nenit 55.1, autoriteti i tillë kontraktues do të, (i) njoftojë tenderuesin përkatës me shkrim mbi vendimin e tillë. Sidoqoftë, nëse siguria e tenderit në fjalë është deponuar në formë të kredie ose garancioni bankar, autoriteti kontraktues duhet që së pari të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'i marrë fondet përkatëse nga lëshuesi i tyre para se t'i dërgojë tenderuesit njoftimin e kërkuar nga fjalia e mësipërme. Autoriteti kontraktues do t'i lërë fondet e tilla të deponuara në xhirollogarinë e përshkruar në nenin 55.6 përderisa tenderuesi përkatës të ketë shpenzuar pa sukses të gjitha të drejtat e tij për të apeluar kundër vendimit të autoritetit kontraktues. Pasi që tenderuesi t'i këtë shpenzuar pa sukses të drejtat e tij për të apeluar kundër vendimit të tillë, dhe nuk është pranuar asnjë urdhër nga OSHP-ja, një panel shqyrtues ose një gjykatë kompetente që kërkon nga autoriteti kontraktues që të mos bëjë asnjë sistemim tjetër të fondeve në fjalë, autoriteti kontraktues do të:

- a. nëse autoriteti kontraktues u nënshtrohet akteve normative mbi çështjet publike buxhetore ose çështjet e përvetësimeve, trajtojë konfiskimin e depozitit të tillë të sigurisë si gjobë dhe/ose dënim dhe do t'a transferojë fondet e tilla në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në përputhshmëri me dispozitat përkatëse të akteve të tilla; ose
- b. nëse autoriteti kontraktues nuk u nënshtrohet akteve të tilla, transferojë fondet e tilla të konfiskuara në xhirollogarinë e tij të përgjithshme rrjedhëse dhe për qëllime të kontabilitetit dhe tatimore, do t'i trajtojë fondet e tilla të konfiskuara të tenderit, si të ardhura të zakonshme.

**Neni 56****Hapja e tenderëve**

56.1. Tenderët e pranuar gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit që shfrytëzojnë procedurat e parapara në nenet 30-31 duhet të hapen vetëm publikisht. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit vendin dhe kohën e hapjes së tenderëve. Nëse autoriteti kontraktues, në përputhshmëri me këtë ligj e nxjerr një dokument, duke e autorizuar zgjatjen e afatit kohor për dorëzimin e tenderëve, autoriteti i tillë kontraktues, në dokumentin e tillë duhet të specifikojë afat të ri kohor për hapjen e tenderëve. Afati i caktuar për hapjen publike të tenderëve duhet të jetë menjëherë pas afatit të fundit kohor të caktuar për pranimin e tenderëve. Autoriteti kontraktues nuk do të hapë tenderët në çfarëdo vendi tjetër ose në çfarëdo kohe tjetër.

56.2. Të gjithë tenderët që dorëzohen para afatit të fundit kohor për dorëzimin e tenderëve do të hapen në vendin dhe kohën e specifikuar në nenin 56.1. Tenderët që janë dorëzuar pas afatit të fundit kohor nuk do të hapen ose shqyrtohen dhe menjëherë do t'i kthehen të pahapura operatorëve ekonomik që i kanë dorëzuar ato. Çdo tenderues ka të drejtë që të dërgojë një përfaqësues që të vëzhgojë hapjen e tenderëve.

56.3. Zyrtari përkatës i prokurimit e bën hapjen e tenderëve. Gjatë hapjes së çdo tenderi, Zyrtari i Prokurimit do t'u lexojë me zë atyre që janë të pranishëm (i) emrin e tenderuesit, (ii) çmimin e përgjithshëm të tenderit të specifikuar në tenderin e tillë, përveç kur dokumenti përkatës është vetëm komponenti i propozimit teknik të tenderit dypjesësh, dhe (iii) çfarëdo zbritje çmim që është ofruar në tender. Të gjitha informatat që lexohen kështu do të regjistrohen në procesverbalin e hapjes publike të tenderëve, i cili në fund të mbledhjes do të nënshkruhet nga zyrtari përkatës i prokurimit dhe secili përfaqësues i tenderuesit që janë të pranishëm në mbledhje. Procesverbali në fjalë menjëherë do të përfshihet në shënimet mbi aktivitetin e prokurimit që kërkohen nga neni 9.1 i këtij ligji dhe kopjet e procesverbalit në fjalë do t'u dërgohen menjëherë të gjithë tenderuesve.

**Neni 57****Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve**

57.1. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

57.2. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet gramatikore, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve. Autoriteti kontraktues menjëherë do t'i dërgojë tenderuesit përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

57.3. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi që mund të korrigjohen pa pasur nevojë që të ndryshohet ndonjë material ose aspekt i tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kualifikohet, aq sa është e mundur, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

57.4. Autoriteti kontraktues do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët që janë dorëzuar me kohë nga operatorët e përshtatshëm – dhe varësisht nga rasti – të kualifikuar, në mënyrë që të përcaktohet (vendoset), tenderi i suksesshëm. Tenderi i suksesshëm do të zgjidhet në përputhshmëri me nenin 58.

57.5. Përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga neni 57.1 dhe 57.2, asnjë komunikim, diskutim ose negociatë e çfarëdo lloji nuk mund të mbahen ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një operatori ekonomik, në lidhje me një tender të dorëzuar.

57.6. Pavarësisht nga ndalesa e nenit 57.5, autoriteti kontraktues mundet që gjatë një aktiviteti të prokurimit që është duke u zbatuar me procedura të negociuar, të negociojë me operatorin e zgjedhur ekonomik; sidoqoftë, me kusht që KRPP në rregullat e prokurimit publik të vendosë një procedurë detale që autoritetet kontraktuese duhet ta respektojnë gjatë këtyre negociatave. KRPP do të sigurojë që kjo procedurë të jetë (i) në përputhshmëri me praktikën më të mirë ndërkombëtare, (ii) të sigurojë konkurrencë dhe transparencë adekuate (iii) të zbatojë parimin e mos-diskriminimit, dhe (iv) përndryshe, të përputhet me dispozitat e aplikueshme të këtij ligji.

**Neni 58****Kriteret për dhënjen e kontratës**

58.1. Përveç siç thuhet në nenin 58.2 dhe 58.3, autoriteti kontraktues do të ia japë kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët.

58.2. Nëse, në përputhshmëri me nenin 50, autoriteti kontraktues ka specifikuar në dosjen e tenderit se kontrata publike do t'i epet operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin më të favorshëm ekonomik, dhënia e tillë do të bëhet vetëm në bazë të kriterëve dhe peshën e kriterëve të tilla që janë specifikuar në dosjen e tenderit, në përputhshmëri me nenin 50.3.

58.3. KRPP në rregullat e prokurimit publik do të vendosë një procedurë detale që autoritetet kontraktuese duhet ta respektojnë gjatë ekzaminimit,

vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve dhe dhënjen e kontratave publike. KRPP do të sigurojë që procedurat e tilla (i) janë në përputhshmëri me praktikën më të mirë ndërkombëtare, (ii) sigurojnë konkurrencë dhe transparencë adekuate, (iii) zbaton parimin e mos-diskriminimit, dhe (iv) përndryshe është në përputhshmëri me të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij ligji.

**Neni 59****Tenderët jo-normalisht të ulët**

59.1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, në lidhje me lëndën e cilësdo procedurë të prokurimit dhe prandaj tenderi do të ngryset shqetësimin se operatori ekonomik ka dorëzuar një tender të pazbatueshëm, autoriteti kontraktues do t'i dërgojë tenderuesit një kërkesë me shkrim ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas nenit 59.2.

59.2. Autoriteti kontraktues do të marrë parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:

- a. ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
- b. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
- c. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
- d. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

59.3. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas nenit 59.1, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrë të njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.

59.4. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas nenit 59.1, nëse autoriteti kontraktues vendos se ka ende mjaft arsye të forta për besuar se tenderuesi ka dorëzuar një tender të pazbatueshëm, autoriteti kontraktues mundet ose (i) të refuzojë ten-

derin, nëse paraprakisht merr pëlqimin me shkrim nga APP-ja, ose (ii) ia jep kontratën përçatë tenderuesit në fjalë më kusht që tenderuesi të bëjë depozitimin e sigurimit të ekzekutimit sipas nenit 60..

### Neni 59A

#### Përfundimi i aktivitetit të prokurimit

- 59A. 1. Kur autoriteti kontraktues e inicon aktivitetin e prokurimit me publikimin e njoftimit të kontratës, aktiviteti në fjalë mund të përfundohet vetëm për njëërën nga këto arsye:
- aktiviteti i prokurimit rezulton në dhënien e një kontrate publike;
  - njëra nga dispozitat e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit;
  - një urdhër i nxjerrë nga një autoritet kompetent publik në bazë të dispozitave të këtij ligji ose një ligji tjetër kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit;
  - të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; ose
  - para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit.
- 59A. 2. Kur njoftimi i kontratës është publikuar dhe procedura e prokurimit është anuluar pa dhënien e kontratës publike, autoriteti kontraktues duhet që; (i) të publikojë njoftimin e anulimit në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar nga KRPP-ja, dhe (ii) të përfshijë në të dhënat e prokurimit të kërkuara nga neni 9.1 i këtij ligji, një deklaratë me shkrim që parashtron me hollësi arsyet faktike dhe bazën ligjore për anulimin.

### Neni 60

#### Siguria e Ekzekutimit

- 60.1. Autoriteti kontraktues do të kërkojë nga operatori ekonomik të cilit i është dhënë një kontratë që të depozitojë një siguri të ekzekutimit si parakusht për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës së tillë nëse (i) kontrata e tillë është kontratë e punëve (ii) kontrata e tillë është kontratë e shërbimeve për krijimin e programeve kompjuterike, (iii) ekziston rreziku se thyerja e kontratës së tillë do t'i shkaktojë dëme substanciale autoritetit kontraktues dhe/

ose mund të kërkojë që autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, (iv) kontrata përfshin shumë punëtor, nënkontrakturë, dhe/ose furnizues të materialeve që mund të mbesin pa u paguar në rast të thyerjes së kontratës në fjalë nga operatori ekonomik, ose (v) autoriteti kontraktues, pasi që të jetë përputhur me nenin 59, ka mjaft arsye për të besuar se operatori ekonomik e ka dorëzuar një tender të pa-zbatueshëm.

- 60.2. Autoriteti kontraktues do të kërkojë nga operatori ekonomik të cilit i është dhënë ndonjë kontratë me vlerë të mesme ose të madhe, që të depozitojë një siguri të ekzekutimit si parakusht për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës së tillë nëse ekziston rreziku që thyerja e kontratës së tillë do t'i shkaktojë autoritetit kontraktues dëme materiale dhe/ose do të kërkonte nga autoriteti kontraktues që të bëjë shpenzime materiale për përfundimin e kontratës në fjalë.
- 60.3. Autoriteti kontraktues do të sigurojë që shuma e çfarëdo sigurie të ekzekutimit që kërkohet nga neni 60.1 (i) të jetë e barabartë me dhjetë për qind (10%) të vlerës së kontratës dhe (ii) përndryshe është vendosur në një nivel që është në përputhshmëri me praktikën e zakonshme publike dhe afariste të aplikueshme ndaj llojit të veçantë dhe lëndës së kontratës përkatëse.
- 60.4. Autoriteti kontraktues do të sigurojë që shuma e çfarëdo sigurimi të ekzekutimit që kërkohet sipas nenit 60.2 (i) të jetë e barabartë me së paku dhjetë për qind (10 %) të vlerës së kontratës, dhe (ii) përndryshe është vendosur një nivel që është i mjaftueshëm për të mbuluar çfarëdo dëme dhe shpenzime që autoriteti kontraktues me arsye i pret që do të ndodhin në rast të thyerjes së kontratës në fjalë nga operatori ekonomik.
- 60.5. Autoriteti kontraktues do të sigurojë që dosja e tenderit dhe kontrata përkatëse publike të përmbajnë dispozita detale mbi karakterin, formën, shumën, statusin, kushtet, konfiskimin dhe kthimin e çfarëdo sigurie të kërkuar të ekzekutimit. Dispozitat e tilla duhet të jenë në përputhshmëri me praktikën e zakonshme publike dhe afariste për llojin dhe lëndën e veçantë të kontratës publike. Në veçanti, kontrata përkatëse duhet që (i) të kërkojë nga autoriteti kontraktues që t'i sigurojë operatorit ekonomik një njoftim me shkrim mbi çfarëdo pretendim të tij se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën, dhe (ii) t'i japë operatorit ekonomik një afat të caktuar kohor për të dështimin e tillë. Pavarësisht nga e mëparshmeja, kërkesa për depozitimin e sigurisë së ekzekutimit që është vendosur

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

- nga neni 60.1 (v) nuk ka nevojë që të specifikohet në dosjen e tenderit.
- 60.6. Sigurimi i ekzekutimit mund të bëhet në para të gatshme apo formë të ngjashme, si p.sh. transfero-bankar. Sigurimi i tenderit po ashtu mund të bëhet në formë të çekut të vërtetuar, letër krediti ose garancion bankar; sidoqoftë, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit të gjitha kushtet – e parapara në rregullat e prokurimit – që duhet ti përmbushë lëshuesi i çekut, letrës së kreditit apo garantimit bankar.
- 60.7. Në pajtim me Rregullat Financiare, çdo autoritet kontraktues do të hapë një xhirollogari të veçantë me kamatë në një bankë të licensuar në Kosovë me qëllim të pranimit dhe mbajtjes së fondeve si siguri e ekzekutimit ose që janë pranuar në formë të një krediti ose garancioni bankar që është depozituar si siguri e ekzekutimit. Autoriteti kontraktues menjëherë do të depozitojë dhe mbajë të gjitha fondet e tilla në shumën e tillë. Autoriteti kontraktues nuk do t'i kthejë, transferojë, shfrytëzojë osë t'i përdorë në çfarëdo mënyrë tjetër fondet në fjalë, përveç siç është autorizuar saktësisht nga nenet 60.8 - 60.9.
- 60.8. Nëse nuk ka ngjarë asgjë që mund të shkaktojë konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit, autoriteti kontraktues do t'i kthejë fondet ose dokumentet që janë depozituar në formë të sigurisë së ekzekutimit, në përputhshmëri me kushtet e kontratës përkatëse.
- 60.9. Nëse autoriteti kontraktues vendos (zbulon) se ka ndodhur një ngjarje që kërkon konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit, siç është cekur në kontratën përkatëse, autoriteti i tillë kontraktues do të njoftojë operatorin përkatës ekonomik me shkrim mbi vendimin e tillë. Sidoqoftë, në rast se sigurimi i ekzekutimit në fjalë është depozituar në formë të një kredie ose garancioni bankar, autoriteti kontraktues duhet që së pari të marrë të gjitha masat e nevojshme për ti marrë (tërhequr), fondet përkatëse nga lëshuesi i tyre para se t'i dërgojë tenderuesit njoftimin e përmendur nga fjalia para-prake. Autoriteti kontraktues do të depozitojë fondet e tilla në xhirollogarinë e përkthuar në nenin 60.7 përderisa tenderuesi përkatës t'i ketë shpenzuar të gjitha të drejtat e tij për të apeluar kundër vendimit të autoritetit kontraktues. Pasi që tenderuesi t'i ketë shpenzuar pa sukses të drejtat e tij për të apeluar kundër vendimit të tillë, dhe nuk është pranuar asnjë urdhër nga OSHP-ja, një panel shqyrtues ose një gjykatë kompetente që kërkon nga autoriteti kontraktues që të mos bëjë asnjë sistemim tjetër të fondeve në fjalë, autoriteti kontraktues do të:
- nëse autoriteti kontraktues u nënshtrohet akteve normative mbi çështjet publike buxhetore ose çështjet e përvetësimeve, trajtojë konfiskimin e depozitit të tillë të sigurisë së ekzekutimit si gjobë dhe/ose dënim dhe do ta transferojë fondet e tilla në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në përputhshmëri me dispozitat përkatëse të akteve të tilla; ose
  - nëse autoriteti kontraktues nuk u nënshtrohet akteve të tilla, të transferojë fondet e tilla të konfiskuara në xhirollogarinë e tij të përgjithshme rrjedhëse dhe për qëllime të kontabilitetit dhe tatimore, t'i trajtojë fondet e tilla të konfiskuara të tenderit, si të ardhura të zakonshme (përgjithshme) të autoritetit kontraktues.

## **Kapitulli 5**

### **Kërkesat e Përshtatshmërisë**

#### **Neni 61**

#### **Pranueshmëria e kandidatëve ose tenderuesve**

- 61.1. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj:
- ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; ose
  - ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të ndonjë pjese të këtyre të fundit.
- 61.1A. Pavarësisht nga dispozitat e më sipërme, autoriteti kontraktues duhet t'i japë operatorit ekonomik që s'kualifikohet sipas nenit 61.1 të këtij ligji një mundësi për t'i demonstruar autoritetit kontraktues se ai nuk ka arritur ndonjë përparësi në konkurrencë nga pjesëmarrja ose asistenca e tillë. Nëse operatorit ekonomik mund të ia demontojë këtë bindshëm autoritetit kontraktues, atëherë ai nuk shkualifikohet sipas nenit 61.1. Të gjitha vendimet e autoritetit kontraktues për këtë çështje mund të apelojnë para OSHP-së nga operatori ekonomik ose ndonjë palë tjetër e interesuar.
- 61.2. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara;

- a. është dënuar nga një gjykatë kompetente për veprën penale duke përfshirë praktikumin e korrupsionit, larjen e parave, mitosen, shantazh ose aktivitetet e përshkruara ose të ngjashme me ato të përshkruara në nenin 117.1 të këtij ligji, në ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë ose në cilindo vend, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;
  - b. është deklaruar i papërshtatshëm, për shkak të sjelljeve të përmendura më lart, nga çfarëdo banke, institucioni ose organizate e cila ofron fonde për zhvillim të përgjithshëm, investim publik ose rindërtim;
  - c. është dënuar nga një gjykatë kompetente për veprën penale të pjesëmarrjes në një organizatë kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme; ose
  - d. është dënuar nga një gjykatë kompetente për veprën penale të mashtrimit ose të barabartë me mashtrimin;
  - e. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose
  - f. është konstatuar nga OSHP ose një gjykatë kompetente se ka bërë keqinterpretime para autoriteteve publike në Kosovë ose diku tjetër.
- 61.3. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik:
- a. gjatë dy viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent, ose aktualisht është në procedurë (i) të falimentimit, (ii) të pranimit të urdhrit për likuidim ose përmbyllje të aktiviteteve ose administrimit nga gjykata ose (iii) ndonjë procedurë tjetër të ngjashme sipas ligjit të Kosovës ose ndonjë juridiksioni tjetër.
  - b. me vendim të një gjykate kompetente është likuiduar ose është vënë në mbikëqyrje të administratorit;
  - c. aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e tij që siguron kushte të zgjeruara ose të reduktuara të pagimit nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë për shkak se operatori ekonomik më parë ka qenë i paafte që të përmbushë obligimet e tij në afatin e duhur kohor;
  - d. është në një situatë të ngjashme me ato të përshkruara në a, b ose c më lartë, që rrjedhin nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve në vendin ku është themeluar ose në vendin ku zhvillon veprimtarinë e tij afariste;
  - e. aktualisht i nënshtrohet një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon pagesat nga ose për një operatori të tillë ekonomik dhe që rezultojnë në një humbje të tërësishme ose të pjesëshme të te drejtave të operatorit ekonomik për të administruar ose disponuar me pasurinë e tij.
  - f. aktualisht është lëndë e një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon ose redukton pagesat nga ose për operatorët e tillë ekonomik nëse procedurat e tilla gjithashtu mund të rezultojnë në vendimin për falimentimin ose likuidimin e operatorit ekonomik;
  - g. gjatë tri viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë me ndonjë njësi publike, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë ose diku tjetër;
  - h. aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik ose është me vonesë në pagimin e çfarëdo shume ndaj një operatori të shërbimeve në Kosovë për ujë, energji elektrike, gaz ose ngrohje;
  - i. aktualisht është me vonesë për pagimin e tati-meve në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose
  - j. ende nuk është pajtuar me një vendim të lëshuar nga OSHP-ja ose një panel shqyrtues.
  - k. ka vendqëndrim afarist në Kosovë por nuk posedon certifikatën e vlefshme dhe aktuale të regjistrimit, të dhënë nga Regjistri i Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtar në Kosovë.
- 61.4. Periudhat kohore të përcaktuara në këtë nen, ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin ftesës për pjesëmarrje ose tenderim.

## Neni 62

### Përshtatshmëria profesionale

- 62.1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatori ekonomik që kërkon të merr pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në përmbushjen e kontratës publike që të paraqesë dokumentin e lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, tregtar dhe/ose të korporatave të atij vendi.

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

62.2. Nëse lëndë e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshin ofrimin e shërbimeve profesionale, dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose liqenzën e autoritetit publik ose që është anëtar i organizatës së caktuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të ofrojnë dëshmi të arsyeshme se ata kanë autorizimin ose liqenzën e tillë ose se janë anëtarë në vendin e tyre të themelimit ose deklaratën nën betimit se një kërkesë e tillë nuk ekziston në vendin e tyre të themelimit.

**Neni 62A**  
**Provat Shkresore**

62A. 1. KRPP përgatit dhe miraton rregullat lidhur me llojet e dokumenteve, provave dhe/ose deklaratave që operatori ekonomik duhet ti paraqesë për të dëshmuar se ai nuk është i përjashtuar sipas dispozitave të nenit 61 të këtij ligji. KRPP-ja po ashtu duhet të përgatisë dhe miratojë rregulla për llojet e dokumentacionit që autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga një operator ekonomik për të dëshmuar përshtatshmërinë e tij profesionale sipas nenit 62. KRPP-ja duhet të sigurojë që sipas rregullave në fjalë të mos kërkohej rreptësisht paraqitja e dokumente ose deklaratave që nuk janë në dispozicion në vende ose rajone të caktuara. KRPP-ja duhet të sigurojë që rregullat në fjalë në masë të arsyeshme tu lejojnë operatorëve ekonomik paraqitjen e deklaratave nën betim, deklaratave të noterizuara e të ngjashme. Në të gjitha rastet, nga operatori ekonomik kërkohej që të pranojë mundësinë e sanksionimit të tij penal dhe civil si dhe përgjegjësinë e tij për dënimet dhe dëmet, nëse operatori ekonomik me dashje ose nga pakujdesia paraqet një dokument, deklaratë ose raport materialisht të pasaktë ose mashtrues.

62A. 2. Autoriteti kontraktues e s'kualifikon çdo kandidat ose tenderues që nuk paraqet (i) certifikatat ose dëshmitë (vërtetimet) e nevojshme për të treguar ose konfirmuar se ai nuk shkualifikohet sipas nenit 61 të këtij ligji, (ii) certifikatë, dokument ose ndonjë provë tjetër të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme kërkohej nga autoriteti kontraktues sipas nenit 62 të këtij ligji me qëllim të verifikimit të përshtatshmërisë profesionale të kandidatit ose tenderuesit, ose (iii) prova të mjaftueshme, sipas nenit 63 dhe 64 të këtij ligji, që në mënyrë të arsyeshme tregojnë së kandidati ose tenderuesi i plotëson kushtet minimale financiare, teknike dhe profesionale të përcaktuara në dosjen e tenderit ose në njoftimin e kontratës.

62A. 3. Neni i mësipërm 62A. 2, nuk mund të përdoret për shkualifikimin e një kandidati ose tenderuesi kur pamundësia për dorëzimin e dokumenteve nuk është materiale dhe nuk ndikon në ndonjë masë domethënëse në fushëveprimin, cilësinë ose realizimin e mallrave dhe kur nuk ndikon padrejtësisht në pozitën konkurruese të një tenderuesi tjetër, me kusht që, në rast se pamundësia është përgjegjësi e kandidatit ose tenderuesit të cilit autoriteti kontraktues synon të i'a japë kontratën, kandidati ose tenderuesi duhet të marrë masa për paraqitjen e dokumenteve të kërkuara para dhënies së kontratës, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga autoriteti kontraktues.

**Neni 63**  
**Gjendja ekonomike dhe financiare**

63.1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Në përgjithësi, operatorëve ekonomik u lejohej të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim:

- a. raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka;
- b. evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve;
- c. kopjet e certifikuar të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga balancat e gjendjes nëse kërkohej publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose
- d. kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuar nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim.

63.2. Autoriteti kontraktues do të specifikojë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tender ose pjesëmarrje, se cilat nga referencat e sipërpërmendura në nenin 63.1 dhe/ose referencat e tjera kërkohej prej tij.

63.3. Nëse për ndonjë arsye të vlefshme, operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktues, operatorit ekonomik i lejohej që të demonstrojë gjendjen e vetë ekonomike dhe financiare përmes dokumentit tjetër që autoriteti kontraktues, në ushtrimin e diskrecionit të tij të arsyeshëm, e konsideron të përshtatshëm.

**Neni 64****Aftësia teknike dhe/ose profesionale**

- 64.1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në nenin 64.
- 64.2. Gjatë udhëheqjes së procedurave që shpijnë drejt dhënies së kontratës publike në të cilën përfshihet livrimin i produkteve, nga operatorët ekonomik mund të kërkohet që të dëshmojnë aftësinë e tyre teknike përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të produkteve që duhet të furnizohen:
- listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;
  - përshkrimin të pajseve teknike të operatorit ekonomik, masave të sigurimit të cilësisë dhe pajisjeve për zhvillim;
  - shënimit për përfshirjen e teknikëve dhe organeve teknike, pavarësisht se i takojnë ose nuk i takojnë drejtpërdrejt operatorit ekonomik, sidomos të atyre që janë përgjegjës për kontrollimin e cilësisë;
  - mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe/ose fotografive të produkteve që duhet të furnizohen, autenticitetit dhe cilësisë reprezentuese e cila duhet të vërtetohet nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues; dhe/ose
  - certifikatave të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuar që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve, që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse.
- 64.3. Nëse lidhur me procedurat që shpijnë në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet livrimi i produkteve, të gjitha produktet që duhet të furnizohen janë komplekse ose, përpjashimisht, kërkohen për qëllime të posaçme, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës që t'i nënshtrohen një inspektimi me qëllim të verifikimit të kapaciteteve të tyre prodhuese, dhe nëse është e rëndësishme, të pajisjeve të tyre të hulumtimit dhe zhvillimit dhe masat për vërtetimin e cilësisë. Inspektimin e tillë, me shpenzimet e autoritetit kontraktues, mund ta kryej autoriteti kontraktues ose organi kompetent i pavarur në vendin në të cilin themelohet autoriteti ekonomik përkatës.
- 64.4. Në procedurat që shpijnë në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkohen lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të operatorëve ekonomik mund të parashtrohen përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të shërbimeve që duhet të furnizohen:
- kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve;
  - listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë siguri të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave), përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkruar nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë siguri të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;
  - një shënim të personelit teknik ose organeve teknike të përfshira, pavarësisht se a i takojnë ose nuk i takojnë drejtpërdrejt operatorit ekonomik, sidomos për ata që janë përgjegjës për kontrollimin e cilësisë;
  - raportin mbi fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e fundit;
  - raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve;
  - përshkrimin e masave që do të merren nga op-

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

- eratori ekonomik për të siguruar cilësinë dhe pajisjet për hulumtim e zhvillim;
- g. përshkrimin e elementeve të kontratës përkatëse që operatori ekonomik planifikon që t'i nënkontrakttojë; dhe/ose
  - h. informacione tjera përkatëse dhe te duhura.
- 64.5. Nëse, lidhur me procedurat që shpijnë në dhënie e kontratës publike me të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, të gjitha shërbimet që duhet të furnizohen janë komplekse ose, përjashtimisht, kërkohen për qëllime të posaçme, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës që t'i nënshtrohen një inspektimi me qëllim të verifikimit të kapaciteteve të tyre prodhuese, dhe nëse është e rëndësishme, për lehtësirat për hulumtime e zhvillim dhe masat për vërtetimin e cilësisë. Inspektimin e tillë, me shpenzime të autoritetit kontraktues, mund ta kryej autoriteti kontraktues ose organi i pavarur kompetent i pavarur në vendin në të cilin është themeluar operatori ekonomik në fjalë.

- 64.6. Në procedurat që shpijnë në dhënie e kontratës publike në të cilën përfshihet realizimi i projekteve të punëve ose realizimi i aktiviteteve ndërtimore, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshkohet aftësia e tyre teknike dhe profesionale për kryerjen e projekteve të tilla ose realizimin e aktiviteteve të tilla; në veçanti, autoriteti kontraktues mund të kërkojë të dhëna përkitazi me:

- a. kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projekteve të punës ose për realizimin e aktiviteteve ndërtimore;
- b. listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; sa herë që është e mundur, autoriteti kontraktues mund të obligohet që të akordohet me autoritetin publik kompetent në Kosovë ose në vendin tjetër që kopjet e certifikatave përkatëse t'ia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues;
- c. raportin për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet

- teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e projektit të punëve ose përmbushjen e aktiviteteve ndërtimore;
- d. raportin për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e kaluara;
  - e. raportin për teknikët ose të njësitë teknike në të cilët mund të thirret kontraktuesi për zbatimin e projektit të punëve ose realizimin e aktiviteteve ndërtimore, pavarësisht se a i takojnë ose nuk i takojnë operatorit ekonomik; dhe/ose
  - f. informacion tjetër përkatës dhe relevant.

- 64.7. Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tenderim do të specifikojë se cilat referenca (dokumentacione), të saktësuara në këtë nen 64, i nevojiten.

**Neni 65****Standardet për sigurimin e cilësisë**

Po qe se autoriteti kontraktues kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, autoriteti kontraktues do t'u referohet sistemeve për sigurimin e cilësisë që (i) bazohen në standardet përkatëse Kosovare, evropiane ose ndërkombëtare dhe (ii) të certifikuara nga organet që kryejnë veprimtaritë e tyre në pajtim me ato standarde për ushtrimin e aktiviteteve të tyre të certifikimit lidhur me aktivitetet e certifikimit. Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i UE-së. Autoriteti kontraktues po ashtu pranon të dhënat e tjera të besueshme për masat e barasvlershme të sigurimit të cilësisë nga operatorët ekonomik që nuk kanë qasje ose mundësi për sigurimin e certifikatave të tilla brenda afateve të caktuara.

**Neni 66****Grupet e operatorëve ekonomik dhe operatorët e huaj ekonomik**

- 66.1. Grupi i operatorëve ekonomik mund të dorëzojë ftesë për pjesëmarrje ose një tender. Nga asnjëri grup i tillë nuk kërkohet që të marrë përsipër ndonjë formë të veçantë ligjore për të paraqitur tenderin; mirëpo, nga grupi i përzgjedhur mund të kërkohet që të bëjë këtë pasi që të epet kontrata në fjalë, për aq sa kjo është e nevojshme, për përmbushjen e mjaftueshme të kontratës.
- 66.2. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, nga grupi kërkohet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë edhe marrëveshjen për krijimin e atij gru-

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

pi. Të gjitha autoritetet kontraktuese duhet që ta parashtrorj këtë kusht në dosjet e tyre të tenderit.

66.3. Të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe secili veçmas të përgjegjshëm para autoritetit kontraktues për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i epet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Të gjitha autoritetet kontraktuese në dosjet e tyre të tenderit duhet ta përfshijnë një njoftim lidhur me këtë çështje.

66.4. Nëse një operatori ekonomik që ndodhet jashtë Kosovës i jepet një kontratë për kryerjen e shërbimeve ose punëve në Kosovë, dhe ky operator ekonomik nuk është i regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtar të Kosovës, operatori i huaj ekonomik duhet të regjistrohet në regjistrin e sipër cekur brenda një afati të arsyeshëm kohor pas dhënies së kontratës. Regjistrimi tillë nuk është me efekt paragjykes për operatorë ekonomik të jashtëm.

### PJESA III RREGULLAT PËR KONKURSET E PROJEKTIMIT

#### Neni 67 Dispozitat e përgjithshme

67.1. Rregullat për organizimin dhe udhëheqjen e një konkursi për projektim duhet të jenë në përputhshmëri me dispozitat e përcaktuara në këtë pjesë (pjesa III). dhe ato do t'u komunikohen të gjithë personave dhe ndërmarrjeve që i përgjigjen njoftimit për konkursin e projektimit.

67.2. Konkursi i projektimit do të ushtrohet në të njëjtën mënyrë, dhe me të njëjtat afate kohore siç ushtrohen aktivitetet e prokurimit për kontratat me vlerë të madhe që zbatojnë procedurat e hapura ose të kufizuara.

67.3. Nëse, pa kurrfarë qëllimi që të diskriminojë në favor ose kundër një personi ose ndërmarrje, autoriteti kontraktues vendos se; (i) konkursi i nevojshëm i projektimit mund të sigurohet, furnizohet ose ekzekutohet nga personi ose ndërmarrja me kualifikimet adekuate profesionale ose teknike dhe (ii) autoriteti i tillë kontraktues do të pranojë vetëm konkurset e dorëzuara nga personat ose ndërmarrjet që i posedojnë kualifikimet e caktuara minimale, autoriteti kontraktues do t'i vendosë kushtet për kualifikimet e tilla në mënyrë të qartë, objektive dhe jo-diskriminuese dhe do t'i publikojë të gjitha

kërkesat e tilla në njoftimin për konkursin e projektimit.

#### Neni 68 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj pjese vlejné për të gjitha konkurset e projektimit të përshkruara në nenin 19 të këtij ligji.

#### Neni 69 Njoftimi mbi konkursin e njoftimit

Kur autoriteti kontraktues planifikon të mbajë një konkurs për projektim, autoriteti kontraktues do t'ë përgatisë njoftimin mbi konkursin e projektimit në gjuhët e cekura në nenin 12 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues menjëherë ia paraqet KRPP-së të gjitha versionet gjuhësore në një njoftim të tillë.

#### Neni 70 Njoftimi mbi rezultatet e konkursit të projektimit

Autoriteti kontraktues që ka mbajtur konkursin e projektimit, duhet që brenda dy (2) ditëve të punës pas përfundimit së konkursit në fjalë të përgatisë një njoftim lidhur me rezultatet e konkursit të projektimit në gjuhët e cekura në nenin 12. Autoriteti kontraktues menjëherë ia paraqet KRPP-së të gjitha versionet gjuhësore në një njoftim të tillë.

#### Neni 71 Publikimi i njoftimeve për konkursin e projektimit

71.1. Rregullat që drejtojnë publikimin e një njoftimi për konkursin e projektimit janë të njëjta me rregullat e parashtruara në nenin 40 që e drejtojnë publikimin e njoftimeve të kontratës për kontratat që e kanë vlerën e njëjtë me konkursin përkatës të projektimit.

71.2. Rregullat që drejtojnë dërgimin dhe publikimin e një njoftimi mbi rezultatet e konkursit të projektimit janë të njëjta me rregullat e parashtruara në nenin 40 që drejtojnë dërgimin dhe publikimin e njoftimit për dhënjën e kontratës, për kontratat që e kanë vlerën e njëjtë me konkursin përkatës të projektimit.

71.3. Përveç për njoftimet mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i janë dërguar një pjesëmarrësi nga autoriteti kontraktues, asnjë njoftim dhe asnjë informacion në një njoftim, nuk mund të bëhen publike ose të zbulohen para një personi ose ndërmarrjeje, para publikimit të tij në përputhshmëri me këtë nen 71.

#### Neni 72

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

**Formulari dhe përmbajtja e njoftimeve për konkur-  
sin e projektimit**

Çdo njoftim do të përpilohet dhe publikohet në pajtim me formularin e aplikueshëm standard që miratohet nga KRPP.

**Neni 73  
Mjetet e informimit**

- 73.1. I tërë komunikimi dhe këmbimi i informacioneve i përmendur në këtë pjesë mund të kryhet përmes letrës, faksit ose mjeteve elektronike, varësisht sipas zgjidhjes së autoritetit kontraktues.
- 73.2. Komunikimi dhe këmbimi i informacioneve të përfshira në kuadër të kësaj pjese do të bëhet në mënyrën me të cilën sigurohet mbrojtja e tërësisë dhe sekretit të të gjitha informacioneve të dorëzuara nga pjesëmarrësit, dhe mundësinë që autoriteti kontraktues të mund të studiojë përmbajtjen e të gjitha planeve ose projekteve pas skadimit të afateve të caktuara për pranimin e tyre.
- 73.3. Autoriteti kontraktues do të sigurojë që njoftimi për konkursin e projektimit dhe rregullat e specifikuara në nenin 67.1 të cekin se, nëse planet ose projektet paraqiten përmes mjeteve elektronike, dërguesi është i detyruar që t'i paraqes autoritetit kontraktues origjinalin fizik ose kur është e përshtatshme kopje të të gjitha dokumenteve, certifikatave, dëshmimeve dhe deklaratave që kërkohen nga autoriteti kontraktues jo më vonë se në afatin e caktuar për pranimin e planeve ose projekteve

**Neni 74  
Përbërja dhe vendimet e jurisë**

- 74.1. Juria përbëhet nga një numër tek, por në asnjë rast më pak se tre (3) persona fizik. Këta persona do të caktohen nga Zyrtari i Prokurimit i autoritetit kontraktues dhe ata nuk mund të jenë të anëtarësuar në ose të ndërlidhur me ndonjërin nga pjesëmarrësit në konkurs. Nëse nga pjesëmarrësit kërkohet që të posedojnë ndonjë kualifikim të posaçëm profesional, së paku një e treta e anëtarëve të jurisë duhet që po ashtu të posedojnë atë kualifikim ose barasvlerën e tij.
- 74.2. Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kriterëve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit. Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë.
- 74.3. Asnjë person jashtë jurisë nuk mund të ndikojë ose të tentojë të ndikojë në vendimet e jurisë ose në opinionin e cilitdo nga anëtarët e jurisë.

- 74.4. Personave që nuk janë anëtarë të jurisë do t'u zbulohet vetëm vendimi i jurisë. Diskutimet e jurisë dhe opinionet e anëtarëve të jurisë gjatë diskutimeve të tilla do të mbahen si sekret nga të gjithë anëtarët e jurisë. Asnjëri nga anëtarët e jurisë nuk do të zbulojë përmbajtjen e diskutimeve të jurisë para një personi tjetër që nuk është anëtar i jurisë, përveç kur kërkohet nga një urdhër me shkrim nga KRPP-ja, OSHP, një panel shqyrtues ose një gjykatë kompetente.

**PJESA IV  
[Shfuqizohet]****Nenet 75 – 80  
[Shfuqizohet]****PJESA V****KOMISIONI RREGULLATIV I  
PROKURIMIT PUBLIK****Neni 81  
Krijimi i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik**

- 81.1. Në bazë të këtij ligji themelohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit i quajtur Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ("KRPP"). KRPP-ja është përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të dhëna sipas këtij ligji për përgatitjen dhe veprimin e rregullave të prokurimit dhe sistemit të prokurimit publik në Kosovë.
- 81.2. KRPP është agjenci e pavarur rregullatore, që do të thotë se asnjë zyrtar publik nuk mund të ushtrojë ose të përpiqet të ushtrojë ndikim në KRPP në lidhje me ndonjë vendim të caktuar operacional apo rregullativ të KRPP-së.
- 81.3. KRPP është autoritet publik dhe organizatë buxhetore. KRPP është subjekt i të gjitha dispozitave të zbatueshme të ligjeve dhe rregulloreve të Kosovës sikurse autoritet e tjera publike ose organizatat buxhetore.
- 81.4. Përveç siç është përcaktuar në dispozitat kalimtare të nenit 89A. 2 të këtij ligji, KRPP i ekzekuton vetëm autorizimet, kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj.

**Neni 82**

**Funksionet themelore të KRPP-së**

82.1. KRPP është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, dhe i ushtron funksionet që i jepen nga ky ligj.

82.2. Përveç çështjeve të parapara më lartë, KRPP ka përgjegjësinë dhe autorizimin që:

- a. të vendosë rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin adekuat të këtij ligji nga autoritetet kontraktuese si dhe rregulla për përdorimin dhe ekzekutimin e secilën nga procedurat e përcaktuara në nenet 30-36 të këtij ligji; me kusht që, këto rregulla të jenë në përputhje me kërkesat dhe parimet e përcaktuara në këtë ligj si dhe çfarëdo kërkesë të detyrueshme të UE-se për prokurim;
- b. të përgatisë dhe shpërndajë doracakë (manuale), të prokurimit, udhëzues, formularë dhe modele standarde për dokumentet e tenderit dhe të kontratave sipas këtij ligji në dobi të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik;
- c. të përforcojë dijen e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për legjislacionin e prokurimit publik si dhe objektivat, procedurat dhe metodat e tij;
- d. t'u japë ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji si dhe për të çdo dokument që nxirret nga KRPP;
- e. të nxjerrë dhe publikojë interpretime me shkrim për autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji ose ndonjë dokumenti të nxjerrë nga KRPP-ja;
- f. të krijojë dhe të mirëmbajë një regjistër elektronik të Prokurimit Publik që shërben si vend për ruajtjen e kopjeve elektronike të të gjitha njoftimeve, ftesave, deklaratave, dosjeve të tenderit, raporteve, ankesave dhe vendimeve të arkivuara ose të nxjerra në lidhje me çdo aktivitet prokurimi të kryer ose të iniciuar nga një autoritet kontraktues;
- g. të krijojë sisteme manuale dhe elektronike për monitorimin e zbatimit të këtij ligji nga ana e autoriteteve kontraktuese, duke përfshirë përgatitjen e formularëve të raportimit që duhet të plotësohen nga të gjitha autoritetet kontraktuese subjekte të këtij Ligji;
- h. të grumbullojë, analizojë dhe publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat publike të dhëna;
- i. për çdo vit kalendarik të përgatisë dhe dorëzojë

në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji, raport ky që dorëzohet jo më vonë se në fund të shkurtit të vitit vijues kalendarik;

- j. të krijojë dhe mirëmbajë një faqen informative në internet që i ofron publikut qasje të pa kufizuar në; (i) këtë ligj dhe gjithë legjislacionin sekondar të nxjerrë sipas këtij ligji, (ii) interpretimet dhe dokumentet e përcaktuara në këtë nen 82, dhe (iii) të gjitha informacionet që përmbahen në regjistrin e Prokurimit Publik;
- k. të zhvillojë një sistem elektronik informativ në mbarë Kosovën për të përmirësuar publikimin e njoftimeve të kërkuara nga ky ligj dhe për të publikuar dokumentet e tenderit;
- l. të mbështesë IKAP dhe autoritetet tjera publike të trajnimit dhe arsimimit për të siguruar arritjen dhe mbajtjen e një niveli të lartë kompetence në radhët e Zyrtarëve të Prokurimit dhe profesionistëve të tjerë të prokurimit për zbatimin e praktikave të mira të prokurimit dhe për respektimin e këtij ligji;
- m. të fillojë dhe mbështesë zhvillimin e prokurimit elektronik dhe komunikimit brenda fushës së prokurimit publik;
- n. të përgatisë dhe mbajë një listë të autoriteteve kontraktuese që i identifikon të gjitha entitetet që janë subjekt i këtij ligji, me kusht që nëse KRPP-ja nuk e përfshin një entitet në këtë listë, kjo (mos-përfshirja) të mos vendosë çështje se nëse entiteti është jo autoritet kontraktues në kuptim të këtij ligji; dhe
- o. të ndërveprojë dhe të bashkëpunojë me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit për çështjet që lidhen me prokurimin publik.

**Neni 83****Funksionet e vëzhgimit dhe të mbikëqyrjes të KRPP-së**

83.1. KRPP ka gjithashtu autoritetin dhe përgjegjësinë të vëzhgojë dhe mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të nxjerra nga KRPP sipas autorizimit të këtij ligji.

83.2. Për këtë qëllim, KRPP-ja përgatit dhe zbaton një metodologji dhe mekanizëm të përshtatshëm raportimi të mbështetur nga një sistem elektronik i menaxhimit të informacionit që i mundëson KRPP-së (i) të vëzhgojë zbatimin e këtij ligji; (ii) të përgatisë raporte mbi rezultatet dhe zbatimin që identifikojnë përparësitë dhe dobësitë në zbatimin e këtij ligji ose sistemit të prokurimit; (iii) të identifikojë ato fusha që kanë nevojë të përmirësohen dhe zhvillo-

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

hen, (iv) të përgatisë raportet vjetore që kërkohen nga ky ligj në mënyrë që të japin një vlerësim të përgjithshëm por të saktë të gjendjes së sistemit kombëtar të prokurimit si dhe vlerësime të veçanta të shkallës së përputhjes/mospërputhjes nga autoritetet individuale kontraktuese; dhe (v) të bëjë rekomandimet e duhura për ndryshimin e legjislationit primar dhe sekondar të prokurimit.

**Neni 84**  
**[Shfuqizohet]**

**Neni 85**  
**Shfuqizohet]**

**Neni 86**  
**Emërimi i anëtarëve**

- 86.1. KRPP-ja, përbëhet prej tre (3) anëtarëve. Përveç siç parashikohet në dispozitat kalimtare të nenit 89A. 1 të këtij ligji, të gjithë anëtarët emërohet në përputhje me këtë nen 86 për një mandat prej pesë (5) vjetësh, dhe mund të riemërohen vetëm një herë.
- 86.2. Kryetari dhe anëtarët e KRPP-së propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi. Gjatë propozimit të personave në fjalë, Qeveria duhet të respektoj kërkesat për anëtarësim, të specifikuar në Nenet 86.3 – 86.4.
- 86.3. Asnjë person nuk mund të propozohet, emërohet ose të shërbejë si anëtar i KRPP-së nëse; (i) ai/ajo nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit për ndonjë arsye të paraparë në nenin 61.2, ose (ii) prej 1 Janarit 2008 dhe më tutje, ai/ajo nuk posedon certifikatën profesionale të prokurimit të vlefshme dhe aktuale të lëshuar nga IKAP. Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurojë që asnjë person i tillë të mos propozohet ose emërohet për anëtar në KRPP.
- 86.4. Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurojnë që çdo person i propozuar për anëtar të KRPP-së të përbushë njërin nga kriteret në vijim: (i) ai/ajo të jetë jurist, ekonomist ose profesionist tjetër me diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme në prokurim ose përvojë tjetër përkatëse, ose (ii) ai/ajo të ketë diplomë universitare në fushën e inxhinierisë ose arkitekturës dhe përvojë të konsiderueshme në ekzekutimin e projekteve të punëve.

**Neni 87**  
**Organizimi dhe votimi në KRPP**

- 87.1. Kryetari përfaqëson, udhëheq dhe organizon pu-

nën e KRPP-së.

- 87.2. Kryetari ka të drejtë që të caktoj një anëtar për të organizuar dhe udhëhequr punën e KRPP-së në një fushë të caktuar.
- 87.3. Kryetari do të kon/vokoj mbledhjet e KRPP-së kur ai/ajo e konsideron te nevojshme ose kur një gjë e tillë kërkohet nga dy anëtarë të tjerë të KRPP-së.
- 87.4. Kuorumi për mbledhjet e KRPP-së është tre (3) anëtar.
- 87.5. Kryetari do të kryesojë mbledhjet e KRPP-së. Në raste të caktuara, kur është e nevojshme që KRPP-ja të takohet në mungesë të kryetarit, kryetari do të autorizojë një anëtar të KRPP-së që të kryesojë mbledhjen.
- 87.6. KRPP-ja do të bëjë përpjekje që vendimet gjatë mbledhjeve të merren me konsensus. Kur kryesuesi i mbledhjes vendos se konsensusi nuk mund të arrihet, çështja përkatëse do të hyjë në votim. Për marrjen e një vendimi kërkohet vota e një shumice të anëtarëve të pranishëm. Në rast të një votimi të barabartë, kryesuesi i mbledhjes e ka votën përfundimtare.
- 87.7. KRPP-ja, nëse e sheh të nevojshme, mund të vendosë rregulla procedurale shtesë për të udhëhequr aktivitetet e saj. KRPP-ja do t'i sigurojë një kopje të rregullave të tilla çdo personi që i kërkon ato.

**Neni 87A**  
**Masat zbatuese**

- 87A. 1. Gjatë ushtrimit të funksioneve të saj sipas 82.2 të këtij ligji, KRPP është përgjegjëse për përgatitjen dhe shpalljen e masave të hollësishme zbatuese të përshkruara në këtë ligj. Masat zbatuese përbëhen nga rregulla, udhëzime, direktiva, dokumente dhe formularë standard të tenderit dhe kontratës si dhe dokumente dhe formularë të tjerë që autoritetet kontraktuese, zyrtarët e prokurimit, ndërmarrjet dhe personat duhet ti respektojnë, përdorin dhe/ose marrin parasysh gjatë ekzekutimit ose pjesëmarrjes në aktivitetet e prokurimit të rregulluara me këtë ligj.
- 87A. 2. Nëse një palë e interesuar ose një autoritet kontraktues beson se KRPP ka marrë vendim apo veprim, ka nxjerrë ose përdorë një masë zbatuese ose interpretim, që nuk është autorizuar ose është në kundërshtim me një ose më shumë dispozita të këtij ligji, pala e interesuar

ose autoriteti kontraktues mund të ankohe kundër këtij vendimi vendimit, veprimi, mase apo interpretimi në OSHP. Vendimet e OSHP-ës mund të paraqiten në gjykatë për shqyrtim në pajtim me rregullat për shqyrtimin gjyqësor të vendimeve administrative.

- 87A. 3. KRPP-ja gjithashtu do të hartojë një kod etikë të prokurimit që duhet të respektohet nga të gjithë nëpunësit publik, shërbyesit civil dhe personat e tjerë të punësuar nga autoritetet kontraktuese. Ky kod etikë në minimum duhet të përfshijë një përmbledhje të qartë të rregullave të detyrueshme mbi shmangien e konflikteve të interesave.
- 87A. 4. Për të ndihmuar punën e saj gjatë formulimit të masave zbatuese, KRPP merr sa më shumë mendime të atyre që janë të përfshirë në aktivitetet e prokurimit në Kosovë. Për këtë arsye, KRPP shqyrton rregullisht komentet dhe qëndrimet me shkrim të Drejtorit të APP-së, Drejtorit të Thesarit; zyrtarëve të prokurimit të autoritete kontraktuese (duke përfshirë dhe operatorët e shërbimeve publike), dhe organizatave që përfaqësojnë operatorët ekonomikë.
- 87A .5. Në lidhje me dispozitat e nenit 55.5 për sigurimin e tenderit si dhe dispozitat e nenit 60.6 për sigurimin e ekzekutimit (realizimit të kontratës), dhe pas konsultimit me Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës dhe Thesarin, KRPP duhet të përfshijë në rregullat e prokurimit publik dispozita të hollësishme për kushtet (kërkesat), që duhet të plotësohen nga institucionet financiare që lëshojnë çeqe të certifikuar dhe letra krediti në mënyrë që këto instrumente të pranohen si letra me vlerë; me kusht që kushtet e sipërcekura të mos jenë diskriminuese dhe të kufizohen vetëm në ato kushte që drejtpërdrejt shërbejnë për të përcaktuar stabilitetin financiar dhe besueshmërinë e këtyre institucioneve financiare.

### **Neni 88** **Fshehtësia**

KRPP, mund të mbrojë nga përhapja në publik ose persona të paautorizuar, informacionet e përgatitura ose marra prej saj gjatë kryerjes së detyrave të veta, por vetëm në masën e lejuar nga ky ligj edhe Ligji për Qasjen në Dokumentet Zyrtare. Pavarësisht nga sa më sipër, KRPP, i ofron qasje dhe kopje të çdo informacioni dhe dokumenti që ka në posedim ose kontroll, duke përfshirë informacionin dhe dokumentet e fshehta, Revizorit të Përgjithshëm, OSHP-së dhe/ose ndonjë panel shqyrtues menjëherë pas kërkesës apo urdhrorit të ndonjërit prej tyre. KRPP i

ofron po ashtu qasje dhe kopje të informacioneve dhe dokumenteve të tilla një gjykatë kompetente nëse kjo qasje ose këto kopje kërkohen me një urdhër të nxjerrë nga kjo gjykatë.

### **Neni 89**

#### **Largimi dhe suspendimi i anëtarëve**

- 89.1. Nëse, në çdo kohë, Qeveria, Kuvendi, një autoritet publik ose nëpunës publik mendon se ka arsye për largimin e një anëtari të KRPP, ai mund të paraqesë çështjen për vendim në gjykatën kompetente, duke dhënë arsye që e vërtetojnë këtë dhe të gjitha dokumentet e provave të kërkuara nga gjykata.
- 89.2. Gjykata kompetente do të nxjerrë urdhrin me të cilin largohet ose pezullohet anëtari i KRPP-së nga detyra nëse, pas mbajtjes së një seance të plotë dhe të ndershme dëgjimi mbi këtë çështje, gjykata në fjalë konstaton se anëtari përkatës (i) nuk i plotëson, ose më nuk i plotëson, kërkesat për të qenë anëtar të specifikuar në nenin 86, (ii) ka kryer vepër penale ose të pamoralshme gjatë ose lidhur me udhëheqjen e detyrave të veta zyrtare, (iii) është ngatërruar në rastin e përshkruar në nenin 117.1; ose (iv) ka përhapur me dashje ose ka përhapur më shumë se një herë nga pakujdesia informacion që KRPP ligjërisht e ka cilësuar si "të fshehtë".
- 89.3. Nëse vendimi i gjykatës i paraparë në nenin 89.2 i nënshtrohet procedurave ose ankesave të mëtejme, gjykata do të nxjerrë një urdhër për suspendimin e anëtarit deri në marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me këtë çështje. Nëse vendimi i gjykatës i paraparë në nenin 89.2 nuk u nënshtrohet procedurave dhe ankesave të mëtejme, gjykata do të nxjerrë një urdhër duke larguar anëtarin në fjalë.
- 89.4. Nëse një anëtar i KRPP-së i nënshtrohet një procedure gjyqësore në të cilën anëtari akuzohet të ketë kryer vepër penale ose vepër që bie ndesh me etikën profesionale gjatë ose lidhur me udhëheqjen e detyrave profesionale ose është ngatërruar në rastin e përshkruar në nenin 117.1, gjykata mund të jap urdhër me të cilin suspendon anëtarin e tillë, derisa gjykata të ketë rast për mbajtjen e një seance të plotë dhe të ndershme të dëgjimit lidhur me akuzat, dhe të nxjerr vendim lidhur me këtë çështje. Gjatë periudhës së pezullimit, KRPP nuk e lejon personin në fjalë (i) të marrë pjesë në ndonjë aktivitet të saj, (ii) të diskutojë çfarëdo çështje të saj me cilindo anëtar ose punonjës të KRPP, (iii) të ketë qasje ose të përdorë ndonjë prej ambienteve, pajisjeve, dokumenteve, informacioneve ose per-

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

sonelit të KRPP.

- 89.5. Anëtari i KRPP-së që suspendohet sipas këtij neni 89, do të vazhdojë të marrë rrogën e tij/saj përderisa anëtari në fjalë të pushohet ose përderisa suspendimi të anulohet.

### Neni 89A Dispozitat Kalimtare

- 89A. 1. Çdo anëtar i KRPP-ës që është në detyrë që prej 31 Dhjetorit 2006 do të vazhdojë të shërbejë në atë detyrë deri në mbarimin e mandatit të tij/saj, siç përcaktohet në legjislacionin e prokurimit që ishte në fuqi në kohën e emërimit të tij/saj. Asnjë anëtar i ri i KRPP nuk mund të emërohet në bazë të nenit 86 të këtij ligji përveç nëse dhe përderisa (i) të mos ketë mbaruar mandati i një anëtari ekzistues, (ii) një anëtar ekzistues të japë dorëheqjen, ose (iii) një anëtar ekzistues të mos largohet në mënyrën e përcaktuar në këtë ligj.
- 89A.2. KRPP, ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e shqyrtimit që me këtë ligj i janë dhënë OSHP-së deri në atë kohë kur kryetari i OSHP-së të kërkojë bartjen e tyre, gjë që duhet të ndodhë jo më vonë se 31 tetor 2007. Në atë kohë, KRPP bashkëpunon plotësisht me OSHP për të siguruar bartjen e rregullt të këtyre funksioneve dhe përgjegjësisive. Nëse ekzistojnë arsye detyruese të cilat kërkojnë një shtyrje përtej datës së cekur, kryesia e Kuvendit e shqyrton çështjen dhe mund të lejojë zgjatjen e afatit deri në dy muaj.

## PJESA VI AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

### Neni 90 Krijimi i Agjencisë së Prokurimit Publik

Në bazë të këtij ligji, në kuadër të Qeverisë do të themelohet një agjenci autonome ekzekutive e quajtur Agjencia e Prokurimit Publik – APP. APP, ushtron dhe zbaton vetëm autoritetin, kompetencat, funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj.

### Neni 91 Aktivitetet e prokurimit të APP-së

- 91.1. Nëse Qeveria vendos se një aktivitet i propozuar prokurimi duhet, për shkak të ekspertizës profesionale, efektivitetit të kostos, efikasitetit ose çështjeve të tjera legjitime, të ushtrohet nga APP-ja në vend

të një ose më shumë autoriteteve të tjera kontraktuese, Qeveria ka autorizim të përcaktojë APP-ën si autoritetin kontraktues përgjegjës për kryerjen e atij aktiviteti prokurimi. Në një rast të tillë; (i) Qeveria njofton për këtë autoritetin përkatës kontraktues ose autoritetet, të cilat nuk janë më të autorizuar të kryejnë prokurimin në fjalë, dhe (ii) APP do të konsiderohet "autoriteti kontraktues" për aktivitetin në fjalë të prokurimit. Qeveria siguron marrëveshjen nga bordi mbikëqyrës përkatës nëse autoriteti kontraktues është ndërmarrje në pronësi publike.

- 91.2. Qeveria vendos një listë të mallrave ose artikujve të përdorimit të përbashkët, prokurimi i të cilëve është caktuar APP-së. Kjo listë miratohet në formën e një Udhëzimi Administrativ. Kjo listë dhe çdo ndryshim i saj duhet të publikohen në media dhe të shpallen në faqen e internetit të KRPP-së, të përcaktuar në Nenin 82.2. të këtij ligji.
- 91.3. Një autoritet kontraktues porosit APP-në për mallrat, punimet ose shërbimet e prokuruar nga APP-ja në bazë të këtij ligji dhe nuk kryen aktivitetet prokurimi për to.
- 91.4. Një autoritet kontraktues mund të caktojë APP-në për kryerjen e një aktiviteti prokurimi në emër të tij. Autoriteti kontraktues gjithashtu mund të kërkojë nga APP të ndihmojë atë për kryerjen e aktivitetit të prokurimit që kryhet nga ky autoritet kontraktues.

### Neni 92 Emërimi, Largimi dhe Pezullimi i Drejtorit dhe Bordit Ekzekutiv të APP-ës

- 92.1. Deri me 30 Qershor 2009 APP do të administrohet nga drejtori dhe anëtarët e bordit ekzekutiv që shërbejnë në atë kapacitet me 31 Dhjetor 2006. Mandati i të gjithë këtyre personave skadon me 30 Qershor 2009.
- 92.2. Nga 1 Korriku 2009, Bordi Ekzekutiv i APP-së do të shpërbëhet dhe APP-ja do të administrohet vetëm nga drejtori, i cili emërohet sipas Nenit 92 me një mandat tre (3) vjeçar.
- 92.3. Drejtori propozohet nga Qeveria dhe emërohet nga Kuvendi. Në bërjen e propozimit dhe emërimit, Qeveria dhe Kuvendi duhet të zbatojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 92.7 dhe 92.8 të këtij ligji.
- 92.4. Drejtori dhe anëtarët e Bordit Ekzekutiv nuk mund të largohen ose pezullohen para mbarimit të mandatit të tyre përveç me një urdhër të gjykatës kompetente. Ky largim ose pezullim u nënshtrohet të

njëjtave kushte të parashikuara në nenin 89 të këtij ligji për largimin dhe pezullimin e një anëtari të KRPP-ës. Në të gjitha aspektet e tjera, drejtori dhe çdo anëtar i Bordit Ekzekutiv kanë statusin e shërbyesit civil dhe i nënshtrohen të njëjtave ligje dhe rregulla që rregullojnë shërbyesit civil në të njëjtën masë si çdo shërbyes tjetër civil.

- 92.5. Nëse drejtori ose një anëtar i Bordit Ekzekutiv pezullohet sipas nenit 89.4, ai/ajo do të vazhdojë të marrë rrogën e tij/saj derisa ai/ajo të largohet ose pezullimi të anulohet. Gjatë periudhës së pezullimit, APP nuk e lejon personin në fjalë; (i) të marrë pjesë në ndonjë aktivitet të saj, (ii) të diskutojë ndonjë prej çështjeve ose aktiviteteve të saj me një zyrtar ose punonjës të APP, (iii) të ketë qasje ose të përdorë ndonjë prej ambienteve, pajisjeve, dokumenteve, informacioneve ose personelit të APP.
- 92.6. Nëse drejtori pezullohet ose largohet, Qeveria emëron një drejtor të përkohshëm për të shërbyer në këtë detyrë derisa pezullimi të anulohet ose të emërohet një drejtor i ri sipas nenit 92.3.
- 92.7. Asnjë person nuk mund të propozohet, emërohet ose shërbejë si drejtor i APP-së nëse ai/ajo nuk mund të marrë pjesë në një aktivitet prokurimi për shkak të ndonjëris nga arsyet e parapara në nenin 61.2 të këtij ligji.
- 92.8. Qeveria dhe Kuvendi sigurojnë që çdo person i propozuar për drejtor të përmbushë njërin nga kriteret në vijim: ai/ajo të jetë juristë, ekonomistë ose profesionist tjetër me diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme në prokurim.

### **Neni 93 Fshehtësia**

APP mund të mbrojë nga përhapja në publik ose persona të paautorizuar, informacionet e përgatitura ose marr prej saj gjatë kryerjes së detyrave të veta, por vetëm në masën e lejuar nga ky ligj edhe Ligji për Qasjen në Dokumentet Zyrtare. Pavarësisht nga sa më sipër, APP i ofron qasje dhe kopje të çdo informacioni dhe dokumenti që ka në posedim ose kontroll, duke përfshirë informacionin dhe dokumentet e fshehta, Revizorit të Përgjithshëm, KRPP, OSHP dhe/ose ndonjë panel shqyrtues menjëherë pas kërkesës apo urdhrit të ndonjërit prej tyre. APP i ofron po ashtu qasje dhe kopje të informacioneve dhe dokumenteve të tilla një gjykate kompetente nëse kjo qasje ose këto kopje kërkohen me një urdhër të nxjerrë nga kjo gjykatë.

## **PJESA VII ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

### **Neni 94**

#### **Themelimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit**

- 94.1. Në bazë të këtij ligji themelohet një organ shqyrtues i prokurimit që njihet si Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP). OSHP, është përgjegjëse për ushtrimin e funksioneve të dhëna sipas këtij Neni 95 dhe dispozitat e tjera të këtij ligji.
- 94.2. OSHP, është organ i pavarur për shqyrtim administrativ. Asnjë person ose zyrtar publik nuk mund të ushtrojë ose të përpiqet të ushtrojë ndikim politik ose ndikim të paligjshëm në OSHP, një anëtar të OSHP ose në panel shqyrtues ose ekspert shqyrtues për ndonjë vendim ose veprim funksional, fakt-gjetës ose shqyrtues.
- 94.3. OSHP, është autoritet publik dhe organizatë buxhetore. OSHP, është subjekt i të gjitha dispozitave të zbatueshme, ligjeve dhe rregulloreve të Kosovës, në masë të njëjtë sikurse autoritetet e tjera publike dhe organizatat buxhetore.

### **Neni 95**

#### **Funksionet dhe Kompetencat e OSHP-ës**

- 95.1. OSHP-ja, dhe panelet shqyrtuese të krijuara nga ajo janë përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e prokurimit sipas pjesës VIII të këtij ligji dhe kanë autoritetin dhe përgjegjësitë e parashikuara në atë pjesë.
- 95.2. Me kërkesën me shkrim të një autoriteti kontraktues ose një pale të interesuar, OSHP-ja ka gjithashtu autorizimin dhe përgjegjësinë të rishikojë dhe vendosë vlefshmërinë e çdo vendimi, veprimi, mase, interpretimi ose rregullimi të nxjerrë, të përdorur ose të shpallur nga APP-ja ose KRPP-ja. Nëse OSHP-ja vendos se vendimi, veprimi, masa, interpretimi ose rregullimi në fjalë nuk është autorizuar ose është në kundërshtim me një ose më shumë dispozita të këtij ligji, OSHP, mund të nxjerre vendim për zhvleftësimin e vendimit, veprimit, masës, interpretimit ose rregullimit në fjalë dhe të urdhërojë APP-në ose KRPP-në të ndërmarrin masa korrigjuese që OSHP i gjykon të arsyeshme. Të gjitha vendimet dhe urdhrat e OSHP-ës të nxjerra sipas këtij Neni 95.2 mund të shqyrtohen nga një gjykatë kompetente në pajtim me ligjin e zbatueshëm për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative. Procedurat për rishikim të prokurimit në bazë të Kreut VIII zbatohet përshtatshëm, me kërkesë të autoritetit kontraktues ose të një pale të interesuar për një rishikim të udhëhequr nga BRP-ja, të

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

ndonjë vendimi, veprimi, mase, interpretimi ose vendimi që është marrë, përdorur, lëshuar ose shpallur nga APP-ja ose KRPP-ja.

**Neni 96****Emërimi i anëtarëve të OSHP-së**

96.1. OSHP, përbëhet nga pesë (5) anëtarë. Sipas dispozitave të nenit 96.2 të këtij ligji, të gjithë anëtarët emërohen për një mandat pesë (5) vjeçar dhe mund të riemërohen vetëm një herë.

96.2. Mandati fillestar i anëtarëve të OSHP-ës është si vijon; Kryetari dhe dy (2) anëtarë të tjerë emërohen për një mandat pesë (5) vjeçar; dy (2) anëtarë të tjerë emërohen për një mandat katër (4) vjeçar.

96.3. Me mbarimin e mandatit fillestar të parashikuar në nenin 96.2 të këtij ligji, çdo riemërim ose emërim i ri bëhet për një mandat pesë (5) vjeçar.

96.4. Secili anëtar i OSHP propozohet nga Qeveria dhe emërohet nga Kuvendi në bazë të vendimit që është marrë nga një organ përzgjedhës i pavarur i themeluar nga Kuvendi. Organi përzgjedhës i pavarur përbëhet prej tre gjykatësve të emëruar sipas rregullit, të caktuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Çdo person i propozuar ose emëruar në këtë mënyrë duhet të ketë të njëjtat kualifikime dhe të plotësojë të njëjtat kriteret si ato që kërkohen nga ligji i zbatueshëm në Kosovë për emërimin e gjykatësve.

96.5. Çdo person i emëruar në këtë mënyrë duhet të ketë këto kualifikime dhe duhet t'i plotësojë kriteret vijuese:

- (a) Të jetë banor i Kosovës;
- (b) Të jetë me integritet të lartë moral;
- (c) Të ketë diplomë të fakultetit Juridik që është e vlefshme sipas ligjit në Kosovë;
- (d) Të ketë certifikatë të provimit të dhënë të judikaturës në Kosovë ose të jetë anëtar i Odës së Avokatëve;
- (e) Të plotësojë kriteret për t'u emëruar si gjykatës;
- (f) Të ketë së paku tre (3) vjet përvojë profesionale në fushën e drejtësisë;
- (g) Të ketë aftësi për të kryer detyrat e postit në mënyrë të paanshme, të ndërgjegjshme, të zellshme, me vendosmëri dhe përgjegjshmëri, për të cilin ai është duke u konsideruar.

96.6. Kuvendi, brenda afatit prej 30 ditëve, shqyrton dhe emëron personat e përzgjedhur në bazë të nenit 96.4. Ai mund të kërkojë sqarime shtesë nga organi përzgjedhës i pavarur përkitazi me personat e përzgjedhur. Në rast të tillë afati kohor i paraparë për emërimet nga ana e Kuvendit mund të shtyhet

për 10 (dhjetë) ditë nga dita e pranimit të sqarimeve shtesë. Nëse nga ana e Kuvendit nuk ndërmerren veprime lidhur me emërimet brenda kornizës kohore të caktuar me këtë nen, personat e emëruar konsiderohen si të emëruar nga Kuvendi.

**Neni 97****Pezullimi dhe largimi i një anëtari të OSHP-ës**

Largimi dhe pezullimi i një anëtari të OSHP-ës i nënshtrohet të njëjtave rregulla dhe procedura që rregullojnë largimin dhe pezullimin e gjykatësve.

**Neni 98****Organizimi i OSHP**

98.1. Kryetari përfaqëson, drejton dhe organizon punën e OSHP dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e administrimit të përditshëm dhe veprimtarisë së OSHP-ës.

98.2. Kryetari është i autorizuar të caktojë një anëtar për të organizuar dhe drejtuar punën e OSHP në një fushë të veçantë.

**PJESA VIII****PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË PROKURIMIT****Kreu 1****Dispozitat e përgjithshme****Neni 99****Fushëveprimi**

Me dispozitat e kësaj pjese përcaktohen të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term ("palë e interesuar"), në nenin 4; detyrat dhe detyrimet që kanë autoritetet kontraktuese sipas këtij ligji ndaj palëve të interesuara.

**Neni 100****Parimet themelore**

100.1. Gjatë zbatimit të procedurave për shqyrtimin e prokurimit të përcaktuara në këtë pjesë, të gjithë personat pjesëmarrës, ndërmarrjet dhe autoritetet publike do të sigurojnë që kjo procedura të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës në fjalë.

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

- 100.2. As zbatimi i ndonjë procedure të shqyrtimit dhe asnjë vendim i OSHP, një panel shqyrtues të krijuar nga OSHP, ose i ndonjë anëtarë ose nëpunësi të OSHP-ës ose një ekspert shqyrtues nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.
- 100.3. Të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike sipas kësaj pjesë VIII.
- 100.4. Çdo procedurë për shqyrtimin e prokurimit do të realizohet në pajtim të plotë me dispozitat e përcaktuara të kësaj pjesë VIII.
- 100.5. Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë pjesë VIII, OSHP ose një panel shqyrtues duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundur, (ii) të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe (iii) të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.
- c. të nxjerrin një urdhër ndaj çdo personi për tu paraqitur në procedurën për shqyrtimin e prokurimit dhe të japë dëshmi lidhur me çdo çështje që paneli shqyrtues, në ushtrimin e arsyeshëm të diskrecionit të tij, i konsideron relevante lidhur me lëndën e kësaj procedure;
- d. të marrin çfarëdo masë tjetër të nevojshme dhe të përshtatshme për të verifikuar nëse është bërë ndonjë shkelje;
- e. nëse kontrata përkatëse nuk është nënshkruar ende ligjërisht nga të dy palët, të japin urdhër me të cilën mënjanohet ose pezullohet dhënia e kontratës publike ose rezultati i një konkursi të projektimit;
- f. t'i japin urdhër autoritetit kontraktues duke e detyruar autoritetin e tillë që të suspendojë ose përfundoj zbatimin e aktivitetit të prokurimit ose zbatimin e vendimit të autoritetit të tillë lidhur me ose gjatë aktivitetit në fjalë;
- g. t'i japin urdhër autoritetit kontraktues, duke e detyruar autoritetin e tillë që të anuloj ose revojoj vendimin e autoritetit të tillë lidhur me - ose të marrë gjatë - aktivitetit të prokurimit;
- h. t'i japin urdhër autoritetit kontraktues duke e detyruar autoritetin e tillë që të ia paguaj kompensimin parashtruesit të ankesës;
- i. t'i japin urdhër autoritetit kontraktues duke e detyruar autoritetin e tillë që të korrigjojë shkëlqen e pretenduar dhe/ose të parandalojë dëmtimin e mëtejshëm të parashtruesit të ankesës dhe/ose të ndonjë pale tjetër të interesuar;
- j. t'i japin urdhër autoritetit kontraktues që të mënjanojë specifikimet diskriminuese teknike, ekonomike, financiare ose të përzgjedhjes, kërkesat ose kriteret e përfshira në njoftim, ftesë, dosjen e tenderit ose dokumentet e tjera të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit; dhe
- k. të lëshojnë një urdhër me të cilin detyrohen zyrtarët për zbatimin e ligjit që të ndihmojnë OSHP-në ose një panel shqyrtues në ekzekutimin e një urdhri të OSHP-së ose panelit në fjalë.

**Kreu 2****Panelet shqyrtuese****Neni 101****Autoriteti i paneleve shqyrtuese**

- 101.1. Të gjitha ankesat e paraqitura në OSHP shqyrtohen nga një panel shqyrtues i krijuar sipas nenet 102.
- 101.2. Paneli shqyrtues ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi, në kuadër të kushteve të saktësuara në këtë pjesë VIII që:
- a. të shqyrtojnë ankesat e pranuar nga OSHP nga palët e interesuara lidhur me shkeljet e mundshme të kësaj ligji;
- b. t'i japin urdhër çdo personi, ndërmarrje ose autoriteti publik duke kërkuar nga një person, ndërmarrje ose autoriteti i tillë që të dorëzojë, bartë, paraqesë dhe/ose mundësojë qasje në të dhëna, informacione, dokumente (përveç këshillave të privileguara juridike), dhe/ose artikuj të tjerë të pasurisë së luajtshme dhe/ose të paluajtshme që paneli shqyrtues, në ushtrimin e arsyeshëm të diskrecionit të vet, i konsideron të rëndësishme për zbatimin e hetimeve ose të procedurave për shqyrtimin e prokurimit.

**Neni 102****Themelimi dhe përbërja e paneleve shqyrtuese**

- 102.1. Kryetari i OSHP-ës është përgjegjës për emërimin dhe përbërjen e secilit panel shqyrtues.
- 102.2. Varësisht nga vlera ose madhësia e kontratës së propozuar apo vështirësia apo rëndësia e rastit, Kryetari emëron një panel shqyrtues nga një ose tre anëtarë të OSHP-së, emërim ky që bëhet në bazë të kriterëve dhe mekanizmave objektivë. Nëse rasti është i rëndësishëm apo interesit të veçantë, paneli shqyrtues përbëhet nga të gjithë pesë anëtarët e përhershëm të OSHP.

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

102.3. Nëse numri i ankesave të prokurimit që duhet të vendosen nga Panelet Shqyrtuese sipas kësaj pjese VIII vendosin barrë të tepruar në OSHP, dhe me këtë e pengojnë mundësinë e OSHP-ës që të përmbushë funksionet e dhëna sipas këtij ligji me kohë dhe në mënyrë efikase, Kuvendi në bazë të vendimit që është marrë nga organi përzgjedhës i pavarur i themeluar nga Kuvendi mundet, pas kërkesës me shkrim të Kryetarit të OSHP-së, të emërojë një ose më shumë persona që të shërbejnë si anëtar të përkohshëm (ad koc), të paneleve shqyrtuese, neni 96.6 zbatohet përshtatshmërisht.

102.4. Çdo person i emëruar për anëtarë të panelit përzgjedhës në bazë të nenit 102.3 posedon kualifikimet dhe plotëson kriteret e parapara nga neni 96.5.

**Neni 103****Rregullorja e punës së paneleve shqyrtuese**

OSHP, është e autorizuar që të vendosë rregulloren e punës për të udhëhequr ushtrimin e procedurave të shqyrtimit. Rregullorja e punës që përmendet më lartë duhet të jetë në përputhshmëri me këtë ligj, veçanërisht me dispozitat e kësaj Pjese VIII. Kryetari është përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e përpilimit (hartimit) të kësaj rregulloreje. OSHP, duhet të publikojë rregulloren e punës në faqen e saj informative të internetit si dhe ti sigurojë çdo personi që kërkon një kopje të rregullores së punës.

**Neni 104****Fshehtësia**

OSHP, mund të mbrojë nga përhapja në publik ose persona të paaautorizuar, informacionet e përgatitura ose marra prej saj gjatë kryerjes së detyrave të veta, por vetëm në masën e lejuar nga ky ligj edhe Ligji për Qasjen në Dokumentet Zyrtare. Pavarësisht nga sa më sipër, OSHP-ja i ofron qasje dhe kopje të çdo informacioni dhe shënimi që ka në posedim ose kontroll, duke përfshirë informacionin dhe shënimet e fshehta, Auditorit të Përgjithshëm ose një gjykatë kompetente menjëherë pas urdhrit të ndonjërit prej tyre.

**Kreu 3****Fitimi dhe zbatimi fillestar i procedurave të shqyrtimit****Neni 105****Afatet për dorëzimin e ankesës**

105.1. Ankesa mund të dorëzohet nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktiviteteve ose procedurave të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo

aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që supozohet të ketë bërë shkelje të këtij ligji.

105.2. Nëse kontrata përkatëse është dhënë ose është marrë vendimi për konkursin përkatës të projektimit, ankesa mund të dorëzohet vetëm brenda afatit prej tetë (8) ditëve kalendarike pas datës së pranimit të njoftimit të kontratës përkatëse ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit. Kjo periudhë tetë (8) ditore fillon në mesnatën e ditës kur bëhet publikimi i njoftimit të kontratës.

105.3. Nëse ankesa dorëzohet pas datës së publikimit të njoftimit për dhënjen e kontratës përkatëse ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, paneli shqyrtues mund të refuzojë një pretendim të bërë në ankesë nëse:

- a. pretendimi ka të bëjë me një veprim ose lëshim të autoritetit kontraktues, që pretendohet të ketë ndodhur dhjetë (10) ose më shumë ditë kalendarike para datës së tillë të publikimit;
- b. parashtruesi i ankesës, sipas opinionit të panelit shqyrtues, ka qenë në dijeni ose arsyetimisht është dashur të ketë qenë në dijeni mbi veprimin ose lëshimin e tillë – tetë (8) ose më shumë ditë kalendarike para datës së publikimit;
- c. parashtruesi i ankesës, sipas opinionit të panelit shqyrtues, ka qenë në dijeni ose arsyetimisht është dashur të ketë qenë në dijeni se veprimi ose lëshimi i tillë përbejnë shkelje të këtij ligji – tetë (8) ose më shumë ditë kalendarike para datës së publikimit; dhe
- d. parashtruesi i ankesës, sipas opinionit të panelit shqyrtues, ka pasur mjaft kohë që të përgatisë dhe dorëzojë një ankesë që përmban pretendimet në fjalë para datës së tillë të publikimit.

**Neni 106****Arkivimi dhe përmbajtja thelbësore e ankesës**

106.1. Çdo palë e interesuar mund të dorëzojë një ankesë në OSHP; sidoqoftë, OSHP do të marrë masa vetëm nëse ankesa e tillë:

- a. përmban emrin, adresën dhe informatat kontaktuese të parashtruesit të ankesës;
- b. përmban emrin e autoritetit përkatës kontraktues;
- c. përmban një përshkrimin specifik të arsyeshem të aktiviteteve përkatëse të prokurimit;
- d. e ka të bashkangjitur një kopje të njoftimit për dhënien e kontratës ose të njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, nëse diç e tillë është nxjerrë ose publikuar.

- e. vërteton se parashtruesi i ankesës kualifikohet si "palë e interesuar" siç është përkufizuar kjo shprehje në nenin 4 të këtij ligji;
- f. përshkruan rrethanat faktike që përbëjnë ose që grisin supozimin për shkeljen e këtij ligji;
- g. specifikon dispozitën ose dispozitat e këtij ligji që supozohet të jenë shkelur; dhe;
- h. përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës.
- 106.2. Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës në fjalë, do të ia dërgojë OSHP-ës dhe njëkohësisht do të ia dërgojë, në mënyrën më të shpejtë të mundshme, një kopje edhe autoritetit kontraktues.
- 106.3. OSHP, pas pranimit të ankesës, menjëherë do ta shqyrtojë atë për t'u siguruar që ajo i plotëson kushtet sipas nenit 106.1. OSHP-ja duhet të përfundojë shqyrtimin e ankesës brenda një (1) dite pune pas pranimit të ankesës.
- 106.4. Nëse OSHP-ja konstaton se ankesa nuk i plotëson kushtet sipas nenit 106.1 OSHP-ja menjëherë do të informojë parashtruesin e ankesës me shkrim, përmes mjeteve më të shpejta të mundshme, mbi karakterin e të metat që janë gjetur. Nëse afati për parashtrimin e ankesës ka skaduar ose skadon për më pak se dy (2) ditë pune, parashtruesi i ankesës do të ketë në dispozicion dy ditë pune pas marrjes së njoftimit të tillë për të korrigjuar të metat e tilla dhe për të ri parashtruar ankesën. Nëse afati për parashtrimin e ankesës akoma nuk ka skaduar dhe nuk skadon për më pak se dy (2) ditë pune, parashtruesi i kërkesës mund të ri parashtrojë kërkesën në çdo kohë para skadimit të afatit për parashtrim.
- 106.5. Nëse parashtruesi i ankesës ri parashtron ankesë me të meta, OSHP do të refuzojë ankesën me paragjykim dhe parashtruesi i ankesës e humb të drejtën për parashtrimin e një ankese që parashtron çfarëdo pretendimi të bërë në ankesën e refuzuar.
- 106.6. Nëse OSHP-ja konstaton se ankesa është parashtruar me kohë dhe i plotëson kushtet sipas neneve 106.1, OSHP menjëherë do të (i) emërojë një ekspert për shqyrtim sipas nenit 108 dhe (ii) formojë një panel shqyrtues për t'i shqyrtuar pretendimet e bëra në ankesë.

### Neni 107

#### Pezullimi automatik i aktivitetit të prokurimit

- 107.1. Po qe se dhe derisa paneli përkatës shqyrtues nuk merr një vendim tjetër, me shkrim, parashtrimi i ankesës automatikisht e obligon autoritetin kontraktues që të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë ankesa në fjalë.
- 107.2. Pavarësisht nga sa më sipër, nëse kërkohet nga autoriteti kontraktues, Kryetari i OSHP-ës mund të nxjerrë urdhër për pezullimin automatik që kërkohet sipas nenit 107.1 nëse, pas marrjes parasysh të pasojave të mundshme të pezullimit automatik, pasoja këto që mund të cenojnë të gjitha interesat duke përfshirë edhe ato publike si dhe pasojat e ankuesit, Kryetari vendos se pasojat negative të pezullimit të tillë i tejkalojnë përfitimet që mund të arrihen përmes pezullimit automatik në fjalë. Para ndërmarrjes së masave të kërkuara nga autoriteti kontraktues, ankuesit duhet ti jepet mundësia që të paraqesë argumentet e tij me shkrim të Kryetari për anulimin e pezullimit. Kryetari do të njoftojë parashtruesin e ankesës dhe autoritetin përkatës kontraktues mbi vendimin e tij/saj. ose përndryshe nuk do të ndikojë negativisht në ankesën
- 107.3. Vendimi mbi heqjen e pezullimit automatik asesi nuk do të cenojë ose parashtruesin e ankesës.

### Neni 108

#### Angazhimi i ekspertit shqyrtues

- 108.1. Me qëllim të mbrojtjes së interesave të autoritetit kontraktues dhe të parashtruesit të ankesës, dhe për të siguruar paanësinë në zgjidhjen e çështjeve të ngritura nga parashtruesi i ankesës, OSHP menjëherë do të emërojë ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar zbatimin e aktiviteteve të prokurimit përkatës dhe për të përcaktuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të përfshira në ankesë.
- 108.2. OSHP-ja do të përpilojë dhe mbajë një listë të ekspertëve të kualifikuar për shqyrtim. Gjatë përzgjedhjes dhe angazhimit së ekspertëve shqyrtues, do të merren parasysh individët që janë të paanshëm, profesional dhe që kanë njohuri lidhur me zbatimin e aktiviteteve të prokurimit, si dhe të kenë njohuri mbi këtë ligj. Kurdo që është e mundshme, OSHP duhet të përzgjedhë dhe angazhojë si ekspert shqyrtues personat që posedojnë certifikatën profesionale të prokurimit të vlershme dhe aktuale.

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

**Neni 109****Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues**

- 109.1. Eksperti shqyrtues, në afat prej shtatë (7) ditësh kalendarike, menjëherë pas emërimit të tij/saj do të, (i) shqyrtojë dokumentacionin e prokurimit të autoritetit kontraktues dhe shënimet përkatëse, (ii) intervistojë, nëse ai/ajo e sheh të arsyeshme ose të nevojshme, cilindo zyrtar, nëpunës ose këshilltar të autoritetit kontraktues ose palës ankuese, dhe (iii) pajisë panelit shqyrtues dhe kryesuesin e autoritetit kontraktues me një vlerësim me shkrim mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të përfshira në ankesë.
- 109.2. Autoriteti kontraktues është i obliguar që; (i) të bashkëpunoj plotësisht me ekspertin shqyrtues, (ii) t'i sigurojë ekspertit shqyrtues qasje të menjëhershme, të plotë dhe të lirë në të gjitha dokumentet dhe të dhënat, pa marrë parasysh vendndodhjen ose llojin, lidhur me aktivitetet e prokurimit të autoritetit kontraktues, dhe (iii) të pajtohet plotësisht, me shpejtësi, në përgjithësi dhe pa shmangie me çdo kërkesë të ekspertit shqyrtues.

**Neni 110****Vendimi i autoritetit kontraktues**

- 110.1. Autoriteti kontraktues, në afat prej katër (4) ditëve kalendarike pas marrjes së vlerësimit të ekspertit shqyrtues të specifikuar në nenin 109.1, i dërgon ekspertit shqyrtues, panelit shqyrtues dhe parashtruesit të ankesës vendimin e autoritetit kontraktues në lidhje me çështjet e parashtrura në ankesë.
- 110.2. Vendimi me shkrim që kërkohet nga neni 110.1 duhet të bëjë vlerësimin detal të autoritetit kontraktues mbi vlefshmërinë e secilës nga pretendimet e bëra në ankesë. Nëse vendimi bën një vlerësim mbi një pretendim, që ndryshon nga vlerësimi i dhënë nga eksperti shqyrtues, autoriteti kontraktues në vendimin e tij paraprak do të bashkëngjisë një deklaratë me shkrim në të cilën shpjegohen arsyet e këtij ndryshimi. Nëse vendimi e refuzon një pretendim ose e mohon vlefshmërinë e tij, autoriteti kontraktues duhet që të përfshijë edhe një deklaratë me të cilën shpjegohen arsyet për refuzimin ose mohimin e tillë.
- 110.3. Nëse, në vendimin e tij, autoriteti kontraktues konstaton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme, ai brenda pesë (5) ditëve

kalendarike, do të ndërmerr çfarëdo veprimi korrigjues të nevojshëm për ta rregulluar aktivitetin e prokurimit në pajtueshmëri me këtë ligj dhe të mënjanojë atë që është e mundur çdo dëm ose kërcënim që shkon në dëm të parashtruesit të ankesës ose operatorëve të tjerë ekonomik. Duke vepruar kështu, autoriteti kontraktues mund të kërkojë këshilla ose sugjerime me shkrim nga eksperti shqyrtues, paneli shqyrtues ose KRPP-ja, parashtruesi i ankesës dhe/ose operatorët e tjerë ekonomik. Masat korrigjuese që ndërmerren nga autoriteti kontraktues mund të përfshijnë, sipas nevojës: (i) anulimin e aktivitetit të prokurimit, dhënies së kontratës ose rezultatit të konkursit të projektimit (ii) zgjatjen e afatit të fundit kohor (iii) ndryshimin ose zhvleftësimin e një vendimi të autoritetit kontraktues dhe/ose (iv) marrjen e çfarëdo masave të tjera që janë të nevojshme për të përmirësuar shkeljet e bëra nga autoriteti kontraktues.

- 110.4. Autoriteti kontraktues menjëherë do të informojë panelin shqyrtues, parashtruesin e ankesës dhe operatorët e tjerë përkatës ekonomik për veprimin korrigjues të ndërmarrë.
- 110.5. Nëse, brenda afatit kohor të specifikuar në nenin 110.1, autoriteti kontraktues nuk e nxjerr vendimin që e refuzon ose e mohon vlefshmërinë e një pretendimi ose që nuk e vlerëson fare vlefshmërinë e një pretendimi, parashtruesi i ankesës, pastaj mundet që brenda tri (3) ditëve kalendarike pasi që të ketë pranuar vendimin në fjalë ose pasi që të ketë skaduar afati kohor i specifikuar në nenin 110.1, cilado që ndodh më vonë, do të dorëzojë (arkivojë), një njoftim me shkrim tek paneli shqyrtues dhe autoriteti kontraktues, duke identifikuar pretendimet që parashtruesi i ankesës planifikon t'i vazhdojë para panelit shqyrtues.
- 110.6. Nëse autoriteti kontraktues e nxjerr një vendim duke konstatuar se një pretendim i bërë në ankesë është i vlefshëm, por ai nuk ndërmerr masa adekuate korrigjuese brenda afatit kohor të specifikuar në nenin 110.4, parashtruesi i ankesës, pastaj mundet që brenda tri (3) ditëve kalendarike nga skadimi i afatit të tillë kohor, të dorëzojë një njoftim me shkrim tek paneli shqyrtues dhe autoriteti kontraktues, lidhur me dëshkrimin e autoritetit kontraktues dhe që kërkon nga paneli shqyrtues që të shqyrtojë çështjen dhe të nxjerrë një urdhër për autoritetin kontraktues sipas nenit 101 .2. të këtij ligji.
- 110.7. Nëse autoriteti kontraktues, më kohë e pranon njoftimin me shkrim nga parashtruesi i ankesës

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

sipas nenit 110.5 ose 110.6, autoriteti kontraktues brenda tri (3) ditëve kalendarike pas pranimit të njoftimit në fjalë, do t'i transferojë të gjitha dokumentet dhe shënimet lidhur me aktivitetin përkatës të prokurimit në panelin shqyrtues.

**Kreu 4****Procedurat para një Paneli Shqyrtues****Neni 111****Kompetencat dhe përgjegjësitë e Panelit Shqyrtues**

- 111.1. Çështjet që parashtuesi i ankesës i ka identifikuar në njoftimin e paraqitur në përputhje me nenin 110.5 ose 110.6 do të shqyrtohen dhe do të vendosen nga paneli shqyrtues që formohet në përputhje me nenin 106.6.
- 111.2. Procedurat e panelit shqyrtues ushtrohen në përputhshmëri me dispozitat e kësaj pjese VIII dhe Rregulloren e Punës sipas nenit 103.
- 111.3. Para marrjes së një vendimi përfundimtar mbi një çështje, paneli shqyrtues mund të kërkojë nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtuesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë. Paneli shqyrtues ka të drejtë që të kërkojë nga çdo person, ndërmarrje ose autoritet publik që të dorëzojë materiale ose dëshmi që me arsye mendon se kanë të bëjnë me çështjen përkatëse. Ngjashëm, paneli shqyrtues ka të drejtë që të kërkojë nga çdo person, ndërmarrje ose autoritet publik që të sigurojë dëshmi që paneli shqyrtues me arsye mendon se kanë të bëjnë me çështjen përkatëse.
- 111.4. Nëse cilado palë në procedurë dështon ose refuzon që të marrë pjesë plotësisht në procedurat ose që të përmbushë kërkesat e kësaj pjese VIII, Rregulloren e Punës që përshkruhet në nenin 103, ose një urdhër të nxjerrë nga paneli shqyrtues, paneli shqyrtues e merr vendimin në bazë të provave që i ka në dispozicion dhe në bazë të argumenteve të sjella nga palët me pjesëmarrje aktive në procedurë. Paneli shqyrtues është i autorizuar ta trajtojë (zgjidhë), refuzimin ose dështimin e tillë, siç e sheh të arsyeshme, duke: (i) vendosur mbi çfarëdo çështje ligjore dhe/ose çështje faktike në favor ose kundër palës kundërshtuese, dhe/ose (ii) vendosur mbi çfarëdo pretendimi në favor ose kundër palës kundërshtuese.
- 111.5. Nëse pala nuk paraqitet ose refuzon të paraqitet – qoftë personalisht ose përfaqësuesi i tij ligjor –

në seancën e caktuar të panelit shqyrtues, dhe pala ka qenë e informuar në lidhje me kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, atëherë paneli shqyrtues nxjerrë gjobë administrative për palën në shumë prej 1.000 Euro dhe i dërgon njoftim palës në lidhje me gjobën.

**Neni 112****Afati i fundit për marrjen e vendimeve**

- 112.1. Me qëllim që të mbrohen interesat e autoritetit kontraktues dhe të operatorëve përkatës ekonomik, procedurat para panelit shqyrtues duhet të jenë efikase dhe të përfundojnë në afat sa më të shkurtër duke respektuar dispozitat e këtij ligji dhe Rregulloren e Punës të vendosur sipas nenit 103.
- 112.2. Paneli shqyrtues do të nxjerrë vendimin e tij përfundimtar me shkrim, së bashku me deklaratën me shkrim mbi arsyet mbi të cilat është marrë një vendim i tillë, dhe ndonjë urdhër që nevojitet për zbatimin e vendimit të tillë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas skadimit të afatit kohor të specifikuar në nenin 110.7.,. Kur në çështje janë të përfshira fakte veçanërisht të ndërlikuara, paneli shqyrtues mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë kalendarike për nxjerrjen e vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrin të tij.
- 112.3. Paneli shqyrtues menjëherë do t'i dërgojë autoritetit kontraktues dhe parashtuesit të ankesës vendimin e tij me shkrim, deklaratën me shkrim mbi arsyet për marrjen e këtij vendimi, dhe çdo urdhër përcjellës.
- 112.4. Pas nxjerrjes së vendimit, ankesa dhe vendimi publikohen në faqen e internetit të OSHP.

**Neni 113****Sigurua, Gjobat dhe Dëmet**

- 113.1. Të gjitha ankuesit duhet të depozitojnë një siguri brenda tri (3) ditëve të punës pas dorëzimit të ankesës. Shuma e këtij sigurimi është e barabartë me pesë për qind (5%) të vlerës së kontratës publike ose konkursit të projektimit, por jo më pak se 1.000 Euro dhe jo më shumë se 5.000 Euro. Sigurimi i tillë mund të depozitohet në para të gatshme, përmes transferimit telegrafik ose bankar. Sigurimi i tillë gjithashtu mund të depozitohet në formë të një çeku të certifikuar, kredie ose garancioni bankar, nëse forma dhe lëshuesi i instrumentit të tillë i përmbush kërkesat e vendosura nga KRPP në rregullat e

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

- prokurimit publik.
- 113.2. Nëse shumica e plotë e sigurimit në fjalë nuk depozitohet brenda afatit kohor të specifikuar prej tri (3) ditëve të punës, OSHP-ja do të refuzojë ankesën dhe parashtruesi i ankesës nuk mund të parashtrorë më ndonjë ankesë tjetër në të cilën përfshihet ndonjëri nga pretendimet e bëra në ankesën e refuzuar.
- 113.3. OSHP-ja do të kthejë menjëherë çfarëdo siguri që është depozituar në lidhje me ankesat që janë refuzuar për shkak të mungesës së afatëve kohore ose jo-plotësisë sipas nenit 105 ose 106.
- 113.4. Nëse ankesa nuk është refuzuar për shkak të ndonjërit nga arsyet e specifikuar në nenin 105, 106 apo 113.2, paneli përkatës shqyrtues, me përfundimin e procesit shqyrtues, do të shqyrtojë secilin pretendim në ankesën në fjalë për të konstatuar se nëse parashtruesi i ankesës ka bërë pretendime të rrejshme. Paneli shqyrtues do të konstatojë se një pretendim është i rrejshëm nëse paneli shqyrtues konstaton se, në kohën kur parashtruesi i ankesës e ka parashtruar ankesën ai ka qenë në dijeni ose është dashur të ketë qenë në dijeni se nuk ka pasur kurrfarë baze objektive në faktet ose se nuk ka pasur ndonjë bazë objektive në ligj për bërjen a atyre pretendimeve.
- 113.5. OSHP-ja menjëherë do të ia kthejë sigurimin parashtruesit të ankesës nëse paneli shqyrtues konstaton se ndonjëra nga pretendimet në ankesë nuk është e rrejshme. Nëse paneli shqyrtues konstaton se të gjitha pretendimet e bëra në ankesë kanë qenë mashtroese, sigurimi i tenderit do të konfiskohet. Në raste të tilla, OSHP-ja do të; (i) njoftojë parashtruesin e ankesës me shkrim mbi konstatimin e tillë. Sidoqoftë, nëse siguria e në fjalë është deponuar në formë të një krediti ose garancioni bankar, OSHP-ja do të ndërmarrë të gjitha masat për t'i tërhequr fondet në fjalë nga lëshuesi i tyre, para se t'i dërgojë parashtruesit të ankesës njoftimin që kërkohet nga fjalia e mëparshme e këtij paragrafi.
- 113.6. Nëse paneli shqyrtues konstaton se cilado nga pretendimet e bëra në ankesë janë të rrejshme, OSHP-ja mund të kërkojë nga parashtruesi i ankesës që të paguajë një gjobë shtesë deri në 5.000 euro. Në raste të tilla, parashtruesi i ankesës është i papërshtatshëm për pjesëmarrje në çfarëdo mënyrë në një aktivitet të prokurimit që mbulohet nga ky ligj përderisa; (i) gjoba në fjalë nuk paguhet plotësisht, ose (ii) një gjykatë me kompetente e anulon vendimin e OSHP-ja për pagimin e gjobës në fjalë. Nëse OSHP-ja e vendos një gjobë sipas këtij neni 113.6, ajo do të lëshojë një urdhër për parashtruesin e ankesës, urdhër ky që kërkon nga ai që; (i) të paguajë gjobën në fjalë, (ii) i referohet këtij neni 113.6, dhe (iii) e njofton parashtruesin e tillë të ankesës se përderisa të paguhet gjoba plotësisht ose përderisa një gjykatë kompetente të mos e anulojë vendimin e KRPP-së, parashtruesi i ankesës konsiderohet (është) i papërshtatshëm për pjesëmarrje në çfarëdo mënyrë në aktivitetet e prokurimit që mbulohen nga ky ligj.
- 113.7. Nëse një pretendim i bërë nga parashtruesi i ankesës konstatohet se është i vlefshëm, paneli shqyrtues mundet; (i) të caktojë një anëtar për të llogaritur, në përputhshmëri me aktet e aplikueshme normative, dëmet që i janë shkaktuar, nëse ka të tilla, parashtruesit të ankesës si pasojë e shkeljeve të bëra nga autoriteti përkatës kontraktues, dhe (ii) të nxjerrë një urdhër që kërkon nga autoriteti kontraktues që të ia pagojë shumën e dëmeve parashtruesit të ankesës.
- 113.8. OSHP do të hapë, në pajtim me Rregullat Financiare, një xhirollogari të ndarë me kamatë në një bankë të licencuar komerciale në Kosovë, me qëllim të pranimit dhe mbajtjes së (i) fondeve të pranuar në formë të sigurimit ose një kredi apo garancion bankar që është depozituar si sigurim i tenderit në vijë me nenin 113.1, dhe (ii) fondet e pranuar nga një gjobë që është vënë sipas nenit 113.6. OSHP menjëherë do t'i depozitojë dhe mbajë fondet e tilla në këtë xhirollogari. OSHP nuk do t'i kthejë, transferojë ose t'i shfrytëzojë në çfarëdo mënyrë tjetër këto fonde, përveç siç autorizohet saktësisht nga neni 113.9.
- 113.9. OSHP-ja mund të lërë fondet e tilla të depozituara në xhirollogarinë e përmendur në nenin 113.8 përderisa (i) kthimi i tyre kërkohet nga neni 113.3 ose 113.5, ose (ii) parashtruesi i ankesës i ka shpenzuar pa sukses të gjitha të drejtat e tij për të apeluar vendimin e panelit shqyrtues, vendim ky i marrë në pajtim me nenet 113.4, 113.5 dhe, nëse aplikohet, 113.6. Pasi është parashtruesi i ankesës të ketë shpenzuar pa sukses të gjitha të drejtat e tij për të apeluar kundër këtij vendimi dhe asnjë gjykatë me juridiksion kompetent nuk e ka nxjerrë një urdhër duke e udhëzuar OSHP-ën që t'i sistemojë fondet ndryshe, OSHP-ja do të trajtojë fondet e tilla, nëse aplikohet, si një gjobë ose dënim dhe do t'i transferojë fondet në fjalë në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në

pajtim me dispozitat përkatëse të akteve të aplikueshme normative mbi çështjet buxhetore dhe të përvetësimeve.

#### **Neni 114** **Veprimet pranë Gjykatave**

- 114.1. Nëse parashtruesi i ankesës mendon se vendimi përfundimtar ose konstatimi i një paneli shqyrtues ose OSHP është në kundërshtim me faktet ose me këtë ligj, parashtruesi i ankesës mund të kërkojë nga gjykata kompetente shqyrtimin e vendimit në pajtim me ligjin e zbatueshëm për Procedurën Administrative. Mirëpo, dorëzimi, dërgimi ose rezultati i kërkesës për shqyrtim gjyqësor nuk do të ketë ndikim të mëtejshëm në zbatimin e prokurimit përkatës.
- 114.2. Nëse, pas shqyrtimit të sipër cekur, gjykata konstaton se një pretendim i bërë nga parashtruesi i ankesës në ankesën e mëparshme që i është dorëzuar OSHP-ës nuk ka qenë i pavlefshëm, gjykata do të lëshojë një urdhër duke kërkuar nga OSHP-ja që të ia kthejë parashtruesit të ankesës çfarëdo sigurimi që ia kishte konfiskuar dhe çfarëdo gjobe që i është vendosur atij sipas nenit 113.
- 114.3. Nëse pas shqyrtimit të sipër cekur, gjykata konstaton se një pretendim i bërë nga parashtruesi i ankesës së ankesën e tij të mëparshme që i është dorëzuar OSHP-ës është bërë në mënyrë të vlefshme, gjykata mund të lëshojë një urdhër; (i) duke e shfuqizuar ose ndryshuar çfarëdo urdhri ose vendimi të marrë nga OSHP-ja ose paneli shqyrtues, dhe/ose (ii) nëse parashtruesi i ankesës mund të demonstrojë se ai është dëmtuar nga veprimi ose mos-veprimi i autoritetit kontraktues, atëherë gjykata gjithashtu mund të kërkojë nga autoriteti kontraktues që të ia paguajë parashtruesit të ankesës kompensimin adekuat

#### **Kreu 5** **Raportimi**

##### **Neni 115** **Raportimi para Kuvendit**

OSHP-ja do të raportojë për punën e saj një herë në vit para Kuvendit mbi mbarëvajtjen e procedurave të shqyrtimit të prokurimit në vijë me këtë pjesë VIII .

##### **Neni 116** **Dërgimi i informacioneve**

- 116.1. Për çdo vit kalendarik, OSHP-ja do t'i sigurojë Kuvendit, më së voni deri në fund të shkurtit të vitit pasues kalendarik, informacionet dhe të dhënat në vijim, sipas llojeve të procedurave dhe objekteve të aktivitetit përkatës të prokurimit:
- numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar;
  - numrin e ankesave të refuzuara për shkak të mungesës së afateve kohore ose jo-plotësisë sipas nenit 105 ose nenit 106 ose dështimin për të depozituar sigurimin e kërkuar nga neni 113;
  - numrin e ankesave që janë konstatuar se nuk përmbajnë pretendime të vlefshme;
  - numrin e aktiviteteve të prokurimit që janë anuluar si rezultat i një ankese; dhe
  - informacione të hollësishme për çdo rast kur autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar një urdhër të OSHP –ës ose një paneli shqyrtues; dhe
  - numrin e procedurave të shqyrtimit që kanë rezultuar në konstatimin se aktiviteti përkatës i prokurimit dhe dhënia ose vendimi janë bërë në mënyrë të vlefshme.
- 116.2. Qeveria, në konsultim me OSHP-ën dhe në bazë të informacioneve që janë përshkruar në nenin e mësipërm 116.1, do të përgatisë propozimin e masave që kanë për qëllim reduktimin ose eliminimin e disa shkeljeve të caktuara dhe të përsëritura, duke përfshirë edhe përgatitjen e propozim-amendamenteve për këtë ligj.

## **PJESA IX**

### **MJETET JURIDIKE, DISPOZITAT NDËSHKIMORE DHE ÇËSHTJET PËRFUNDIMTARE**

#### **Kreu 1** **Shkeljet e ligjit dhe ndëshkimet**

##### **Neni 117** **Ndikimi i paligjshëm dhe shpagimi**

- 117.1. Konsiderohet vepër penale, e dënueshme dhe e zbatueshme në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjeve penale të Kosovës për çdo person që:
- sigurojë, ofrojë, kërkojë, ose pranojë ose të tregojë gatishmëri për të siguruar, ofruar, kërkuar ose pranuar diç që është e vlefshme (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, para, ofertë pune, pasuri materiale dhe jo, favorizim ose shërbime)

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

- për përfitimin e drejtpërdrejtë materiale ose të tërthortë ose pasurimin e punonjësit ose të ish punonjësit, zyrtarit ose ish zyrtarit të një autoriteti kontraktues, ose të një personi apo ndërmarrje që ka lidhje me ose që bashkëpunon me punonjësin, ish punonjësin, zyrtarin ose ish zyrtarin, në tërësi ose pjesërisht për të ndikuar ose tentuar për të ndikuar në vendimin ose masat që dëmtojnë, ose lidhen me iniciimin, zbatimin ose rezultatet e aktivitetit të prokurimit ose shqyrtimit.
- b. të ndërmarrë masa, ose të tregojë gatishmëri për të marrë masa, me qëllim të frikësimit, shtrëngimit, dëmtimit ose shkakimit të dëmit (fizik, financiar ose të ndryshëm), të ndonjë personi ose ndërmarrje, në tërësi ose pjesërisht me qëllim që të ndikojë, të tentojë të ndikojë ose të hakmerret për një vendim ose veprim lidhur me iniciimin, zbatimin ose rezultatin e aktivitetit të prokurimit ose shqyrtimit.
- c. të kërkojë ose të hyjë në çfarëdo marrëveshje, aranzhim ose mirëkuptim me çfarëdo personi ose ndërmarrje tjetër, nëse marrëveshja, aranzhimi ose mirëkuptimi i tillë ka për qëllim që të ndikojë ose të parandalojë, kufizojë ose të ngatërroj konkurrencën për cilëndo kontratë publike; ose
- d. të ia lehtësojë ose ta inkurajojë cilindo person ose ndërmarrje që të merret me cilëndo nga veprimet e specifikuar në pikat "a", "b" ose "c" më lartë.
- 117.2. Pika "c" e nenit 117.1 nuk do të zbatohet gjatë negociatave ose ekzekutimit të marrëveshjeve formale me shkrim të një grupi të operatorëve ekonomik, nëse marrëveshja e tillë bie nën fushëveprimin e nenit 66.2.
- 117.3. Çdo nëpunës civil ose punonjës ose zyrtar i autoritet kontraktues që informohet, përmes çfarëdo mjeti, për veprën e përshkruar në nenin 117.1 ose për ndonjë rast që pritet të përfshijë një vepër të tillë, menjëherë duhet të njoftojë Ministrinë e Punëve të Brendshme.
- 117.4. Me të mësuar për një shkelje ose ngjarje të tillë, Ministria e Punëve të Brendshme menjëherë zhvillon hetimet paraprake lidhur me çështjen, dhe nëse ka arsye të mjaftueshme për të konstatuar se një shkelje e tillë ka ndodhur, Ministria zyrtarisht ia përcjell çështjen agjencionit për zbatimin e ligjit për hetime të mëtejme, në përputhje me ligjin në fuqi, për të ndërmarrë të gjitha masat e tjera të nevojshme të cilat Ministria i konsideron të domosdoshme dhe të përshtatshme për të rregulluar gjendjen.
- 117.5. Çdo person ose ndërmarrje që me dashje ose nga pakujdesia e rëndë ofron, ose shkakton ose nxit personin tjetër ose ndërmarrjen për të siguruar, informacione përmbajtësish të pasakta ose mashtruese, dëshmi ose të dhëna Ministrisë së Punëve të Brendshme ose zyrës së prokurorit publik duke pohuar ose duke tentuar të dëshmoj ose të mos e pranoj veprën penale të paraparë në nenin 117.1 i nënshtrohet ndjekjes penale sipas ligjit penal të Kosovës për një vepër të tillë dhe po ashtu përgjigjet për të gjitha dëmet financiare dhe dëmet e tjera që ai ua ka shkakuar personave të tretë dhe ndërmarrjeve.
- 117.6. Kur një kundërvajtje e saktësuar në nenin 117.1 pretendohet të jetë kryer nga ose në emër të ndërmarrjes, personi ose personat fizik që faktikisht janë të ngatërruar në rastet që kanë shkakuar ndjekjen penale të një veprimi të tillë, po ashtu ndiqen penalisht për këtë. Veç kësaj, çdo drejtor ose zyrtar i lartë ekzekutiv i ndërmarrjes së tillë që ka qenë në dijeni ose, sipas kujdesit të arsyeshëm drejtues, është dashur të ketë qenë në dijeni për rastet që kanë shkakuar ndjekjen e veprës së tillë penale, po ashtu do të ndiqen penalisht. Kur vepra penale është vepër penale e paraparë në nenin 117.5, personat, drejtorët dhe zyrtarët e tillë, së bashku me ndërmarrjen, do të përgjigjen në mënyrë të përbashkët për të gjitha dëmet financiare ose dëmet e tjera që u kanë shkakuar personave të tretë ose ndërmarrjeve.

**Neni 118****Shkeljet e ligjit nga autoriteti kontraktues**

- 118.1. OSHP-ja do të vendosë një gjobë prej jo më pak se 5.000 euro mbi një autoritet kontraktues që nuk zbaton një urdhër brenda 3 ditëve pune ose për mosrespektimin e urdhrit të OSHP-së, një paneli shqyrtues ose APP-së.
- 118.2. Nëpunësi civil, punonjësi ose zyrtari i autoritetit kontraktues që dështon në respektimin e urdhrit do të pushohet nga puna dhe do të gjobitet me një shumën që nuk është më e vogël se 1.000 euro. Personi i tillë nuk mund të bëhet prapë nëpunës civil, punonjës ose zyrtar i një autoriteti kontraktues për një periudhë tri (3) vjeçare pas pushimit nga puna.

**Neni 119****Prokurimet e mbyllura në kundërshtim me këtë ligj**

- 119.1. Kontrata publike ose konkursi i projektimit mund të shfuqizohen pjesërisht ose plotësisht nga OSHP-ja, një panel shqyrtues ose një gjykatë,

## LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17

- nëse të përmendurit konstatojnë se kontrata publike ose konkursi i projektimit:
- a. janë dhënë ose janë lidhur për një qëllim ose në bazë të një procedure ose aktiviteti që nuk lejohet shprehimisht me këtë ligj;
  - b. janë dhënë ose janë lidhur në përputhje me një procedurë ose aktivitet që është në kundërshtim me këtë ligj;
  - c. kanë të bëjnë me lëndën që autoriteti kontraktues e ka ndarë në disa pjesë për t'iu shmangur zbatimit të procedurave të prokurimit sipas dispozitave të këtij ligji;
  - d. i janë dhënë operatorit ekonomik ose janë lidhur me operatorin ekonomik ose kandidatin që është përzgjedhur; (i) në kundërshtim me kriteret përkatëse të përzgjedhjes, kërkesat dhe specifikimet ose (ii) në përputhje me kriteret e përzgjedhjes, kërkesat ose specifikimet që nuk janë të përgatitura ose publikuara në pajtim me këtë ligj;
  - e. i janë dhënë operatorit ekonomik ose është lidhur me operatorin ekonomik ose kandidatin që nuk i ka plotësuar kërkesat e specifikuara në këtë ligj dhe në njoftimin, ftesën ose dokumentet e aplikueshme të kontratës;
  - f. janë ndryshuar në kundërshtim me ndonjë dispozitë të këtij ligji ose me qëllim të shmangies nga procedurat e këtij ligji; ose
  - g. janë dhënë ose janë lidhur në kundërshtim me një vendim ose urdhër të OSHP, një paneli shqyrtues ose APP-së.
- 119.2. Në rast se OSHP-ja ose një gjykatë konstaton se një kontratë publike ose konkurs projektimi mund të shfuqizohet për shkaqet e përcaktuara në nenin 119.1, OSHP-ja ose gjykata mund të nxjerrë urdhër:
- a. për shfuqizimin e kontratës publike, pjesërisht ose plotësisht;
  - b. për detyrimin e autoritetit kontraktues që të kryejë një prokurim të ri për kontratën publike ose konkursin e projektimit ose cilëndo pjesë të tyre që nuk është ekzekutuar ende në masë kënaqshme;
  - c. nëse ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për sjellje të gabuara nga ana e operatorit ekonomik gjatë aktivitetit të prokurimit, për ta detyruar operatorin ekonomik që të paguajë dëmet e shkaktuara autoritetit kontraktues dhe/ose një operator tjetër ekonomik të dëmtuar nga sjelljet e sipër cekura;
  - d. nëse ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për sjellje të gabuara nga ana e autoritetit kontraktues gjatë aktivitetit të prokurimit, për ta detyruar autoritetin kontraktues që të paguajë dëmet e shkaktuara cilëndo operator ekonomik që është dëmtuar nga shkeljet e sipër cekura;
- 119.3. Gjatë vendosjes për shfuqizimin e një kontrate publike ose konkursi të projektimit, pjesërisht ose plotësisht, OSHP-ia ose gjykata duhet të marrin parasysh dëmet në interesin publik që mund të rezultojnë nga ky veprim. Nëse OSHP-ës ose gjykata konstaton se shfuqizimi do të kishte pasoja të rënda në interesin publik, atëherë OSHP-ës ose gjykata nuk do të shfuqizojnë kontratën publike ose konkursin e projektimit, por do të përpiqen ta rregullojnë çështjen përmes nxjerrjes së një urdhri për kompensimin e dëmit sipas pikave c. dhe/ose d. të nenit 119.2.
- 119.4. Nëse një urdhër i nxjerrë nga OSHP-ja, paneli shqyrtues ose gjykatë sipas këtij neni 119 është subjekt i shqyrtimit gjyqësor ose procedurës ankimore, dhe operatori ekonomik dhe/ose autoriteti kontraktues e njofton me kohë organin urdhërues për qëllimin e tij që të paraqesë ankesë ose kërkesë për shqyrtim, organi urdhërues e pezullon përmbarrimin e urdhrit deri në kohën kur urdhri nuk do të jetë më subjekt i shqyrtimit gjyqësor ose procedurës ankimore. Në këto raste, organi urdhërues duhet që menjëherë të urdhërojë operatorin ekonomik dhe/ose autoritetin kontraktues që menjëherë të depozitojë sigurim për përmbarrimin e urdhrit, në një shumë e cila është së paku e baras vlefshme me (i) dëmet, nëse ka të këtilla, që janë përcaktuar në urdhër, dhe (ii) çfarëdo shume tjetër të arsyeshme që organi urdhërues e konsideron të nevojshme për të siguruar të drejtat e palëve të tjera dhe/ose për të siguruar përmbarrimin e urdhrit, nëse i njëjti konfirmohet nga shqyrtimi gjyqësor ose procedura ankimore. Sigurimi i kërkuar nga ky nen 119.4 mund të depozitohet në të njëjtën mënyrë sikurse sigurimi i tenderit ose sigurimi i përmbarrimit.
- 119.5. Nëse operatori ekonomik dhe/ose autoriteti kontraktues nuk e bën depozitimin e sigurimit të kërkuar sipas Nenit 119.4 brenda shtatë (7) ditëve kalendarike pasi të jetë informuar për shumën e sigurimit, urdhri nuk do të konsiderohet i pezulluar dhe i njëjti mund të përmbahet menjëherë.
- 119.6. Asgjë në këtë nen 119 ose në cilëndo dispozitë tjetër të këtij ligji, nuk e kufizon dhe nuk mund të interpretohet për të kufizuar pushtetin e gjykatës që; (i) të pezullojë cilindo aktivitet prokurues të autoritetit kontraktues dhe cilëndo procedurë të OSHP-së ose një gjykatë të shkallës më të ulët gjatë ankimit para gjykatës ose procedurës së shqyrtimit, (ii) të pezullojë, ndryshojë ose vërtetojë çfarëdo urdhri të nxjerrë nga OSHP-ës

**LIGJI PËR PROKURIMIN PUBLIK NË KOSOVË, NR. 2003/17**

ose një gjykatë më e ulët, (iii) të nxjerrë çfarëdo urdhri të përkohshëm që duhet të respektohet gjatë ankimit para gjykatës ose procedurës së shqyrtimit; ose (iv) të nxjerrë çfarëdo urdhri tjetër që gjykata e konsideron të nevojshëm për të ruajtur status kuotë ose përmbarimin e një vendimi që mund të nxirret në të ardhmen nga gjykata për këtë çështje.

**Kreu 2**  
**Dispozitat përfundimtare**

**Neni 120**  
**Shfuqizimi i legjislacionit të mëparshëm**

Ky ligj dhe rregullat e prokurimit publik që do të nxirren sipas këtij ligji do t'i zëvendësojnë të gjitha legjislacionet paraprake dhe rregullat mbi prokurimin publik në Kosovë. Legjislacioni i mëparshëm në fjalë dhe rregullat do të dalin nga fuqia në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 121**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 4 muaj pas shpalljes së tij.

**UNMIK/REG/2007/20**  
**06.06.2007**

## LIGJI NR. 02/L-81

# PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E TË USHQYERIT ME QUMËSHT GJIRI

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 (ë) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001,

Miraton:

## LIGJIN PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E TË USHQYERIT ME QUMËSHT GJIRI

### Kapitulli I

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1

Ky Ligj ka për qëllim që të kontribuoj në sigurimin e të ushqyerit adekuat të foshnjës përmes inkurajimit dhe mbrojtjes së të ushqyerit me gji.

##### Përkufizimet

##### Neni 2

Për qëllimet e këtij Ligji vlejné përkufizimet e termeve nga Ligji për shëndetësi Nr. 2004/4, Kapitulli 1, neni 1 dhe përkufizimet e veçanta si vijon:

**Qumështi i gjirit:** nënkupton qumështin e gjirit të nënës ose të mëndeshës.

**Mëndesha:** Grua që i jep gji foshnjës së huaj.

**Foshnjë:** Fëmijë i vogël që ushqehet me qumësht të gjirit të nënës.

**E punësuara që ushqen foshnjën me gji:** E punësuara që informon punëdhënësin për atë se ushqen foshnjën me gji dhe këtë e dëshmon me mendimin e mjekut familjar.

**Zëvendësues i qumështit të gjirit:** nënkupton çdo lloj ushqimi zëvendësues i qumështit të gjirit, qoftë i plotë apo i pjesërishëm, që është i shënuar ose etiketuar në ndonjë formë.

**Ushqimi plotësues:** nënkupton çdo lloj ushqimi i përgatitur në mënyrë industriale ose në shtëpi, që është i përshtatshëm si plotësim i qumështit të gjirit ose zëvendësuesve të tij.

**Paketimi:** nënkupton çfarëdo forme të paketimit të prodhimit, si njësi e dedikuar për shitje me pakicë, duke përfshirë edhe letrën për mbështjellje.

**Distributori:** nënkupton personin juridik apo fizik, në sektorin publik ose privat të inkuadruar në punë të marketingut, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për shitje me shumicë apo pakicë.

**Etiketë:** nënkupton çfarëdo emërtimi, shënimi, shenjzimi apo vizatimi, të shkruar, të shtypur, të stampuar në paketim ose i bashkangjitur me paketimin e prodhimit.

**Prodhues i zëvendësuesve të qumështit të gjirit:** Korporata ose individ i në sektorin publik apo privat i inkuadruar në punë ose në funksion të prodhimit të produkteve të cilat i përfshinë ky Ligj, qoftë drejtpërsëdrejti ose përmes përfaqësuesit tregtar, përmes individit që kontrollohet ose është nën kontrollin e kontraktorit.

**Marketing:** nënkupton promovim, shpërndarje falas, shitje, reklamim dhe paraqitje publike të prodhimeve dhe shërbimeve propaganduese.

**Person i marketingut:** nënkupton çdo person, funksioni i të cilit përfshin tregtimin e ndonjë produkti apo produkteve.

**Mostër:** nënkupton sasinë e vogël dhe të zgjedhur të prodhimit që jepet falas me qëllim të prezantimit apo promovimit.

**Furnizimi:** nënkupton sasinë e prodhimit të dhënë për përdorim për një kohë më të gjatë, falas ose me çmim shumë të ulët për qëllime sociale, duke inkuadruar këtu edhe ndihmat e dhëna familjeve të cilat kanë nevojë për të.

### Kapitulli II

#### INFORMIMI

##### Neni 3

3.1. Shtatzënat, nënat dhe personat e interesuar duhet të kenë qasje të lehtë dhe të garantuar në informatat, materialet, mjetet dhe metodat që promovojnë të

**PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E TË USHQYERIT ME QUMËSHT GJIRI**

ushqyerit me qumësht gjiri.

3.2. Ministria e Shëndetësisë përkrahë Institucionet shëndetësore në informimin, komunikimin, edukimin dhe zbatimin e promovimit të ushqyerit me qumësht të gjirit bazuar në të dhëna dhe në veçanti punëtorët shëndetësorë që merren me përkujdesin për nënën dhe foshnjën.

3.3. Punëtorët shëndetësor në institucionet shëndetësore që merren me përkujdesjen e nënës dhe foshnjës, kanë për obligim të bëjnë informimin, edukimin dhe komunikimin për të ushqyerit me qumësht gjiri të mbështetur në evidencë.

**Institucionet shëndetësore****Neni 4**

4.1. Institucionet shëndetësore, inkurajojnë dhe mbrojnë të ushqyerit me qumësht gjiri.

4.2. Inkurajimi, mbrojtja dhe përkrahja e të ushqyerit me qumësht gjiri, në Institucionet shëndetësore që merren me përkujdesjen e nënës dhe foshnjës, rregullohet me akt nënligjor.

4.3. Aktet nënligjore duhet të mbështeten në "Deklaratën e Inoçetit", "Dhjetë hapat e të ushqyerit të suksesshëm me gji" dhe në "Kodin Ndërkombëtar të Marketingut të Zëvendësuesve të Qumështit të Gjirit".

**Kapitulli III****MARKETINGU I ZËVENDËSUESVE TË QUMËSHTIT TË GJIRIT****Neni 5**

Prodhimet që kanë të bëjnë me zëvendësimin e qumështit të gjirit për foshnje janë:

1. Qumështi artificial në formë pluhuri me modifikim të plotë ose të pjesshëm.
2. Qumështi dhe produktet e qumështit të prodhuara në mënyrë industriale ose në shtëpi.
3. Ushqimet plotësuese për foshnjat dhe fëmijët.
4. Cucllat, shishet, ose mjetet tjera për ushqimin e foshnjeve.

**Emërtimi, Etiketa dhe Paketimi i zëvendësuesve të qumështit të gjirit****Neni 6**

6.1. Paketimet e zëvendësuesve të qumështit të gjirit nuk guxojnë të përmbajnë fotografi, vizatime, portrete foshnjesh apo tekste të shkruara që motivojnë dhe inkurajojnë përdorimin e tyre.

6.2. Paketimet e prodhimeve të zëvendësuesve të qumështit të gjirit që nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara, por që mund të modifikohen për të arritur këtë, duhet shënjuar me etiketë paralajmëruese se nuk bën të përdoren si të vetmet ushqime për foshnje.

6.3. Etiketi i zëvendësuesve të qumështit të gjirit duhet të bëhet ashtu që të theksojë përparësitë e të ushqyerit me gji dhe të mos dekurajojë në asnjë mënyrë të ushqyerit me qumësht gjiri.

6.4. Çdo paketim i zëvendësuesve të qumështit të gjirit duhet të përmbajë etiketën në gjuhët zyrtare me këto informata:

- a) Udhëzimet e plota dhe të qarta rreth përdorimit të këtyre prodhimeve, moshën kur duhet përdorur dhe mënyrën e përgatitjes, të paralajmëruara me vërejtjen "VENI RE" apo të ngjashme që tërheqin vëmendjen e përdoruesit.
- b) Vërejtjen e theksuar se përdorimi i këtyre prodhimeve është i mundur vetëm pas këshillimit me punëtorin shëndetësor.
- c) Informata për rreziqet dhe pasojat për shëndetin e foshnjës në raste të përdorimit jo të drejtë të tyre.
- d) Të dhëna të plota mbi përmbajtjen, përbërësit dhe analizat e kryera të zëvendësuesve të qumështit.
- e) Kushtet e transportimit, ruajtjes dhe deponimit.
- f) Numrin serik të prodhimit, datën e prodhimit dhe afatin e përdorimit dhe, ose datën e skadimit të afatit të përdorimit.

**Kapitulli IV****DHURIMI I ZËVENDËSUESVE TË QUMËSHTIT TË GJIRIT****Neni 7**

7.1. Ndalohet reklamimi ose ndonjë formë tjetër e promovimit në opinion të prodhimeve që janë në kuadër të fushëveprimit të këtij Ligji.

7.2. Nuk lejohet që prodhuesi ose distributori tu dhuroj shtatzënave, nënave, foshnjave dhe anëtarëve të familjes së foshnjës, çoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, mostra të prodhimeve në kuadër të fushëveprimit

**PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E TË USHQYERIT ME QUMËSHT GJIRI**

të këtij Ligji.

- 7.3. Nuk lejohet që personi i marketingut gjatë veprimtarisë së tij të kërkojë dhe të arrijë asnjë formë të kontaktit të drejtpërdrejt apo të tërthortë me shtatzënat, nënat dhe familjarët e foshnjave.
- 7.4. Nuk lejohet përdorimi i metodave inkurajuese për shitjen me pakicë të zëvendësuesve të qumështit të gjirit si reklamimi, vendosja e pikave për shitje dhe dhënie të mostrave apo mekanizmat tjerë inkurajues si shitja me çmime më të ulëta, kuponat për lirim, shpërblimet, shitje e dy gjërave bashkërisht dhe metodave tjera inkurajuese për shitjen me pakicë të zëvendësuesve të qumështit të gjirit.

**Kapitulli V****DHURIMI I PAJISJEVE DHE MATERIALEVE  
NGA PRODHUESIT E  
ZËVENDËSUESVE TË QUMËSHTIT  
TË GJIRIT****Neni 8**

- 8.1. Dhurimi i pajisjeve dhe materialeve informative, edukative dhe komunikuese nga prodhuesit dhe distributorët e zëvendësuesve të qumështit të gjirit, mund të bëhet vetëm pas marrjes së lejes në formë të shkruar nga Ministria e Shëndetësisë.
- 8.2. Pajisjet dhe materialet e këtyra mund të mbajnë emrin ose shenjën njohëse të dhuruesit, por jo edhe t'i referohen prodhimeve të caktuara në kuadër të fushëveprimit të këtij Ligji.

**Kapitulli VI****SISTEMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR****Neni 9**

- 9.1. Ministria e Shëndetësisë dhe autoritetet shëndetësore ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të inkurajuar dhe mbrojtur të ushqyerit me qumësht gjiri, duke informuar dhe këshilluar në mënyrë adekuate punëtorët shëndetësor në nivelin e përgjegjësive të tyre, dhe duke i njoftuar ata me përmbajtjen e këtij Ligji.
- 9.2. Sistemi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor nuk mund të përdoret për qëllime të promovimit të prodhimeve në kuadër të fushëveprimit të këtij Ligji, pos shpërndarjes së informatave për punëtorët shëndetësor.

tësor.

- 9.3. Nuk lejohet shfrytëzimi i sistemit të kujdesit shëndetësor për prezantim ose distribuim të prodhimeve dhe materialeve promovuese të zëvendësuesve të qumështit të gjirit, përveç sipas kushteve të përcaktuara në nenin 8 të këtij Ligji.
- 9.4. Nuk lejohet përdorimi i sistemit të kujdesit shëndetësor nga personat e financuar nga prodhuesit apo distributorët e prodhimeve brenda fushëveprimit të këtij Ligji.

**Kapitulli VII****PUNËTORËT SHËNDETËSOR****Neni 10**

- 10.1. Punëtorët shëndetësor janë të obliguar që të inkurajojnë dhe mbrojnë të ushqyerit e foshnjës me qumësht gjiri.
- 10.2. Punëtorët shëndetësor e kanë të ndaluar që të pranojnë çdo formë të stimulimit nga prodhuesi apo distributori, për promovim në institucione shëndetësore të prodhimeve brenda fushëveprimit të këtij Ligji.
- 10.3. Punëtorët shëndetësor e kanë të ndaluar të bëjnë promovimin e zëvendësuesve të qumështit të gjirit në institucione shëndetësore përveç me qëllime të vlerësimit profesional ose të hulumtimeve në nivel të institucionit.
- 10.4. Punëtorët shëndetësor e kanë të ndaluar që t'i dhurojnë shtatzëna, nëna dhe familjareve të këtyre foshnjave, mostra të prodhimeve brenda fushëveprimit të këtij Ligji.
- 10.5. Prodhuesi apo distributori e ka për obligim t'a informoj institucionin shëndetësor për punëtorin e atij institucioni i cili përfiton ndonjë kontribut të dhënë për të ose në favor të tij, si financimin e studimeve pasuniversitare, vizitave studiuëse, dhënien e burave për hulumtime, pjesëmarrje në tubime profesionale dhe aktivitete të tjera të ngjashme.
- 10.6. Punëtori shëndetësor përfitues, duhet ta informoj institucionin e tij për cilëndo formë të stimulimit nëse ajo vënie nga prodhuesit dhe distributorët e prodhimeve përbrenda fushëveprimit të këtij Ligji.

**Kapitulli VIII****PERSONAT E PUNËSUAR NGA PRODHUESI  
DHE DISTRIBUTORI**

**PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E TË USHQYERIT ME QUMËSHT GJIRI****Neni 11**

- 11.1. Personeli i punësuar në marketingun e prodhimeve përbrenda fushëveprimit të këtij Ligji, nuk mund të ushroj funksione edukative shëndetësore për shtatzënat dhe nënat e foshnjave.
- 11.2. Kjo nuk nënkupton parandalimin për ta shfrytëzuar sistemin e kujdesit shëndetësor për veprimtari të tjera, me kërkesë dhe pëlqim të aprovuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.
- 11.3. Prodhuesi dhe distributori kryesor i prodhimeve përbrenda fushëveprimit të këtij Ligji, janë të obliguar të informojnë çdo anëtar të personelit të marketingut për përmbajtjen e këtij Ligji.

**Kapitulli IX****TË DREJTAT E FEMRËS PËR GJIDHËNIE****Vlerësimi dhe masat për garantimin e rrezikshmërisë****Neni 12**

- 12.1. Çdo punëdhënës është i detyruar që të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë lidhur me punët të cilat i ekspozohen rrezikshmërisë së veçantë nga agjentet e Aneksit I i cili është pjesë përbërëse e këtij ligji.
- 12.2. Çdo punëdhënës është i detyruar që lidhur me rezultatet e vlerësimit të informoj të punësuarën që ushqen foshnjën me gji.
- 12.3. Në rastet kur vlerësimi nga paragrafi 1 konstaton rrezikshmëri për sigurinë ose shëndetin e të punësuarave që ushqejnë foshnjën me gji, çdo punëdhënës duhet ti ndërmarr gjitha masat e nevojshme për ndërrimin e kushteve të punës dhe masat mbrojtëse për shëndetin e punësuarave që ushqejnë foshnjën me gji gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.
- 12.4. Në qoftë se punëdhënësi nuk ka mundësi që të marrë masat e nevojshme nga paragrafi 3 ose ndërmarrja e këtyre masave është e përcjellur me kosto të papërbalueshme, punëdhënësi është i detyruar që të punësuarave që ushqejnë foshnjën me gji t'ia ndërrojndë vendin e punës brenda ndërmarrjes së njëjtë pa reflektuar efekte të ndjeshme financiare për këta persona.
- 12.5. Në qoftë se ndërrimi i vendit të punës nuk është i

mundshëm për shkaqe teknike ose operative, punëdhënësi është i detyruar që të punësuarave që ushqejnë foshnjën t'iu mundësoj pushim me pagese.

**Ndalesa absolute e ekspozimit****Neni 13**

Punëtorja që ushqen foshnjën me gji nuk guxon, që nën asnjë rrethanë, të detyrohet të punojë në punë për të cilat vlerësimi nga neni 12.1. konstaton ekzistimin e rrezikut për sigurinë ose shëndetin e saj prej ekspozimit të:

- a) Agjentëve kimikal nga plumbi ose derivateve të plumbit përderisa këto agjente janë të prekshme ose mund të absorbohen në organizmin e njeriut.
- b) Punëve në miniera nën sipërfaqësore.

**Ndalesa për ndërprerje të marrëdhënies së punës****Neni 14**

- 14.1. Punëdhënësi nuk mund të ndërpres marrëdhënien e punës të punësuarës që ushqen foshnjën me gji e cila gjendet në pushimin e lehonisë.
- 14.2. Punëdhënësi nuk mund të ndërpres kontratën e punës të punësuarës që ushqen foshnjën me gji për shkak të së drejtave të saj të përcaktuara me këtë ligj.
- 14.3. Punëdhënësi është i detyruar që në rast të ndërprerjes së kontratës të punësuarës që ushqen foshnjën me gji për arsye tjera nga paragrafi 2, të bëjë arsyetimin e këtij veprimi me shkrim.
- 14.4. Në rast të shkeljeve të dispozitave ligjore nga ky nen, punëdhënësi detyrohet që të paguaj dëmshpërblimin adekuat për kompensimin material që do të kishte takuar të punësuarës që ushqen foshnjën me gji për 6 muajt e ardhshëm.
- 14.5. Në rastet nga paragrafi 2, e punësuarë që ushqen foshnjën me gji ka të drejtë për vazhdim të pagesës nga paragrafi 4 për 6 muaj tjerë nga fondet e sigurimit shëndetësor ose në mungesë të këtyre fondeve nga fondet sociale.

**Kapitulli X****FINANCIMI****Neni 15**

Nxitja dhe mbrojtja e të ushqyerit me gji do të finan-

cohen në pajtim me nenin 57 të Ligjit për shëndetësi Nr. 2004/4.

## Kapitulli XI

### DISPOZITAT DISCIPLINORE DHE NDËSHKIMORE

#### Neni 16

Në rastet e mos zbatimit dhe shkeljeve të dispozitave të këtij ligji kur nuk përbën vepër penale do të merren masa konform Nenit 118 dhe 119 të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës.

## Kapitulli XII

### DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### Neni 17

Me qëllim të zbatimit të këtij Ligji, Ministria e Shëndetësisë do të nxjerrë akte nënligjore të përcaktuara me këtë ligj.

#### Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

**UNMIK/REG/2007/7**  
**31.01.2007**

## ANEKSI I

### LISTA JO-KOMLETE E FAKTORËVE, PROCESIVE DHE E KUSHTEVE TË PUNËS

#### A. Faktorët

Faktorët fizik ku trajtohen si faktorë që shkaktojnë lëndimin e fetusit dhe/apo për përçarjen e shtrati të fëmijës, dhe në veçanti që shkaktojnë:

- (a) shok, dridhje apo lëvizje;
- (b) reagimi ndaj rrezikut nga barra e detyruar, posaçërisht ata të natyrës shpinore;
- (c) zhurma;
- (d) rrezatim jonizues (\*);
- (e) rrezatim jo-jonizues;
- (f) ftohje apo nxehe ekstreme
- (g) lëvizjet dhe gjendja, udhëtimet brenda apo jashtë ndërmarrjes, lodhjes fizike apo psikike, dhe ngarkesa tjera fizike, lidhur me aktivitetet e të punësuarës që ushqen foshnjën me gji.

#### Faktorët Biologjik

Faktorët Biologjik të grupeve në rrezik sikur: Grupet 2, 3 dhe 3 brenda kuptimit të Nenit 2 (d) numrat 2, 3 dhe 4 të Direktivës 90/679/EEC (1), deri në atë masë që të dihet se këta faktorë apo masat terapeutike të kërkuara nga këta faktorë, rrezikojnë shëndetin e grave shtatzëna dhe të fëmijës që nuk kanë lindur ende, që nuk përmenden në Shtojcën II.

#### Faktorët Kimik

Faktorët kimik vijues, kur dihet se rrezikojnë shëndetin e grave shtatzëna dhe fëmijës që nuk ka lindur ende, ku me sa duket nuk përmenden në Shtojcën II:

- (a) Substanca e etiketuar R 40, R 45, R 46, dhe R 47 nën Direktivën 67/548/EEC (2), me sa duket nuk përmendet në Shtojcën II;
- (b) faktorët kimik në Shtojcën I të Direktivës 90/394/EEC (3);
- (c) zhiva dhe derivatet nga zhiva;
- (d) bari antimitotik;
- (e) oksid karboni;
- (f) faktorët kimik të njohur dhe të rrezikshëm që përcjellën (thithen) përmes lëkurës.

#### B. Proceset

Proceset industriale të përmendur në Shtojcën I të Direktivës 90/394/EEC.

#### C. Kushtet e punës

Puna nëntokësore në minierë

**LIGJI NR. 2004 / 19****PËR AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**

Kuvendi i Kosovës,

Duke u bazuar në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Kreu 5.1.(d); 9.1.26);  
Duke u nisur nga interesi i përgjithshëm që ka Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës për zhvillimin e shkencës dhe arteve;  
Duke e përkufizuar veprimtarinë e shkencës dhe arteve si veprimtari me interes publik e kombëtar;  
Duke i konsideruar institucionet e Kosovës përgjegjëse për krijimin e kushteve për realizimin e veprimtarisë shkencore dhe të arteve

miraton në vijim:

**LIGJI PËR AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS****I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1**

1.1. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (Akademia) është institucioni më i lartë i shkencës dhe i artit në Kosovë i themeluar nga Kuvendi i Kosovës.

1.2. Për punën e vet Akademia i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.

**Neni 2**

2.1. Akademia është institucion i mëvetësishëm në fushën e shkencës dhe të artit.

2.2. Veprimtaria e Akademisë është veprimtari e interesit të veçantë publik e kosovar.

2.3. Interesi publik e kosovar i Akademisë shprehet në ushtrimin e veprimtarisë së saj në fushën e shkencës dhe të artit, që përfshin kultivimin, nxitjen dhe zhvillimin e mendimit shkencor dhe të krijimtarisë artistike.

**Neni 3**

3.1. Selia e Akademisë është në Prishtinë.

3.2. Akademia ka emblemën e vet.

**Neni 4**

Akademia është person juridik publik me të drejta, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara me këtë Ligj dhe të konkretizuara me Statutin e Akademisë dhe me aktet normative të tjera të veçanta të saj.

**Neni 5**

Puna e Akademisë financohet nga buxheti i Kosovës.

**II. DISPOZITA TË VEÇANTA****Neni 6**

Qëllimet e Akademisë:

Akademia nxit, zhvillon dhe avanco mendimin shkencor dhe krijimtarinë artistike, nëpërmjet:

- a) pjesëmarrjes në formimin e politikave të veprimtarisë shkencore dhe të krijimtarisë artistike;
- b) vlerësimit të gjendjes ekzistuese dhe propozimit të masave për avancimin e mendimit shkencor dhe ngritjen e cilësisë së krijimtarisë artistike;
- c) shqyrtimit të problematikës së përgjithshme nga fushat e veprimtarisë shkencore dhe të krijimtarisë artistike;
- d) organizimit të punës kërkimore-shkencore me karakter teorik e praktik në fusha të ndryshme të dijes dhe të arteve përmes tubimeve, tryezave, këshillimeve, simpoziumeve, konferencave shkencore dhe formave përkatëse të shprehjes së krijimtarisë artistike, si ekspozitave, koncerte etj.
- e) botimit të publikimeve të veta të rregullta dhe periodike nga fusha e shkencës dhe e artit;
- f) bashkëpunimit të brendshëm dhe të jashtëm, së bashku me UNMIK-un, nga fusha e shkencës dhe e artit;
- g) krijimit të kushteve për depërtimin e mendimit shkencor dhe të krijimtarisë artistike jashtë kufijve të vendit;
- h) përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të punës të anëtarëve të Akademisë, dhe
- i) ndërmarrjes së veprimeve të tjera të interesit të veçantë për Kosovën dhe popullatën e saj, e në mbështetje të së drejtës dhe të detyrimit të Akademisë për të qenë institucion sugjerues dhe këshillues për zhvillimin e shkencës dhe të artit në Kosovë, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit.

**Neni 7**

Me qëllim të avancimit të punës kërkimore-shkencore dhe artistike me interes të përgjithshëm për shkencën dhe për artin në Kosovë Akademia themelon seksionet e

**PËR AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**

Akademisë, bërthama të studimit, njësi shkencore e artistike dhe qendra studimore.

**Neni 8**

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Akademisë burojnë nga qëllimet e përgjithshme të saj dhe ato përfshijnë veçanërisht:

- a) planifikimin e punës kërkimore-shkencore dhe artistike në përputhje me mundësitë e saj për realizimin e tyre;
- b) gatishmërinë e Akademisë për pranimin e anëtarëve të rinj në përputhje me standardet më të larta të veprimtarisë shkencore dhe të krijimtarisë artistike;
- c) bashkëpunimin e rregullt, së bashku me UNMIK-un, me akademitë simotra në rajon, në Evropë e më gjerë, si dhe me organizata shkencore ndërkombëtare me qëllim të komunikimit të ndërsjellë shkencor e artistik dhe për një integrim në rrjedhat botërore të shkencës;
- d) realizimin e projekteve me qëllim të ndërtimit të strategjive të zhvillimit të gjithëmbarshtëm të Kosovës dhe të zbatimit praktik të tyre;
- e) Të punohet në projekte, punën në projekte të përbashkëta me institucionet e ngjashme, me qëllim të ruajtjes, mbrojtjes dhe zhvillimit të vlerave kulturore e trashëgimive gjuhësore të të gjitha bashkësive në Kosovë;
- f) punën në projekte të përbashkëta për studimin dhe zhvillimin e kulturave në Kosovë, dhe
- g) të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të saktësuara në Statutin e Akademisë dhe aktet normative të tjera të veçanta të saj.

**III. ORGANIZIMI I AKADEMISË****Neni 9**

9.1. Aktiviteti shkencor e artistik në Akademi zhvillohet në kuadër të seksioneve, të bërthamave të studimit shkencor, të njësive shkencore e artistike dhe të qendrave të tjera studimore.

9.2. Seksionet janë bartëse të të drejtave, detyrave dhe përgjegjësisë të Akademisë për fushat shkencore e artistike për të cilat janë themeluar.

9.3. Në seksionet e Akademisë veprojnë anëtarët e rregullt dhe korrespondentë të fushave përkatëse shkencore e artistike.

9.4. Secili anëtar i rregullt dhe korrespondent i Akademisë mund t'i takojë vetëm një seksionin të një fushe apo njësie përkatëse shkencore a artistike.

9.5. Punën e seksionit e drejton Sekretari i seksionit.

9.6. Punën e njësive shkencore ose artistike dhe të qendrave të tjera studimore e drejton Drejtori ose organi përkatës drejtues.

9.7. Organizimi dhe puna e seksioneve dhe njësive, përkatësisht qendrave të tjera studimore të Akademisë më detajisht rregullohen me Statutin e Akademisë dhe me aktet e veçanta normative.

**Neni 10**

Organet e Akademisë janë: Kuvendi, Kryesia dhe Kryetari i Kuvendit.

**Neni 11****Kuvendi i Akademisë**

11.1. Kuvendi i Akademisë është organi më i lartë i qeverisjes së saj.

11.2. Kuvendin e Akademisë e përbëjnë të gjithë anëtarët e rregullt dhe korrespondentë të saj.

11.3. Në punën e Kuvendit të Akademisë mund të marrin pjesë edhe anëtarët e jashtëm të saj, pa të drejtë vote.

11.4. Seancën e Kuvendit të Akademisë e konvokon Kryesia e Akademisë, vetë ose me propozimin e më së paku dy seksioneve të Akademisë apo të 10 anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë.

**Neni 12**

Kuvendi i Akademisë:

- a) miraton Statutin e Akademisë;
- b) miraton udhëzime dhe procedura të ndryshme që rregullojnë marrëdhënie të caktuara nga veprimtaria e Akademisë;
- c) miraton programin e punës të Akademisë;
- d) miraton Planin Financiar dhe Llogarinë Përfundimtare të Akademisë;
- e) zgjedh anëtarët e rregullt dhe korrespondentë të Akademisë;
- f) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin, Nënkryetarin dhe Sekretarin e përgjithshëm të Akademisë, dhe
- g) verifikon zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve të Akademisë;
- h) kryen dhe detyra të tjera që përcaktohen me këtë Ligj dhe me Statutin e Akademisë.

**Neni 13**

13.1. Kuvendi i Akademisë mund të mbledhet dhe të vendosë nëse në të është e pranishme shumica e anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë.

**PËR AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**

13.2. Për miratimin e Statutit të Akademisë, për zgjedhjen e Kryetarit, të Nënkyetarit dhe të Sekretarit të përgjithshëm të Akademisë, për verifikimin e zgjedhjes së sekretarëve të seksioneve të Akademisë, si dhe për zgjedhjen e anëtarëve korrespondentë dhe të anëtarëve të jashtëm të Akademisë, është e nevojshme shumica e votave të të gjithë anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë.

13.3. Për zgjedhjen e anëtarëve të rregullt është e nevojshme shumica e votave të të gjithë anëtarëve të rregullt të Akademisë.

**Neni 14**  
**Kryesia e Akademisë**

14.1. Kryesinë e Akademisë e përbëjnë: Kryetari, Nënkyetari, Sekretari i përgjithshëm dhe sekretarët e seksioneve të Akademisë.

14.2. Kryesia e Akademisë për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Akademisë.

14.3. Kryesia zbaton vendimet e Kuvendit të Akademisë dhe qëndrimet e tij.

**Neni 15**  
**Kryetari i Akademisë**

15.1. Kryetari i Akademisë e përfaqëson dhe e prezanton Akademinë.

15.2. Kryetari i Akademisë përgjigjet për ligjshmërinë e punës të Akademisë.

15.3. Kryetari i Akademisë për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Akademisë, ndërsa në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Kryesisë së Akademisë, i përgjigjet Kryesisë.

## IV. ANËTARËT E AKADEMISË

**Neni 16**

16.1. Akademia ka anëtarë të rregullt, anëtarë korrespondentë, anëtarë të jashtëm dhe anëtarë nderi.

16.2. Të qenët anëtar i Akademisë është i përjetshëm.

**Neni 17**

17.1. Anëtarë të rregullt dhe anëtarë korrespondentë të Akademisë mund të zgjedhën punonjës të shkencës dhe të artit për të arritura të veçanta në fushat e shkencës dhe të artit.

17.2. Vetëm anëtarët e rregullt të Akademisë kanë të

drejtë ta bartin titullin "Akademik".

17.3. Anëtarë të rregullt të Akademisë mund të zgjedhën punonjës të shkencës dhe të artit, banor me vendbanim në Kosovës, veprat e të cilëve paraqesin realizime kulmore në fushat e shkencës a të artit dhe janë me peshë në vend dhe jashtë tij.

**Neni 18**

Anëtarë korrespondentë të Akademisë mund të zgjedhën punonjës të shkencës a të artit, banor me vendbanim në Kosovës, të cilët kanë krijuar vepra shkencore dhe artistike të një rëndësie të veçantë.

**Neni 19**

Anëtarë të jashtëm të Akademisë mund të zgjedhën punonjësit e shkencës a të artit që jetojnë dhe veprojnë jashtë vendit, por të cilët kanë krijuar vepra të rëndësishme me vlerë për Kosovën ose me vlerë të përgjithshme për shkencën dhe artin.

**Neni 20**

Anëtarë nderi të Akademisë mund të zgjedhën krijues të shquar të shkencës a të artit, që nuk janë shtetas të Kosovës, por të cilët me realizimet e veta janë bërë përgjithësisht të njohur për shkencën a artin dhe të cilët kanë dhënë ndihmesë për Kosovën.

**Neni 21**

Procedura e propozimit, e votimit dhe e zgjedhjes së anëtarëve të Akademisë përcaktohet me Statutin dhe aktet e tjera normative të Akademisë.

**Neni 22**

Zgjedhjet për anëtarë të Akademisë bëhen për çdo katër vjet.

**Neni 23**

Me zgjedhjen për anëtarë të rregullt dhe korrespondentë, anëtarët e Akademisë gëzojnë të drejta dhe marrin detyra dhe përgjegjësi, të përcaktuara me këtë Ligj dhe me Statutin e Akademisë.

**Neni 24**

24.1. Anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë banor me vendbanim në Kosovës u takon shpërblimi i përhershëm mujor.

24.2. Anëtarëve të Kryesisë përkatësisht: Kryetarit, Nënkyetarit, Sekretarit të përgjithshëm dhe sekretarëve të seksioneve u takon shpërblimi mujor për funksionet që i kryejnë.

24.3. Kriteret dhe shuma e shpërblimit të përhershëm mujor për anëtarët e rregullt dhe korrespondentë të Akademisë si dhe për anëtarët e Kryesisë së Akademisë caktohen me vendim të posaçëm të Kryesisë së Akademisë.

## V. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE PROFESIONALE E TEKNIKE

### Neni 25

- 25.1. Shërbimet administrative, profesionale e teknike i kryen Administrata e Akademisë.
- 25.2. Administratën e Akademisë e udhëheq Sekretari i Akademisë.
- 25.3. Sekretari i Akademisë zgjedhet me konkurs për katër vjet dhe mund të rizgjedhet.
- 25.4. Për punën e vet Sekretari i përgjigjet Kryetarit dhe Kryesisë së Akademisë.

## VI. MJETET E AKADEMISË

### Neni 26

- 26.1. Mjetet themelore dhe financiare për punën e Akademisë sigurohen nga buxheti i Kosovës, në zë të veçantë.
- 26.2. Me mjetet nga buxheti i Kosovës sigurohen puna e seksioneve e njësive dhe qendrave të tjera studimore të Akademisë, puna e organeve të qeverisjes të Akademisë, bashkëpunimi i jashtëm i Akademisë, veprimtaria e rregullt botuese dhe periodike e Akademisë, pasurimi i bibliotekës së Akademisë, shpërblimet e përhershme mujore të anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë, shpërblimet për kryerjen e funksioneve të caktuara në Akademi, pagat e përhershme mujore për të punësuarit në shërbimet administrative profesionale e teknike dhe të mirëmbajtjes së Akademisë.
- 26.3. Financimi i projekteve të Akademisë bëhet në bazë të konkurseve të shpallura.
- 26.4. Akademia mund të sigurojë mjete edhe nga donacionet dhe sponsorizimet dhe ato mjete mund t'i përdorë për veprimtarinë plotësuese të saj.
- 26.5. Akademia mund të sigurojë mjete të tjera plotësuese për punën kërkimore-shkencore e artistike të anëtarëve të saj të rregullt dhe korrespondentë përmes aktiviteteve të veta, marrëveshjeve të ndërsjella kërkimore-shkencore e artistike dhe përmes donacioneve e dhuratave ose mbi ndonjë bazë tjetër juridikisht të lejueshme.

### Neni 27

Akademia është pronare e pasurisë të cilën e disponon.

## VII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 28

Akademia duhet të harmonizojë organizimin dhe punën e saj, Statutin dhe aktet e tjera normative të Akademisë, me dispozitat e këtij Ligji brenda gjashtë muajve nga hyrja e tij në fuqi.

### Neni 29

Kryetari, Nënkryetari, Sekretari i përgjithshëm dhe sekretarët e seksioneve të Akademisë i kryejnë funksionet e veta deri me kalimin e kohës mandatore për të cilën janë zgjedhur.

### Neni 30

Ditën që hyn në fuqi ky Ligj, pushon së ekzistuari ligji i mëparshëm i Akademisë.

### Neni 31

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvend dhe nënshkrimit të tij nga PSSP-ja.

**UNMIK/REG/2004 / 25**  
**28.07.2004**

## PËR VEPRIMTARITË HIDROMETEOROLOGJIKE

## LIGJI NR. 02/L-79

PËR VEPRIMTARITË  
HIDROMETEOROLOGJIKE

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 (f) dhe 9.1 26 (a) të Kornizës Kustetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Me qëllim të administrimit të mirë të veprimtarisë hidrometeorologjike të Kosovës, si dhe definimin e kësaj veprimtarie, harmonizimin e politikave dhe standardeve me Organizatën Botërore Meteorologjike (WMO) dhe të Bashkimit Evropian:

Miraton:

## LIGJIN PËR VEPRIMTARITË HIDROMETEOROLOGJIKE

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë ligj rregullohen punët hidrometeorologjike dhe mënyra e kryerjes së tyre.

**Neni 2**  
**Përkufizimet**

**Moti** - paraqet gjendjen fizike të atmosferës në një territor të caktuar, në kohën e dhënë e karakterizuar nga një kombinacion i caktuar i elementeve meteorologjike.

**Klima** - karakterizohet nga një regjim shumë vjeçar i motit me të cilin nënkuptohen jo vetëm kushtet mbisunduese po edhe ata të mundshmet e motit për një vend të dhënë ose më mirë me thënë në përgjithësi klima përcaktohet si rezultat i të gjithë dukurive meteorologjike që karakterizojnë gjendjen mesatare të atmosferës me një pikë të caktuar të rruzullit tokësor. Klima paraqet një renditje të ligjshme të proceseve atmosferike që krijohen në një vend të dhënë, si rezultat i bashkëveprimit kompleks të rrezatimit diellor, qarkullimit diellor, qarkullimit të atmosferës dhe sipërfaqes aktive shtresore, bashkëveprim i cili përcakton regjimin karakteristik të motit për një vend.

**Burimi i parë**- është zona e ujërave të nëntokës në zonën e ngopur dhe me kontakt të drejtpërdrejt me sipër-

faqe të tokës.

**IHMK** - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.

**MMPH** - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.

**Dukuritë Meteorologjike** janë: Bryma, Retë, Reshjet, Ngricat etj.

**Elementet Meteorologjike** janë: Temperatura, Era, Lagështia relative dhe absolute, Diellzimi, Shtypja Atmosferike, etj.

**Neni 3**

Punë hidrometeorologjike në vështrim të këtij ligji, konsiderohen të gjitha llojet e matjeve e të vrojtimitve të elementeve dhe dukurive meteorologjike, hidrologjike, biometeorologjike, hidrobiologjike, përpunimi dhe shpallja e rezultateve të mbledhura të këtyre matjeve dhe vrojtimitve, shpallja e informatave të rregullta dhe të kohë pas kohshme për motin, gjendja e ujërave sipërfaqësore dhe të nëntokës, përcjellja dhe hulumtimi i ndryshimeve dhe dukurive në atmosferën e hidrosferës me rëndësi për ekonominë e Kosovës dhe studimi e vlerësimi i ndikimeve të tyre në mjedis.

**Neni 4**

Punët hidrometeorologjike i kryen Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.

**Neni 5**

Punët hidrometeorologjike me interes për Kosovën janë:

1. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetit themelor të stacioneve hidrologjike dhe meteorologjike,
2. Matjet dhe vrojtimit e elementeve dhe dukurive: hidrologjike, meteorologjike, biometeorologjike dhe hidrobiologjike,
3. Matjet dhe vrojtimit speciale në lëmin e rrezatimit, radioaktivitetit në pajtim me ligjin në fuqi,
4. Matjet dhe vrojtimit e elektricitetit atmosferik dhe ndotjes së ajrit, ujit, të reshurave sipas programit dhe metodologjisë unike që vlen për stacionet e rrjetit themelor,
5. Studimi, përpunimi, ruajtja, këmbimi dhe shpallja e të dhënave dhe rezultateve hidrometeorologjike dhe rezultateve të hulumtimeve në rrjetin e monitorimit,
6. Organizmi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i sistemit llogaritës, vrojtues të bazës së të dhënave e të prognozimit për kryerjen e punëve hidrometeorologjike,
7. Mirëmbajtja dhe kalibrimi i instrumenteve të rrjetit themelor të stacioneve,

## PËR VEPRIMTARITË HIDROMETEOROLOGJIKE

8. Institucionet simotra që merren me sistemin e monitorimit janë të obligueshme që ti referohen (për bazën e të dhënave) IHMK-së,
9. Kryerja e matjeve, vrojttimeve meteorologjike me radar,
10. Kryerja e matjeve dhe vrojttimeve hidrometeorologjike sistematike në ujërrjedhat e lumenjve në rastet e zakonshme dhe në rastet e çrregullimeve të gjendjes së ujërave të nëntokës në zonën e ngopur dhe në kontakt të drejtpërdrejt me tokën dhe nëntokën (në tekstin e mëtutjeshëm burimi i parë),
11. Ndjekja sistematike dhe konstatimi i ndotjes së ajrit, të reshurave atmosferike, ujërave sipërfaqësore dhe ujërave të nëntokës të burimit të parë dhe tokës, si dhe studimi dhe prognozimi i kushteve hidrometeorologjike të ndotjes së mjedisit,
12. Publikimi i analizave hidrologjike, meteorologjike dhe saktësimit afat shkurt: të motit, ujit, akullit në lumenj dhe ndikimi i motit në kulturat bujqësore,
13. Paralajmërimi i paraqitjes së fatkeqësive elementare hidrometeorologjike,
14. Dhënia e raporteve, parashikimeve dhe paralajmërimeve të organeve kompetente qendrore dhe lokale mbi dukuritë hidrometeorologjike me rëndësi për mbrojtjen nga përmbytjet, akulli, ndryshimet e cilësisë së ujërave si dhe paralajmërimeve lidhur me havaritë dhe ndotjet e tjera të paraqitura të ujit,
15. Studimi i motit, klimës, ujërave sipërfaqësore dhe të nëntokës, si dhe ndikimit të tyre në biosferë,
16. Hulumtimi i ndryshimeve të motit, klimës, ujërave të shkaktuara nga ndikimi artificial si dhe studimi i metodave të veprimeve artificiale mbi motin, klimën dhe ujërat,
17. Përgatitjet për kryerjen e punëve hidrometeorologjike dhe përfshirjen e shërbimit hidrometeorologjik për mbrojtje nga përmbytjet,
18. Punët e tjera hidrometeorologjike për të cilat me ligj janë përcaktuar se janë me interes për Kosovën.

**Neni 6**

- 6.1. Financimi i punëve hidrometeorologjike nga neni 5 i këtij ligji sigurohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.
- 6.2. Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen në bazë të programit vjetor të punëve dhe parallogarisë për realizimin e tyre të cilin IHMK-ja e nxjerrë deri më 30 shtator të vitit pasues kalendarik,
- 6.3. Për programin vjetor të punëve dhe parallogarinë e realizimit të tyre, pëlqimin e jep Qeveria e Kosovës.

**Neni 7**

- 7.1. Rrjetin themelor të stacioneve hidrometeorologjike e përcakton me Udhëzim Administrativ Qeveria e Kosovës.
- 7.2. Propozimin e rrjetit themelor të stacioneve hidrometeorologjike e përgatit IHMK-ja pasi të ketë marrë mendimin e Ministrive kompetente për administrimin e resurseve natyrore.

**Neni 8**

- 8.1. Punët hidrometeorologjike për nevojat e veta mund t'i kryejnë edhe personat juridik dhe fizik, me përjashtim të parashikimit të motit.
- 8.2. Subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni kanë për detyrë që për kryerjen e punëve hidrometeorologjike nga neni 5 i këtij ligji për nevojat e veta, të marrin pëlqimin nga MMPH-IHMK-ja.
- 8.3. Personat juridik dhe fizik nga paragrafi 1 i këtij neni, rezultatet e fituara nga monitorimi detyrohen që në afat prej 30 ditësh t'ia dorëzojnë IHMK-së.

**Neni 9**

Rezultatet e hulumtimit, të njoftimit dhe të dhënat që merren me kryerjen e punëve nga neni 4 dhe 5 i këtij ligji janë të dhëna publike përveç rasteve tjera të parapara me ligj.

**Neni 10**

- 10.1. IHMK-ja për nevojat e personave fizik dhe juridik mund të kryej punët nga neni 5 i këtij ligji.
- 10.2. Mjetet financiare të realizuara nga kryerja e punëve për persona juridik ose fizik janë të hyra të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

**Neni 11**

- 11.1. Ndërtimi, rikonstruimi i objekteve hidrometeorologjike ose kryerja e punëve të tjera në objektet dhe në tokën në distancën që kushtëzon ndryshimin e regjimit natyror ose ekzistues të elementeve që monitorohen në stacionet meteorologjike, hidrologjike, stacioneve për monitorimin e cilësisë së ujërave, ajrit dhe dheut të rrjetit themelor mund të bëhen në bazë të pëlqimit të organit kompetent të Kosovës dhe Administratës kompetente për punët e Ekonomisë ujore.
- 11.2. Bashkë me kërkesën për dhënie të pëlqimit nga paragrafi 1 i këtij neni investuesi ka për detyrë të paraqes mendimin e IHMK-së.

**Neni 12**

- 12.1. Pronarët, gjegjësisht shfrytëzuesit e tokës janë të obliguar tu lejojnë kalimin nëpër tokë personave të

**PËR VEPRIMTARITË HIDROMETEOROLOGJIKE**

autorizuar për punët hidrometeorologjike në pajtim me ligjin në fuqi.

- 12.2. Pronarët përkatësisht shfrytëzuesit e tokës nga paragrafi 1 i këtij neni kanë të drejtë për kompensimin e dëmit të shkaktuar me kryerjen e punëve hidrometeorologjike sipas ligjeve në fuqi.

**Neni 13**

- 13.1. Të gjithë personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji do të konsiderohen se bëjnë kundërvajtje.

- i. Personat juridik do të gjobiten në shumë prej 3.000-30.000 euro
- ii. Personat fizik do të gjobiten në shumë prej 2.000-5.000 euro.

- 13.2. Nëse fillon ndërtimi përkatësisht rikonstruimi i objekteve ose kryerja e punëve të tjera në objektet dhe tokën në distancën që kushtëzon ndryshimin e regjimit natyror ose ekzistues, neni 11. Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni do të gjobitet edhe personi përgjegjës fizik dhe juridik, prej 2.000 deri në 5.000 euro .

**Neni 14**

**Hyrja në fuqi**

- 14.1. Për zbatimin e këtij ligji do të nxjerrën aktet nënligjore, në afat prej një viti.
- 14.2. Të gjitha aktet ligjore dhe nën ligjore si dhe ato që janë në kundërshtim me këtë ligj pushojnë së vepruari nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
- 14.3. Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

**UNMIK/REG/2007/2**  
**09.01.2007**

## LIGJI NR. 02/L-100

# PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/49 PËR PATENTIM

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 (ç) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke pasur parasysh nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/49 për Patentim për krijimin e kushteve që Ligji të gjejë zbatueshmëri të plotë,

Miraton:

## LIGJIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/49 PËR PATENTIM

### **Neni 1**

Në Ligjin për Patentim Nr. 2004/49 të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/56 të datës 21.12.2004 në nenin 13.1 në rreshtin e parë fshihet fjalia "Agjencia e Pavarur brenda Qeverisë" dhe zëvendësohet me "Zyra e pavarur në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë".

### **Neni 2**

Në nenin 13.3 në rreshtin e parë fshihet fjala "Qeveria" dhe zëvendësohet me "Ministria e Tregtisë dhe Industrisë", me pëlqimin e Qeverisë.

### **Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

UNMIK/REG/2007/10  
06.02.2007

## LIGJI NR. 02/L-89

# PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/5 PËR TREGTINË ME NAF- TË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 (ç) dhe 9.1.26 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke pasur parasysh nevojën për ndryshimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë për krijimin e kushteve që ligji të gjej zbatueshmëri të plotë.

Miraton:

## LIGJIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/5 PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË

### Neni 1

Në Ligjin Nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/22 të datës 07.05.2005 në nenin 2.1 nocioni "Transporti" ndryshohet dhe përkufizohet si vijon:

"**Transporti**" nënkupton çdo bartje të naftës dhe të produkteve të saj prej një vendi tjetër, përveç bartjes përmes hekurudhës dhe të automjeteve sipas Ligjit për transportin e mallrave të rrezikshme.

### Neni 2

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

UNMIK/REG/2007/9  
05.02.2007